

Në Katedralen e Sienës, kemi imazhin e plotë të një shqiptari të famshëm të viteve 1460-1480, të një luftëtari që la gjurmë në frontet e luftërave dhe zhvillimet politike, në rajonin e Ballkanit e më gjerë, në shekullin e XV.

LUFTËTARË SHQIPTARË NË TABLOTË E PIKTORËVE TË MËDHENJ TË RILINDJES ITALIANE

Nga Prof. Dr. Irakli Koçollari



KRIKA LETRARE DHE SPEKULIMET NËN OKELION E SAJ

nga Vangjush Sarro

(fq. 12)

Kohët e fundit, në disa shkrime, jam përpjekur të theksoj se është momenti që në fushën e letrave t'u lëmë vendin e duhur Tregut dhe Kritikës Letrare. Nuk ka dhe nuk mund të ketë letërsi e art përtej këtyre treguesve; edhe nëse, do të ishte një gjë fort e rralë. Madje, gjykoj se edhe kur ndahen çmime e bëhen nderime - për çka gjithnjë konsumohen llafe, mbase me të drejtë - duhen marrë parasysh këto tregues; sepse janë shumë pranë së vërtetës, sa i takon veprave në fjalë dhe letërsisë në tërësi.



REVISTA "KRITIKA" (1944) E ARSHI PIPËS

(Vështruar si paradigmë e kujtesës)

Nga Ymer Çiraku

Revista *Kritika* kujtohet me vërim, si e para revistë shqiptare e orientuar posaçërisht për nga lëvrimi i kritikës letrare, por edhe si projekt i aktivitetit dhe përgatitjes të një kritiku e personaliteti të shquar në kohët e mëpasme, sikundër do të ishte Arshi Pipa.

(fq. 6)

SHËNIME MBI LIBRAT

"B2" DRAMA E PANJOHUN GJERMANISHT E GJOVALIN GJADRIT

nga Ardian Ndreca

(fq. 5)

Kësaj herë kemi të bajmë me një dramë të shkrueme në gjuhën gjermane, një vepër me një sfond të theksuem autobiografik që trajton atë pjesë të shkurtë të jetës së autorit që ai ka kaluar si inxhinier në Bashkimin Sovjetik në fundin e viteve '20.

PSE ROMANI "KARVANI BARDHË" I AZEM SHKRELIT NA PRISH PUNË?

Nga Anton Nikë Berisha

(fq. 8)

Poezia e Azem Shkrelit me strukturën e veçantë tekstore poetike, me shumësinë dhe thellësinë kuptimore që ngërthen në vete, me nëntekstin e pasur poetologjik dhe me mundësi të shumta të ndikimit estetik, bën një rëndësi të veçantë të shumta të ndikimit estetik, bën një rëndësi të veçantë të shumta të ndikimit estetik, bën një rëndësi të veçantë të shumta të ndikimit estetik.

Për romanin "Arratisja e fundit
e Baltazar Ketës" - Agron Tufa

NËPËR DISTOPINË E SHQIPËRISË

nga Ballsor Hoxha

(fq. 10)

Për të krijuar një distopi shkrimtarit shpesh i duhet që të gjejë mesin, jo utopinë e vendit të cilin e shndërron, por këtu, pyetemi, nëse kjo është shkathtësi e papërsëritshme e autorit të romanit "Arratisja e fundit e Baltazar Ketës", Agron Tufës, apo në të vërtetë ai vetëm sa ka 'hapur' realitetin.

ROMANI "SHIHEMI NË GUSHT", NJË RRËFIM I FUNDIT I DASHURISË DALLDISËSE

Nga David Mills, *The Times*

PARATHËNIA NGA BIJTË E SHKRIMTARIT

Rodrigo dhe Gonzalo García Barcha

FRAGMENT NGA KAPITULLI I PARË

Përktheu nga origjinali: Mira Meksi

SHËNIM I REDAKTORIT

nga Cristóbal Pera

PËR NJË LIBËR QË MË NË FUND MUND TË SHKRUAJ

nga Andreas Dushi



(fq. 20-24)

BIBLIOTEKË

Martin Camaj

(fq. 14)

Lirika

Immanuel Mifsud

(fq. 13)

Vështrime në errësirën e natës

Elida Buçpapaj

(fq. 16)

Tiranës

Alejandra Pizarnik

(fq. 17)

Pafajësia e fundit

Libër i ri me poezi i Visar Zhiti në Itali

RRUGË OË RRJEDHIN NGA DUART E MIA

(fq. 11)

Botim i ri nga Minerva

NJERIU MË I PASUR NË BABILONI

nga George S. Classon

(fq. 7)

SAMANTA SCHWEBLIN:

Letërsia ka një fuqi të
pakrahasueshme

Bisedoi: Florencia del Campo
Përktheu Granit Zela

(fq. 18)

RILINDJA DHE ARTI I RILINDJES

Piktorët e mëdhenj të Rilindjes italiane i ofruan historisë së artit dhe bashkë me të historisë së shoqërisë njerëzore, jo vetëm mjeshtërinë e madhe të krijimit, teknikave, zhanreve të reja por edhe filozofinë e madhe të artit të ri, përcollën mesazhe të rëndësishme për gjeneratat që do të vinin dhe ndryshonin botën. Arti i tyre vendosi për herë të parë në qendër të krijimit, - humanen, duke shtyrë përmasat stuhisë së kurajës krijuese një epokë të re që do të vinte ndesh me tërë traditën konservatore të shekujve pararendës dhe shpallur botërisht epokën e humanizmit.

Subjektet e muraleve marramendëse, shkuan përtej të njohurës duke ofruar imazhe mahnitëse, personazhe dhe ngjarje tronditëse, të së shkuarës por edhe bashkëkohëse, heronj dhe profetë, filozofë dhe mëkatarë, ekzekutorë dhe të ekzekutuar, rebelë, kryengritës dhe të nënshtruar. Të gjitha ata qëndrojnë aty, në planet ballore apo dytësore të veprave të artit. Prej shekujsh ato vazhdojnë të komunikojnë me gjenerata të tëra gjer në ditët tona, me ne spektatorët, vizitorët dhe nxënësit e përjetshëm të mjeshtërve të mëdhenj të asaj epoke.

Në to janë ngjizur aleanca dhe konflikte, tronditje politike dhe religjioze, figura të njohura dhe personazhe me rëndësi historike apo të tjerë anonimë, që ende nuk i njohim apo nuk dimë ç'thonë. E gjithë ajo mori e pafund skenash, personazhesh, lëvizjesh, gjestesh, vështrimesh, planesh, përcjell mesazhe të pafund. Disa i kemi kuptuar, të tjerat qëndrojnë në mënyrë sfiduese dhe lutëse përpara nesh për të rrëmihur brenda heshtjes së tyre domethënëse dhe zgjidhur enigmat.

Dhe ndodh, që në këto sfida, në përpjekjet për të gjetur të fshehtat e heshtura, që qëndrojnë nëpër shekuj mes kryeveprave të artit të Rilindjes, të identifikohen skena apo personazhe të panjohur, të cilat zbulojnë enigmat shekullore dhe të shpjegohen kështu skenarët e tablove të hershme.

Sigurisht, një rast i tillë është çasti i ngazëllimit të madh njerëzor. Një ngjarje të tillë trajtojmë edhe ne në rreshtat e këtij shkrimi!

SHQIPTARËT NË EUROPËN MESJETARE

Epoka e artit të madh - Rinashimentos, të shekujve të XIV-XV, përkon me ngjarje të mëdha, komplekse politike dhe ushtarake, filozofike, shkencore, me zbulimet e mëdha gjeografike, astronomike, fizike, anatomike, etj., në Europë dhe më gjerë.

Por, epoka e madhe e Rilindjes përkon me ngjarje të mëdha tronditëse edhe për trojet arbërore! Ishin dekadat dhe shekulli kur arbërit çapiteshin krahas ritmeve perëndimore, zgjerimin kontaktet intensive me ta, rrisnin këmbimet tregtare, politike por edhe

LUFTËTARË SHQIPTARË NË TABLOT E PIKTORËVE TË MËDHENJ TË RILINDJES ITALIANE

Prof. Dr. Irakli Koçollari

kulturore, etj. Por, në këto dekada, të fundit të shekullit të XIV, fatkeqësisht, bota e arbërit do të kërcënohej fatalisht nga invazioni i përgjakshëm, barbar Osman. Rezistenca e popullsisë shqiptare ishte e gjatë, e përgjakshme dhe mbresëlënëse. Kudo ku arbërit ndodheshin, brenda kufijve të Arbërisë mesjetare apo edhe përtej, në kalvarin e emigrimeve nëpër Europë ata do të qëndronin fort përballë invadorëve

lindorë dhe do të luanin një rol të rëndësishëm në fatet e popujve të këtyre anëve.

Në frontet e luftërave në trojet arbërore, në Ballkan apo nëpër Europë ku ata emigruan, u identifikuan si luftëtarë të rrallë, me kurajë unike, me emrin e njohur "Stratioti Albanesi". Repartet e tyre u kthyen në njësi ushtarake elitë, në formacione që vendosnin fatet e luftimeve në



Fig. 1. Skica e Petro Buas nga Xhentile Bellini



fushëbeteja. Shumë nga komandantët "di stratioti Albanesi" u bënë figurat e luftëtarëve dhe strategëve më të njohur në Europë, morën emër, tituj, grada, dekorime dhe flamuj si rrallëkush në historinë e mesjetës. Mërkur Bua (Gjenerali më i dekoruar në historinë e Europës mesjetare), Krokodil Kladha (Kryengritës në territoret e tre popujve, për 40 vite me radhë), Gjergj Basta (Strategu i rreth 90 betejave të fituara në frontet e Europës, teoricien dhe autor i disa traktateve teorike militare), kapostratiotët Buziqi, Maneshi, Muriqi, Meksi, Kelmendi, Bohali, Peta, Shpata, Këmbëthekra, Koroveshi, Gjerbësi, Petro Bua..., dhe bëmat e tyre mbushin raftet e pafund të arkivave mesjetare.

Pikërisht, këta personazhe, për shkak të bëmave dhe gjurmëve që ata lanë, emocioneve që ata krijuan në botën e trazuar europiane, tërhoqën vëmendjen, emocionuan dhe u bënë subjekt i shumë krijimeve në artin e Rilindjes italiane. Piktorë dhe mjeshtër të mëdhenj të artit, si Xhentile Bellini, Lorenzo Lotto, Vittorio Karpajo, Pintorekio dhe dekada më vonë Eugen Delakrua, Camille Corot, Leon Gerome, etj., vunë në fokusin e penelit apo të grafitit fushëbetejat e stratiotëve shqiptarë. Aktet e tyre mahnitëse apo portretet e atyre burrave të shquar u kthyen në simbole shprese për popuj dhe fatet e tyre. Një ndër ta dhe ndoshta luftëtarë (stratioti) më i adhuruar edhe në botën latine është Petro (Pjetër) Bua.

PETRO BUA STRATIOTI SHQIPTAR I ADHURUAR NE ARTIN ITALIAN

Vitet e fundit, në fondet e veprave të artit të Rilindjes italiane është identifikuar një grafikë e bukur e panjohur më parë e këtij stratioti, Petro Buas, një komandant i njohur i reparteve shqiptare, i cili krijoi një emër të madh sa në ndeshjet e tij në frontet e luftërave antiosmane në trojet e Ballkanit, në Peloponez, por edhe nëpër territoret e Italisë dhe më gjerë në Europë.

Grafika e gjetur është punuar nga piktori i njohur i Rilindjes italiane, veneciani Xhentile Bellini (Gentile Bellini).

Po kush ishte Petro Bua (Shpata) që tërhoqi vëmendjen e mjeshtërve të madh Italian të pikturës?

RËNIA E KOSTANDINOPOJËS DHE QËNDRESA E SHQIPTARËVE

Në kohën që Kostandinopoja përpëlitej nën grahamat e fundit të shpirtit të saj (1453) dhe perandori i Bizantit (Dhimitër dhe Thoma Paleologu) kishte marrë arratinë në Mistra të Peloponezit, për tu larguar përfundimisht edhe prej këtu, drejt Italisë, askush nuk e dinte se çdo të ndodhte me gadishullin e Moresë (Peloponezin) dhe popullsinë e tij.

Kush do të ishte tanimë autoriteti që do të merrte kurajën të bënte thirrje dhe të udhëhiqte popullin në luftërat e përgjakshme kundër invazionit Osman? Peloponezi dhe Greqia nuk kishte askund më një autoritet tillë!

Fatkeqësisht, historiografia greke hesht për këtë çast fatal të perandorëve grekë të Bizantit! (1) Pikërisht, në këto kohë tmerri, shfaqet Petro Bua një shqiptar i Peloponezit, i cili kërkon prej shqiptarëve të këtyre anëve (të cilët ishin një popullsi maxhoritare ato kohë në Peloponez), të zgjedhin udhëheqësit e tyre! Dhe shqiptarët e bënë këtë.

Historia e shkruar për këto ngjarje konsideron këtë akt si një revoltë apo kryengritje, kur në fakt pikërisht ata, shqiptarët po e vlerësonin largimin e palavdishëm një dështim të plotë dhe përfundimtar të desotëve grekë. (2)

Historiani bizantin dhe bashkëkohës i ngjarjeve, Sfranzes shkruan qartë se “në fakt në këto kohë të gjithë Shqiptarët e Moresë ishin në revoltë dhe kryengritje. Ndërkohë ushtarakët venecianë, sipas dokumenteve të Arkivit të Venedikut, sqarojnë se “këta kryengritës kishin një fuqi prej tridhjetë mijë luftëtarësh.” (3)

Historiani tjetër bizantin i kohës, Leonik Halkokondili, i identifikon këto ngjarje me rolin dhe praninë e një figure të rëndësishme, atë të shqiptarit Petro Bua, duke e karakterizuar atë si “një burrë të ashpër dhe me sjelljet e një të pabinduri...(nënkupto – të panënshtuarit)”, - karakteristikë të cilën historianët grekë e kanë pranuar si të mirqënë dhe pa ja nënshtuar asnjë analize, vetëm për faktin se Petro Bua ishte një shqiptar. (4)

Por, ndryshe nga Halkokondili, venecianët e shumtë që e njohën nga afër Petro (Pjetër) Buan na ofrojnë të tjera konsiderata, duke nënvizuar për të se ai ishte një “**burrë me karakter të pastër dhe kurajoz, luftëtar i vendosur**”. (5)

GJENEALOGJIA E SHQIPTARIT PETRO BUA

Petro Bua rridhte nga familja e njohur e princit shqiptar Gjin Bua Shpata. Stërgjyshi i tij ishte pikërisht ai zoti i njohur i trevave të Arbërisë jugore, Artës, Ahaisë, etj., Gjin Bue Shpata. Në fakt mbiemri i familjes së tij ishte Bua, por sikundër bën me dije historiani grek i shekullit të kaluar, K. Biris, titulli “Shpata” ju dhurua Buajve nga Princi i njohur shqiptar, Karl Topia, aso kohe zot i Durrësit dhe Arbërisë qendrore.

Kjo ndodhi mbasi tre princat shqiptarë, Gjin Bua Shpata, Karl Topia dhe Gjin Zenebisi në aleancë me njëri tjetrën fituan betejën e përgjakshme kundër aleancës bizantino-turke-florentinase në Angjelokastër – Etoli, Akarnani. (6)

Vite më vonë Pavllo Bua Shpata, gjyshi i Petro Buas, gjendet i vendosur në Peloponez mbasi kishte dorëzuar Nafpakton venecianëve. Fill mbas këtyre ngjarjeve duket që familja fisnike e Shpatajve gjendet përfundimisht në Peloponez dhe Atikë (Greqi), së bashku me një numër të madh shqiptarësh, emigrim që aso kohe Perandori i Bizantit, Manueli i II i mbështeti.

Aty nga mesi i shekullit të XV një nip i Pavllo Buas, Petro Bua shfaqet në Peloponez si kreu i fisit, madje edhe i një feudi të madh. (7)

Ai shfaqet në arkivat veneciane, si komandanti i vetëm në radhën e princave të Peloponezit që nuk kishte pranuar të nënshtroante nënshtimin ndaj Sulltan Muratit, pra që nuk kishte pranuar pushtimin!

Mbas rënies së Kostandinopojës dhe vdekjes së perandorit bizantin

Kostandin Paleologut, më 1453, shqiptarët e Moresë (“albanesi di Morea”) të udhëhequr nga Petro Bua u ngritën në revolta të armatura kundër dy Despotëve të Moresë, Thoma dhe Dhimitër II, për tributet e mëdha të papaguara prej tyre. Edhe në vitet në vazhdim kjo forcë e madhe shqiptarësh prej 30,000 vetësh nën komandën e Buas vazhdoi qëndresën e përgjakshme kundër pushtuesve osmanë nëpër fushëbeteja duke e mbajtur Morenë për vite të tëra të lirë dhe panënshtuar nga pushtuesit osmanë. Tridhjetëmijë luftëtarë shqiptarë e konsideronin atë si udhëheqësin e tyre. (8)

Në vitin 1459, Petro Bua shfaqet përsëri në dokumentet veneciane, madje ato e përcaktojnë ato si “kapo” të të gjithë Shqiptarëve kryengritës të Moresë. Jo vetëm kaq, por ai së bashku me tjetër kryengritës Manuel Ralin gjendet në një listë që së bashku ne dymbëdhjetë princa të tjerë luftojnë në krah të venecianëve në Isthm, në gusht të vitit 1463. Nga viti 1464 dhe gjer në vitin 1467 Petro Bua gjendet edhe më

tej në shumë dokumente veneciane që pasqyrojnë beteja dhe luftime të pandërprera në frontet antiosmane. (9)

Në radhën e po këtij dokumentacioni gjenden edhe dorëshkrime të vetë atij, çka tregon kulturën e këtij shqiptari të dëgjuar. Petro Bua nuk kishte djalë dhe për këtë arsye Venediku për kontributet e tij, si komandant i suksesshëm në shumë fronte të luftërash të Venedikut, i njohu si djem tre nipat e tij Nikollën, Petron dhe Kondotjerin Mërkur Buan, një tjetër luftëtar të famshëm, ndoshta gjenerali më i dekoruar në frontet e luftërave të Europës. (10)

Në vitet në vazhdim, i ftuar nga venedikasin, Bua bëri të paktën tre udhëtime në Venecia si aleat i tyre dhe së bashku me ta ai mori pjesë me trupat në një sërë fronte betejash, duke lënë impresione të thella në sytë e latinëve. Për meritat e tij të veçanta në luftërat e vazhdueshme dhe rezistencën antiosmane, si dhe kontributet në aleancat venedikase, në 1476, Senati Venedikas e priti atë me nderime të veçanta në Pallatin e Dozhëve “*dhe i dorëzoi atij një shpërblim të madh në para*”.

Në 1478, përsëri Dozhët me vendim e shpallën atë “*Kalorës nderi*” dhe i dhanë sipas protokollit të veçantë një mantel të punuar në ar, në ngjyrë të kuqe.” (11)

Por, fama dhe emri i Petro Buas ka qenë mjaft i përhapur për bëmat e tij, jo vetëm në kohën që ai jetoi, por edhe në dekadat që pasuan. Kështu, në poemën e njohur të shqiptarit Manol Blesi, botuar në vitin 1561, të titulluar “*I Fatti e le Prodezze di Manoli Blessi, Strathioti*”, dhe në të dytën titulluar: “*Barzaletta – de Quattro compagni de Albania zuradi de andar per il mondo alla ventura, capo di loro Manoli Blessi da Napoli di Romania*”, ne gjejmë vargje dedikuar stratiotëve të njohur arbërorë (albanesi) që luftuan për vite me radhë në territoret italiane dhe më gjerë nëpër Europë. Mes tyre autori rendit edhe Petro Buan, si një kapostratit, që sigurisht kishte lënë gjurmë në frontet e luftërave në ato anë. Në këto vargje Blesi shkruan:

Ku është Shtino dhe Kanaci?
Meksi, Lopsi dhe Barbati?
Po Andruc mustaqegjati?
Petro Bua dhe Stamati? (12) (a).

(a)
MANOLI BLESI:
“I Fatti e le Prodezze di Manoli Blessi, Strathioti”
by Antonio Molino, Giolto di Ferrari, Venezia, 1561.

Dovè e l Stigni, e chel Canacchi,
Mexsa, Lopossi, et Berbatti,
con Andruzzo dal mustacchi,
Petro Bua, com Stamatti,
.....

Në periudhën e viteve 1467 dhe gjer në vitin 1489, Petro Bua si një komandant i stratiotëve shqiptarë bëhet një ndër figurat më të njohura të luftëtarëve të dalluar në Republikën e Venedikut dhe më gjerë në opinionin Italian.



Fig. 2. Petro Bua në tablon e Pinturekios



Fig. 3. Tabloja murale e Pinturekios në anën e majtë të të cilës ndodhet Petro Bua – veshur me mantelin e kuq dhe në krah të djathtë të tij turku me turban në kokë.

Mbas vitit 1501 ai nuk përmendet më në dokumentacionin arkivor apo nga burime të tjera, çka nënkupton se në moshë të thyer ai duhet të ketë vdekur. (13)

PIKTORI XHENTILE BELINI DHE STRATIOTI SHQIPTAR PETRO BUA

Sigurisht, tek një luftëtar i tillë, sku qenë kthyer sytë e shpresës të shumë njerëzve në Ballkan e më gjerë, në Venecia, në Ishujt Jonianë, bregdetin Dalmat, etj., nuk kish si të mos kthehej vëmendja, bashkë me të adhurimi dhe frymëzimi i artistëve të kohës, për më tepër në hapësirat e Rinashimentos.

Dhe vërtet, ishte piktori i famshëm i Rilindjes Italiane, Xhentile Belini ai që punoi atë skicë të detajuar dhe mjaft të bukur, të kapëdanit Petro Bua, që është gjetur vitet e fundit. Bua qëndron në këmbë, (Shih tablën nr. 1) me një pelerinë (mantel) mbi supet, që i ngjan një tallagani apo gune të traditës së komitëve shqiptarë. Ai ka një pozicion sfidues, gjysmë të kthyer, me një sup më të ngritur se tjetri, mbi të cilin mban peshën e pelerinës, me vështrim të drejtuar ballazi mbi atë që punon portretin e tij, i vrenjtur, pse jo kërcënues, me mustaqe të gjata dhe një kësulë karakteristike në kokë.

Ne ende nuk dimë ku e takoi piktori i njohur Italian heroin shqiptar të

fushëbetëve!? Kush ja prezantoi dhe ja solli piktorit këtë shqiptar për ta punuar? Nuk dimë, gjithashtu, nëse skica ishte thjeshtë dhe vetëm një punim i mjeshtrit apo bashkë me të ajo do të ketë shërbyer piktorit si një bocet për ta hedhur mandej në telajo me ngjyra? Nëse e punoi me ngjyra, ku mund të ndodhet ajo, nëpër galeri apo pinakoteka personale? Nuk dimë gjithashtu nëse piktori punoi vetëm këtë variant apo edhe skica të tjera të Petro Buas? Këto dhe shumë dilema mbeten ende të panjohura dhe pa përgjigje.

NJË E PAPRITUR BEFASUESE DHE NGAZËLLOESE!

Duke vizituar para pak kohësh fondet e artit të rilindjes italiane dhe monumentet ku qëndron një pjesë e madhe e tyre - katedralet, papritur për habinë tonë, hasëm në Katedralen e qytetit të Sienës - Itali, në sallën maxhore të saj, në një prej muraleve qendrore, të titulluar "Debatit i Shën Katerinës", punuar në vitin 1491, një figurë që vështron në mënyrë sfiduese i kthyer me vështrim nga vizitorët, sikur të komunikojë me ta!!!

Për çudinë tonë konstatojmë se ky personazh qendror i muralit ishte i njëjti personazh, me atë të skicës të punuar nga Xhentile Belini! Ai ruan të njëjtin pozicion, të njëjtën pelerinë, një sup më të ngritur se tjetri, njëra dorë

e mbuluar nga pelerina tjetra, ndërsa tjetra, dora e majtë e lëshuar në pozicion të lirë. Është i njëjti portret, i burrit me vështrim sfidues, me mustaqe, krenar pse jo kërcënues... Tiparet e fytyrës janë po ato që gjenden në skicën e Bellinit! Pra, është i njëjti njeri...! Është vetë shqiptari Petro Bua!

Por, tanimë, Petro Bua në këtë kompozim mural është punuar me ngjyra, në përmasa të mëdha dhe manteli që ai mban hedhur mbi supet duket qartë që është në ngjyrë të kuqe, i punuar në ar. Pra, është ai mantel që i dhuruan Dozhët e Venedikut, një veshje fisnikërie që nuk e kishte kushdo, por vetëm njerëz të paktë të rangjeve të larta dhe të nderit të veçantë.

Kjo tablo është punuar nga një tjetër piktor i famshëm i rilindjes italiane, Bernardino di Betto di Biagio, apo ndryshe i njohur në tërë botën e artit me nofken Pikturiku, sikundër e shkruante ai vetë emrin dhe firmën e tij!!! Ndërsa në literaturën e shkruar për të, gjendet me emrin Pinturikio. (shih fig 2, 3)

Nuk dimë, nëse Pikturiku e njohur vetë, personalisht, luftëtarin shqiptar Petro Bua, apo ai e punoi atë mbështetur në skicën e njohur të Bellinit?! Nëse është kështu, nuk dimë gjithashtu se si dhe në ç'rrethana Pikturiku mori të drejtën e riprodhimit të skicës së Belinit, në një murale të rëndësishme dhe përjetësuar atë në Katedralen e Sienës?!

Në muralen e Pinturekios gjenden edhe figura të tjera, por ajo që tërheq

vëmendjen është e një turku me turban në kokë. Nga verifikimet mësohet se ai është vëllai i Sulltan Muratit - i njohur me nofken "Pushtuesi". Ai kishte miqësi me Dukën e Sienës dhe kishte vizituar këtë qytet disa herë, ato vite. Siç shihet qartë edhe në tablo, turku ka ngulur vështrimin e tij mbi shqiptarin Petro Bua, kundërshtari gjer në vdekje i perandorisë Osmane, njeriu që luftonte për lirinë e popullit të tij të robëruar. Belini ka punuar një skicë edhe të këtij vizitori lindor të papranushëm për Petro Buan.

Edhe personazhe të tjerë në këtë tablo kanë kthyer sytë nga luftëtarin shqiptar çka tregon se ai kishte tërhequr vëmendjen e opinionit latin. Tabloja flet shumë edhe me mjaft detaje të tjera që ajo ofron..

Sidoqoftë, në Katedralen e Sienës, tanimë në kemi imazhin e plotë të një shqiptari të famshëm të viteve 1460-1480, të një luftëtarin që la gjurmë në frontet e luftërave dhe zhvillimet politike, në rajonin e Ballkanit e më gjerë, në shekullin e XV.

Pse jo, kjo është një arsye më shumë që Katedralja e Sienës të jetë një atraksion unik për t'u vizituar nga shqiptarët, duke shpresuar që të tjera vlera të panjohura të shqiptarëve do të gjenden në tokën dhe artin Italian, me të cilin vendi ynë ka pasur lidhje dhe këmbime të hershme tradicionale.

Për ma shumë se nandë dekada ato letra thuejse të tejdukshme, të zverdhuna e të brishta, kishin ndejt të mbylluna në një sirtar mes skicash, kalkulimesh inxhinierike, projektesh të realizueme apo të harrueme që inxhinier Gjovalin Gjadri ka ba ndër vite. Askujt nuk i kishte shkue ndër mend, dhe arsyeja kryesore asht gjuha në të cilën janë shkruie, se bahej fjalë për një dramë, madje për një vepër teatrale tepër moderne dhe interesante që e nxjerr në pah Gjadri si një shkrimtar të mirëfilltë e jo thjesht si një bashkëshort që mori shtysëm me shkruie librin e tij të mirënjohun "Letra grues seme teme të vdekun" nga tragjedia e vdekjes së grues së tij.

Dihet tashma se ky libër papritmas ka dalë si një *bestseller* i letërsisë sonë, tue pasë në një kohë krejt të shkurtë tri botime, të gjitha të shtypuna nga Shtëpia e mirënjohun botuese "Onufri".

Kësaj herë kemi të bajmë me një dramë të shkrueme në gjuhën gjermane, një vepër me një sfond të theksuem autobiografik që trajton atë pjesë të shkurtë të jetës së autorit që ai ka kalue si inxhinier në Bashkimin Sovjetik në fundin e viteve '20. Emigrimi i tij në atë shtet nuk përban një çudi për kohën, edhe pse nuk ka asnjë lidhje me ideologjinë e shtetit sovjetik, por thjesht me profesionin e tij. Asokohe Bashkimi Sovjetik për arsye të numrit të madh të veprave publike që ndërtonte dhe nevojës për specialistë kishte mbërrijtë me tërheqë një numër të madh inxhinierash dhe specialistash nga Austria, Gjermania, Britania e Madhe, Franca, të cilët paguheshin shumë mirë dhe kishin kushte të mira jetese. Një ndër ta ishte edhe Gjovalin Gjadri, i cili me formimin

"B2" DRAMA E PANJOHUN GJERMANISHT E GJOVALIN GJADRIT *nga Ardian Ndreca*



e tij profesional në shkollën austriake i plotësonte kushtet për një kontratë pranë Komisarariatit të Transporteve në Moskë që asokohe drejtohej nga ministri Rublev.

Drama duhet të jetë shkruie në harkun kohor 1930-'31, dhe ka shumë elemente që na shtyjnë me mendue se asht hedhë në letër me turr menjihërë sapo Gjadri ishte kthye në Tiranë dhe si e tillë ajo ruen freskinë e emocioneve të forta dhe të tragjedisë që ai kishte përjetue në ato dy vite e gjysëm që kishte jetue në Rusinë sovjetike.

Në pesë aktet e dramës zbulohet një dramaturg me nerv të fortë, i cili mbërrin me ndërthurë dinamizmin skenik me thellësinë e mendimit filozofik, përgjatë veprës ndihen nuancat büchneriane si edhe ndikimi i teatrit ekspresionist vjenez dhe forca e mendimit e ndjeshmënia tej mase e thellë e ndjenjave të autorit. Dashunia dhe vdekja krijojnë kushtet ideale për një


tension dramatik në "crescendo". Tablotë e dramës zhvillohen në Moskë, në Alupka në Krime dhe në Shafranovo, një sanatorium në Urale.

Rrezikut që i kanoset për jetën e protagonistit Enrik Vremeda sëmundja e tuberkulozit pulmonar i shtohet edhe survejimi dhe përndjekja nga ana e agjentëve të GPU, sigurimit të Lubjankës, prej të cilëve arrestohet edhe pse i sëmurë randë. Dashunia e tij plot tallaze për Tatjanën, marrdhanjet komplekse shoqnore me kolegët, diskutimet me tone nietzscheane me ipeshkvin katolik Brisanski në qelitë e Lubjankës, si edhe skena e fundit me të dashunën e tij duken të shkrueme prej një shpirti që jo vetëm e një jetën në palat e saja ma të mshehta e tragjike por zotnon artin dramatik dhe sekretet ma të thella. Familjariteti i tij me skenën spjegohet edhe pse tashma dihet se Gjadri gjatë viteve të studimit

në Vjenë e kishte ba zakon që çdo muej të hiqte mënjianë aq sa i duhej për me pague biletat për shfaqjet teatrale në Burgtheater.

Gjuha e dramës asht e pasun, një gjermanishte e zhdërvjellët dhe shumë shprehëse, figuracioni i pasun, ndërsa ajo që të bjen në sy asht sensi i pritjes, element ky i dramës ekspresioniste, gja që e ban autorin një pionier shqiptar në këtë lloj drame dhe një dramaturg shqiptar "sui generis".

Shumë shpejt kjo dramë që tashma asht përkthye gegnisht nga i nënshkruemi, do t'i vijë në dorë lexuesit shqiptar e ndoshta teatri i qytetit të tij të lindjes do të mund ta nderojë autorin Gjovalin Gjadri tue e vu në skenë veprën, e cila – e themi pa modesti – do të hynte me të drejta të plota në repertorin e artë të atij teatri tue i dhanë sens dhe jetë kulturës dhe artit tonë skenik.



Nga grishja e kësaj kujtese, krahas veprave letrare, nga ato që zënë vend në rendin e vlerave, nuk mund të mbeten jashtë vëmendjes as vektorët e proceseve të kritikës letrare, e cila, dihet se shfaqet e lidhur ngushtësisht/pazgjdhshëmrisht, edhe me fatin e vet letërsisë shqipe. Përveç ndërvarësisë së brendshme, nga aspekti determinativ, mes tyre ka rezultuar i pandarë gjithashtu edhe fati i ndikimeve reciproke, ku nuk kanë munguar nga ato raste që ky ndikim - të shkonte deri në absurd, pikërisht atëherë, kur kjo situatë, vinte veçse për shkaqe të natyrës jashtë letrare. Domethënë, një kritikë anatomohej dhe përjashtojë nga komunikimi për shkaqet e fatit jashtëletrar të veprës, apo të autorit - të cilit, ajo mund t'i referohej. Apo edhe sepse vet autori i shkrimeve kritike, mund që të zbohej nga fronti i kritikës për shkaqe krejt të tjera, nga ato që s'kishin të bënin fare me tekste të kritikës së tij. Kjo ka ndodhur me jo pak autorë të njohur, që u përfshinë në rrahjen e problemeve të letërsisë shqipe si: Faik Konica, Namik Ressuli, Mitrush Kuteli, Filip Fishta, Ernest Koliqi, Karl Gurakuqi, Eqrem Çabej, Arshi Pipa, Vedat Kokona, Vangjel Koça (alias Vangjo Nirvana), Pashko Gjeçi, Jani Lili etj. Madje është interesante të kujtojmë se ky i fundit, Jani Lili, me pseudonimin letrar Lek Drini, që shfaqet mjaft aktiv në lëvrimin e kritikës në periudhën monarkiste e gjatë viteve të luftës së dytë botërore, i është drejtuar disa herë edhe paradigme/dimensionit të kujtesës në letërsi, dhe konkretisht në disa shkrime me tituj të tillë si: *Kujtimi, element i parë i artit* (tek: *Tomori*, 28.1.1942), *Kujtimi dhe koha* (tek: *Vatra shqiptare*, 25.11.1941), *Futurizmi dhe kujtimi* (tek *Tomori*, 23.1.1942).

Në këtë kontekst, si kujtesë e një kontributi - por i përjashtuar ky kontribut nga komunikimi për dekada vitesh, mund të shqyrtohet edhe revista *Kritika* (1944) e A. Pipës, e cila, e ka nisur botimin periodik të saj në disa numra, 80 vjet më parë, në marsin e vitit 1944. Pra, doli në qarkullim në një nga periudhat më të vështira të kohës, deri edhe të rreziqeve të mirëfillta egzistenciale, sikundër ishin vitet e pushtimit të Shqipërisë, gjatë luftës së dytë botërore. Por paradoksalisht, në kohët që erdhën më pas, edhe pse tashmë jemi pas largimit të pushtuesit, jo vetëm që kjo revistë nuk mundi ta vijonte dot më botimin e saj, por edhe mbeti në harrësë, apo nisi kalvari i anatemit të saj. Ky qëndrim, sigurisht që ishte në sintoni me qëndrimin ndaj autorit të saj, por që paradoksalisht, nuk lidhej me kurrfarë çështje të kritikës, që ai kishte shkruar e botuar deri atëherë.

Pra, për rrethanat e kohës, revista *Kritika*, mbeti jetëshkurtër nga aspekti editorial, por mbetet e vlerësuar për frymën emancipuese dhe moderne/vizionare, që ajo e përcolli tek lexuesi në trajtimin e çështjeve letrare. Do të mjaftonte që kjo revistë të mbetej vlerë e shënuar - edhe vetëm për faktin, si e para revistë e profilit kryesisht kritik në editorinë shqiptare, e njëkohësisht për nga rastësia e vitit të botimit, me botimin e librit - po të parë me shkrime kritike - atij të Mitrush Kutelit: *Shënime letrare* (1944).

Arshi Pipa ka meritën, jo vetëm si botuesi i një reviste të këtij formati, por mbi të gjitha, për vizionet konceptuale që përcaktoi dhe realizoi në shkrimet e saj. Duhet sjellë në vëmendje se, kësaj kohe, edhe pse në kushte aspak të favorshme prej rrethanave të amullisë së pushtimit të vendit, vrehet gjithsesi si sfidë mbijetese e qëndrese, që të qarkullonin prirje e modele të larmishme letrare, shoqëruar këto me debate e polemika të ndezura. Edhe pse në hapësirat e ngushta kulturore e të një vendi të vogël si Shqipëria e asaj kohe, e ca më tepër, në kushtet e smogut dëshpërues/depresiv të luftrave në kontekst global, megjithatë, këtu bota letrare vazhdonte të ruante ritmet e saj, thua sikur ajo të jetonte në oazin e vet të paqte.

Pra, kësaj, letërsia dëshmonte qartazi e pa trandje atë autonominë e saj sovranë/natyrë e të patjetërsueshme, që i takonte

REVISTA "KRITIKA" (1944) E ARSHI PIPËS (Vështruar si paradigmë e kujtesës) nga Ymer Çiraku

gjenetikisht. Dhe prandaj vrehen që të ndeshen në këtë hapësirë letrare njëkohshëm: kryqëzime ndikimesh prej lëvizjeve më të reja letrare europiane dhe prej traditave të tejkaluara e anakronike; risi apo shenja origjinaliteti deri impresionuese - dhe plagjiatura spekulative; lartësime dhe denigrime të natyrës objektive apo emocionale; art elitari e deri estetizant, që nxitej prej frymës krijuese - dhe art pacifist, apo hiper militant, që frymëzohej prej ideve të përkundërta politike të kohës.

Kjo revistë e A. Pipës, deri në çastin e daljes së saj më 1944, duket se ka një parapërgatitje në frymën konceptuale të interpretimeve letraro-estetike, që do të merrte përsipër të trajtonte. E kjo do të lidhej me frymën dhe parapërgatitjen e vet autorit të tyre. I sapo kthyer nga studimet në universitetin e Firences për filozofi (1938-1942), fare i ri, me formim të fortë estetik e letrar, ai dëshmonte përkushtim në fushë të kritikës letrare. Janë disa shkrime më të hershme të tij, të botuara në gazeta e revista letrare të kohës dhe sidomos tek *Shkëndija*, *Tomori*, *Fryma*, ku mund të veçonim ato me titujt: *Për një kritikë letrare*,¹ *Art moral e vetëdije letrare*,² *Kritikë a Polemikë*?³ Këto shkrime të para të tij, sado prej një të riu të sapodiplomuar, dallohen për vëzhgime substanciale e të përditësuar të realiteteve letrare të kohës. Ato dëshmojnë shije të hollë në përzgjedhje e vlerësim, talent dhe inteligjencë të spikatur/lindur, si dhe formim të lartë/sigurt letrar e filozofik. Ky formim, ishte fituar jo sido kudo, por pikërisht në aulat e njohura universitare të Firences (Itali). Kritiku i ri, gjen rastin që t'ua drejtohet veprave të disa prej autorëve nga më të njohurit e letërsisë shqipe si: De Rada, Konica, Fishta, Serembe, Noli, Kuteli, Migjeni...

A. Pipa e ka përcaktuar/projektuar qartazi vizionin e tij për kritikën, çka bie në sy edhe në një nga shkrimet e tij të para me titull: *Për një kritikë letrare*. Për të, kritika ka rolin e saj si vlerësim/matje e produktit

¹ Shkëndija, 1941, nr 2-3, f. 59-61

² Shkëndija, 1941, nr 5-6

³ Kosova, 1942, nr 36

spiritual dhe këtë, ajo duhet ta bëjë me dinjitet, pa e tradhëtuar vetveten - duke bërë pazarin vulgar të kulisave. Ai evidenton kërkesën për një kritikë të orientuar nga interpretimet e letërsisë prej principesh estetiko-historike. Pra, dëshmon se ndjek modelin e kritikës mirëfilli profesionale, e cila, duhet që t'i kalkulojë vlerësimet e veta mbi kriteret rreptësisht dhe vetëm estetike. Sigurisht, duke mos i shkëputur ato vlerësime e klasifikime edhe nga konteksti historik, se ku dhe kur ato vlera janë krijuar e krijohej. Por pa u shkëputur krejt, edhe nga koha e mëtejme, kur ato vlera/vepra do të vazhdojnë të receptohen. Dhe nisur prej këtyre premisash, që procesi letrar shqiptar të mos prezantohet si stanjativ dhe i kalkifikuar, shtron kërkesën e rivlerësimeve. ...*Nuk mundemi të vijojmë ma me pranue verbësisht traditat e arkivave letrare për hatër të disa qyshkeve praktike extra - poetike. Me pranue një flije ose një zvoglim adhurimi për hir të së vërtetës; me guxue me u shprehë pa paragjykime edhe në se në këtë mënyrë i biem ndesh krenarisë son' kombëtare; me depërtue raportet midis poetit e atdhetarit, midis qëllimit e kufinit estetik të arrijtun; shkurt me da shapin prej sheqerit: qe çka duhet me u ba. Iluzionet në fushën kritike janë po aq të damshme sa gjetiu...*⁴ Pra, kërkohet që të bëhen rivlerësime të letërsisë, nisur nga kriteret veçse estetike.

Shkrimi *Shpirti kritik*,⁵ i vendosur në faqen e parë të revistës, ka konturet e një programi të vizionit përmbi kritikën, të cilin, e ka formuluar vet botuesi i saj, A. Pipa. Këtu projektohet e përcillet pikërisht koncepti dhe besimi, që ai ka për lëvrimin e një kritike të atillë, që të sjellë pak rend e ndriçim në pyllin e gjykimeve tona, një kritikë që vlerëson traditën dhe ndjek hap pas hapi prodhimin letrar të kohës, që përcjell në procesin letrar rend e dallim, masë e qartësi, kuptim e vlerë. Është ndjekës i asaj kritike, e cila, nuk shkatërron pa ndërtue ma parë... Pra, studiuesi i ri, ka për yll të

⁴ Cituar sipas: E. Muhametaj; Mendimi letrar shqiptar 1939-1944/7, f. 62

⁵ A. Pipa, rev. *Kritika*, nr 1, T. 1944



tij një kritikë, që e përmbush misionin e saj përmes kompetencave profesionale, përmes ndjekjes sistematike dhe empatisë për letërsinë, që lidhet me konceptin e kritikës me perspektivë.⁶

Tek nr. 2 i revistës, Pipa i kushton një shkrim në trajtë eseje Faik Konicës. Koha provoi se do të ketë disa pika takimi mes karakterit dhe veprës së tyre. Vlerëson figurën e Konicës që u vendos në fronin ma të naltin e mendjes shqiptare dhe si hypi një herë nuk luejti ma... Vlerëson po kështu, aktivitetin e tij kulturor e letrar, që, ndonëse jo e shpeshtë/e dendur, por gjithëherë e ndrrueshme, e freskët. *Kishte tinguj të një mendësjie të ndryshme, perëndimore... e që ma se një herë iu dukshin të çuditshme botës së vjetër shqiptare dhe ishte njeri ekstremesh të mëdhaja, këndeje nuk begendiste, andej nuk falte!*

Për A. Pipën, Konica ishte nga ata personalitete, që i njihte të tëra të fshehtat e stilit dhe që mund të karakterizohej si *i tani stil*, por që megjithëse botoi vlerësime impresionuese në fushë të letrave, potenciali i tij kritik, nuk arriti që të shfrytëzohej sa do të duhej dhe kjo, sepse rezultoi të jetë ende i kufizuar produkti letrar: *Gjithë letërsija shqipe përmbledhet në një grusht dhe jo fort të shtërnguem...*⁷ shkruan ai. Sipas tij, Konica qe *i pari njeri modern i vërtetë ndër shqiptarë edhe sepse puna atdhetare e Faikut, qindron ma tepër te kritika e anës së dobët se sa te lëvdimi i anës së mirë të shqiptarit*.⁸ Po kështu, vlerëson ironinë dhe sarkazmën koniciane, si një *dhuratë hyjnorësh*, që sjell veç vlera të shëndetshme për shoqërinë shqiptare, sepse është e drejtuar nga një qëllim serioz, nga një dëshirë universale.

Këtu ka rastin të bëjë edhe një përfaqje interesante mes dy personaliteteve: Konicës dhe Fishtës, fare të pangjajshëm në vështrim të parë mes tyre, duke dhënë me këtë rast edhe një sintezë përcaktuese të karakterit antropologjik e më gjerë: *Na duket, ndërmjet atyne dy poleve të kombit, qi janë gega e toska, se i pari përmban ma tepër landën, brumin e shqiptarit dhe i dyti, trajtën, frymën. Dhe nëse gjejmë ma të madhin përfaques të gëgnisë te Fishta, ndeshim kulmin e faqes tjetër ... te Konica*.⁹ Sigurisht, që në këtë konkluzion, nuk ndihet ndonjë vlerësim paragjykues: diferencues apo relativizues, rreth tipareve të poetikave dhe shfaqjeve repektive antropologjike. Veçse bëhet e ditur si e pamundur që të shprehet e të përfaqësohet dot e plotë letërsia shqipe, pa njerën apo pa tjetrën. Ato krijojnë harmoninë e së plotës.

Kjo është nga ato teza besojmë mjaft interesante dhe intriguese për t'ua shtjelluar në boshtin tematik të çështjeve të arealit letrar shqiptar. Por që mbetet një *tezë enigmë*, në kuptimin se autori, këtu nuk i hyn argumentit për ta shtjelluar së brendshmi, por që as më pas, në dijeninë tonë, nuk ka patur rast për ta trajtuar. Deri diku, si vijuese e cekjes së kësaj teze, është edhe një shkrim, pikërisht po i kësaj kohe i E. Çabejt, i cili, ndalet mbi veçoritë e epikës së veprës së Fishtës, një shkrim ky i botuar tek revista *Shkëndija*, ku kishte botuar jo pak herë edhe vet A. Pipa. Çabej thekson se vepra e

⁶ Shih: I. Rugova, Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare, T. 1996, f. 169

⁷ Po aty, f. 465

⁸ A. Pipa Faik Konica, rev. *Kritika*, n. 3, 1944

⁹ Po aty



tij (Fishtës)...u bë pasqyra besnike, fytyra e kthjellë e gjithë vërtetësisë etnike, trimërisë së ashpër, burrërisë luftarake, krenarisë raciale, që ka mundur të ruajë gjer sot jeta shqiptare... Kësaj i përshtatet edhe forma e përzjashtme e poemit, stili i të cilit është burrëror e i vrazhdë, gjuha kokërr e larg çdo ëmbëlsie të tepruar...¹⁰ Dhe këtë formë të poemës, Çabej e shikon të ndikuar prej Eposit të Kreshnikëve.

A. Pipa e shfaq edhe në raste të tjera prirjen e vështrimeve krahasimtare mes krijesve e tendencave letrare, shenjë kjo e zotërimit të sigurtë të procesit letrar dhe e kalkulimeve të vlerësimeve më të gjera mbi nivelet e tij. Ai bën përcaktime koncize/ bazike psh mes artit të Nolit dhe Konicës. "Arti për art" mund t'ishite "credo-ja" e një Konice. Formula e Nolit që gjithmonë: "Arti për edukatë", nënvizon ai tek shkrimi: Bariu i popullit.¹¹ Pra, bën me dije atë dallimin e njohur mes artit meditant e artit militant në krijimtarinë e tyre, por pa rënë në pozita paragjyquese/blasfemuese për ndjekësit e kësaj ose asaj prirjeje.

Vështrime krahasimtare hedh edhe mes Fishtës e Nolit. Njeni geg e tjetrin tosk: dy poet e gjenialitetit shqiptar. Prift Fishta e prift Noli. Shqiptar i madh i pari e Shqiptar i madh i dyti. Veltje poliedrike që të dy: të pajisun me kulturë të gjatë, me njohuri të thella, të pajisun dhe me art të madh. Që të dy bisedarë e polemista të fuqishëm... Përveç se shkrimtarë, piktor e arkitekt Fishta, muzikant Noli. Dhe përmbi të gjitha e najtë e pothuaj fuqija profetike e fjalës së tynë, e Verbit të tynë. Fe e Poezi, Zanë e Perëndi: binome të shëjta të shkrime në një monom: Shqipni... Por kur kemi thanë kto nuk kemi precizue si duhet. Fishta me Nolin janë, në një vështrim të dytë, antitetikë. Fishta "gjeni i tokës, shkëmb i tokës dhe shkëmb i shpirtit shqiptar", si e quejt në një mënyrë lapidare Lasgushi. Noli: gjeni i ajrit, za burije n' erë, fatidik kah horizontet e reja të s'ardhmes...¹²

Qysh në fillimet e aktivitetit letrar e studimor, Pipa e ka kuptuar se udha e idealistëve dhe shkrimtarëve, shpesh është e shtruar me gjëmbe, që do ta artikulonte viteve më pas edhe Kuteli tek testamenti i tij. Atje ku jetën e shteteve e drejton makiavelizmi, hipokrizija politike ka tallë e mashtrore gjithmonë idealet ma të naltat njerzore. Dhe parashikon me një apel retorik atë situatë të rëndë që do të ndodhte menjëherë në Shqipërinë e pasluftës: O kohna të republikës së Platonit, ku filozofi drejton shtetin! Ju jeni gjithnji larg! E poezija! Ah! Ajo sidomos, qi asht aq e hajthët, aq ajrore, sa të mos i afrohet valës së betejave politike: mund t' i digjen krahët e atëhere do të bëhet krymb i mjerë qi çdo kambë mund t' a shklasë...¹³

Ne nuk e dimë pritjen e kësaj reviste tek lexuesi i kohës. Nuk kemi të dhëna të referueshme, aq më tepër, që ajo doli në kushtet e turbullta të travajeve të luftës së dytë botërore dhe brenda një qarku të shkurtër kohor – vetëm në pak muaj. Dhe pastaj, vjen koha e përzjashtimit të gjatë të saj nga komunikimi, në vitet e totalitarizmit. Kësaj kohe, i pari që e risjell dhe e vlerëson para lexuesit këtë kontribut, në kontekstin e tërë rrjedhave të kritikës letrare shqiptare, ishte studiuesi Ibrahim Rugova, në studimin e tij të gjerë monografik Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983, me të cilin, ai mbrojti tezën e doktoraturës (1984).

Por kjo revistë, ka rastin e gjykimit të sotëm, tashmë pa korniza kufizuese - për të evidentuar nivelin e saj antikonformist dhe emancipues e vizionar, vlera këto, që i kishin përcjellë para së gjithash e sidomos, shkrimet e botuesit të saj, A. Pipës.

Në ndonjë tekst apo manual, A. Pipa është përcaktuar si ndjekës i kritikës intuitiviste. Këtu është patur me sa duket parasysh interesimi i tij i njohur për filozofi e estetikë, duke u bërë në disa shkrime përcjellës/ referues, sidomos i filozofisë metafizike të

Bergsonit, e cila, artin e koncepton si një metafizikë dhe që procesin e saj të njohjes e realizon përmes intuicionit.¹⁴ Duhet kujtuar se ky filozof, ishte mjaft i njohur dhe i autoritetshëm i kësaj kohe, mik i Ajshtajnit, i zgjedhur anëtar i Akademisë franceze dhe mbajtës i çmimit Nobel (1928).¹⁵ Por gjithsesi, besojmë se duhen marrë me rezerva klasifikimet kategorike, ku në këtë rast, tek shkrimet kritike të A. Pipës, mund të ketë patur ndikimin e vet fryma eseistike në disa prej tyre. Kjo mund të ketë ndodhur me sa duket për t' i çliruar ato nga gjuha e thatë e për t' i bërë më tërheqëse për lexuesin. Këtu nuk përzjashtohet, nga aspekti i veçorive të diskutit ligjërimor, as ndikimi që mund t' i vinte autorit të tyre prej muzës së poezisë, e cila, e kishte pushtuar qysh aso kohe zemrën e A. Pipës. Por duhet kujtuar se në rrethin e atyre shkrimeve, nuk mungojnë edhe parashtrimet vertikale mbi tekste e shqyrtuara letrare.

Pra, mund të konstatojmë se modelin e kritikës intuitiviste, në fakt, nuk e ka si prirje/ tendencë themelore të tij: as në shkrimet kritike të viteve '40, e aq më tepër pastaj në ato të mëpasmet, të cilat, shquajnë për zotërim dhe aplikim të koncepteve të thella teorike folozofike e letrare, si dhe me parashtrime e interpretime të karakterit filologjik, kulturoro-historik e tekstologjik. Mjafton të kujtojmë psh studimin e tij të gjerë monografik mbi poezinë e De Radës, si pjesë e Trilogjia Albanika, botuar më 1978. Padyshim që kjo është një vepër jete dhe mbetet nga interpretimet më të thella rreth veprës deradiane, në saj të hulumtimit nëpër burime të reja dhe të aplikimit të metodave adekuate interpretuese të asaj veprë. Kryevepra e De Radës Këngë të Milosaut, apo margaritari i poetit, siç e quan atë në një nga shkrimet e tij të para,¹⁶ shqyrtohet si një univers letrar, i konceptuar brenda projektit të poetit arbëresh të romanit lirik të dyfishtë, e prej këtej: të ndërtuar/organizuar – brenda një strukture binare, një tezë kjo e vijuar për t' u rimarrë edhe nga studiuesit e mëpasëm.


Ky studim monografik i A. Pipës mbi veprën poetike të J. De Radës, do të mbetet një nga studimet tejet të thelluara/sofistikuara në vëzhgimin, në interpretimin dhe në rindërtimin e poezisë deradiane, sidomos e vështruar kjo krijimtari në amëzën/frymën italo-shqiptare dhe në rimarrjet ciklike e gërshetuese të saj – e vlerësuar si shenjë e një konceptualiteti prej tërësie, prej universi letrar të pa cak, të pafund.

Revista Kritika kujtohet me vërim, si e para revistë shqiptare e orientuar posaçërisht për nga lëvrimi i kritikës letrare, por edhe si projekt i aktivitetit dhe përgatitjes të një kritiku e personaliteti të shquar në kohët e mëpasme, sikundër do të ishte Arshi Pipa.

¹⁴ Shih I. Rugova, vep. e cituar, f. 170-171

¹⁵ Didier Julia, Fjalor I Filozofisë, Sh.B. Enciklopedike, T. 1994

¹⁶ A. Pipa, Vepra atdhetare e poetike e De Radës, Bashkimi i kombit, T. 01.03. 1944



Botim i ri nga Minerva

NJERIU MË I PASUR NË BABILONI

nga George S. Clason

Begatia e vendit varet nga begatia financiare personale e secilit prej nesh si individë. Ky libër ka si subjekt suksesin personal të secilit prej nesh. Suksesi nënkupton arritjet si rezultat i përpjekjeve dhe aftësive tona. Përgatitja e duhur është çelësi i suksesit tonë. Çka bëjmë nuk mund të jetë më e mençur se çka mendojmë dhe niveli i të menduarit varet nga niveli i të kuptuarit.

Ky libër që ofron kura për kuletat e zbrazura është quajtur një udhërrëfyes për njohjen financiare. Dhe, me të vërtetë, ky është qëllimi i tij: t' u ofrojë atyre që aspirojnë suksesin financiar një këndvështrim që do t' i ndihmojë për të fituar para, për t' i ruajtur ato dhe për t' i shumëfishuar.

Në faqet që vijojnë do të kthehemi pas në kohën e Babilonisë, djepi i parimeve bazë të financës që njihen dhe aplikohen edhe sot në mbarë botën.

Autori uron nga zemra lexuesit e rinj që ky libër të jetë për ta një burim frymëzimi, siç ka qenë për shumë të tjerë në mbarë vendin, në mënyrë që të mund të rrisin llogaritë bankare, të shtojnë sukseset financiare dhe të kapërcejnë vështirësitë financiare që hasin.

Për drejtuesit e biznesit që i kanë shpërndarë këto histori aq bujarisht mes miqve, të afërmeve, punonjësve dhe bashkëpunëtorëve, autori gjen rastin që të shprehë mirënjohjen e tij. Nuk ka mbështetje më të fuqishme sesa ajo prej njerëzve praktikë që çmojnë mësimet e këtij libri, sepse ata vetë kanë arritur suksese të rëndësishme duke zbatuar pikërisht parimet që rekomandon autori.

Babilonia u shndërrua në qytetin më të pasur të botës së lashtë, sepse qytetarët e saj ishin njerëzit më të pasur të kohës së tyre. Ata e çmonin vlerën e parave, u përmbaheshin parimeve të shëndosha financiare për fitimin, ruajtjen dhe shtimin e tyre. Ata siguruan për veten atë që dëshirojnë të gjithë... të ardhura për të ardhmen.

G. S. C.

Përktheu Arben Shehu ISBN 978-9928-265-81-4
Çmimi 900 lekë 160 faqe

¹⁰ Përmbledhja Gjergj Fishta, Sht. botuese.Luarasi, T. 1941

¹¹ A. Pipa, Kritika, T. 1944, nr.2

¹² A. Pipa, Kritika, F. S. Noli "Mall e brengë...", T. 1944, nr 1

¹³ Po aty

I

Tashmë është e njohur se letërsia nuk është shkencë nga se për hartimin e veprave përkatëse letrare përdoret si materie kryesore gjuha poetike dhe se teksti letrar synon sa më shumë kuptime. Teksti i natyrës shkencore synon njëkuptimësinë, përkufizimin, saktësinë. Për t'ia dalë kësaj edhe për shkencëtarin, edhe për shkrimtarin, është e domosdoshme dije sa e thellë aq e gjerë dhe përkushtim i madh në punën që bën.

Pra, për shkrimtarin janë të domosdoshme njohuritë e mirëfillta për letërsinë, për natyrën dhe llojet e saj. Ai duhet ta njohë sa më mirë traditën letrare, qoftë në rrafshin kombëtar, qoftë ndërkombëtar. Sa më shumë që shkrimtari e njeh këtë traditë, bëhet i vetëdijshëm për zgjerimin e përhershëm të njohurive për artin e fjalës, po dhe për fusha të tjera të veprimtarisë së njeriut. Kjo gjë mundëson përfitim e veprave të arti që do t'u qëndrojnë kohëve. Në punimin "Piksime Estetike mbi zëje të fjalës" (i nënshkruar vetëm me shkronjën X) Fishta vë në dukje se në artin e fjalës, si dhe në çdo mjeshtëri tjetër, kërkohet përgatitje e përvojë dhe një përkushtim i madh për përfitim e veprave me vlera të rëndësishme, që do të shtegtojnë pastaj nëpër breza njerëzish, duke u qëndruar kohëve të përdhshme!

Domosdoja e njohjes së natyrës së letërsisë dhe të traditës letrare, përkatësisht të veprave të krijuarve më të mëdhenj paraprakë, dëshmohej edhe nga ky mendim i poetit tonë të shquar, Lasgush Poradecit: "Unë jam *Bücherwurm* – krimb librash – që rri ditën e natën mbi libra". Pra, arti i Poradecit, siç ka ndodhur dhe me të gjithë shkrimtarët e rrafshit të tillë, ishte rrjedhojë e leximit, e njohjes të letërsisë sonë dhe e ngritjes së vijueshme të tij si krijues.

Për një varg shkrimtarësh tanë dija e mirëfilltë, qoftë për natyrën e letërsisë, qoftë për njohjen e traditës letrare, sikur nuk përfillet, gjë që ka shkaktuar edhe zbritjen e cilësisë së letërsisë sonë e të llojeve të saj. Kjo dukuri e kishte shqetësuar në kohën e tij edhe poetin tonë të madh dhe njërin nga estetët më të shquar, Fishtën³, prandaj thotë me ironi: "Due me thënë, se per çdo zanat, qi do me kapë nieri, duhet një farë përgatitje gjithkund [...]. Vetem është një zanat, qi në Shqypni s'lypë kurrfarë përgatitje: letërsija!"⁴.

Disa nga shkrimtarët tanë (mjerisht edhe disa nga ata që kinse merren me studimin e letërsisë dhe me kritikë letrare) ende nuk e dinë atë që pati thënë Jurij. M. Lotman: "Tashmë moti është futur në përdorim krahasimi i artit me jetën. Mirëpo, vetëm tash po bëhet e qartë sesa shumë të vërteta ka në këtë krahasim, i cili dikur ka tingëlluar si metaforë. Me siguri mund të thuhet se midis gjithë asaj që ka krijuar dora e njeriut teksti artistik në masën më të lartë ka ato cilësi, të cilat kibernetistin e nxisin të merret me indin e gjallë"⁵.

Gjuha poetike e një veprë të mirëfilltë letrare nuk vjetrohët, por vazhdon komunikimin nëpër breza. Ajo i ofron lexuesit një shumësi sa më të madhe kuptimesh; e vë përballë mundësive të shumta, të thuash të pafund, ku teksti poetik e përlligj qenësinë e vet. Me cilësi të tilla ai nxit komunikim më të thellë e më të mirëfilltë dhe bën ndikim estetik më të madh në marrësinë⁶. E tillë nuk është e nuk mund të jetë gjuha e komunikimit dhe e kuvendimit të përditshëm (të rëndomtë), që ka për qëllim të sjellë një kuptim të vetëm, të jetë shprehje një kuptimore.

Nga shumësia kuptimore që shkakton teksti poetik tek marrësi, i mundëson atij jo

¹ Gjergj Fishta, *Piksime Estetike mbi zëje të fjalës*. Në "Hylli i dritës", Vjeta VIII, n. 7 – 8, Shkodër 1932, f. 396.

² Petraç Kolevica, *Lasgushi më ka thënë... Shënime nga bisadat me Lasgush Poradecin. Botimi i dytë i plotësuar*. "Toena", Tiranë 1999, f. 96.

³ Shih për veprën letrare të Fishtës librin tim *Vepër e genies dhe e qenësisë sonë. Vëzhgime mbi artin poetik të Fishtës*. "Shpresa" & "Faik Konica", Prishtinë 2003.

⁴ Gjergj Fishta, *Piksime Estetike mbi zëje të fjalës, pun. i përm.*, 396. Shih dhe Atë Gjergj Fishta, *Piksime estetike mbi artin e fjalës. Me një punim hyrës nga Anton Nikë Berisha*. Shpresa, Prishtinë 2003.

⁵ J. M. Lotman, *Struktura umetni kog teksta*. Nolit, Beograd 1976, f. 384.

⁶ Shih rreth rëndësisë së ndikimit estetik të veprës letrare në marrësinë në veprën time *Estetika dhe estetika e letërsisë. Tekst për studentë*. (Bashkë me Labinot Berishën.) Faik Konica, Prishtinë 2018.

PSE ROMANI "KARVANI I BARDHË" I AZEM SHKRELIT NA PRISH PUNË?

Nga Anton Nikë Berisha


Heshtja që u bëhet disa veprave letrare të disa autorëve tanë e përlligj këmbëngulësinë kryeneçe për ruajtjen e vlerave të pakta ose të rrejtshme në letërsinë tonë edhe në kohën e tanishme, duke krijuar kështu një rrafsh të dëmshëm, të shpifur dhe me pasojë, në vend të përfilljes, dhënies përparësi vlerave poetike, ngritjes dhe pasurimit të mirëfilltë të artit tonë të fjalës.

vetëm të përcaktohet për ndonjërin ose për disa prej tyre (kuptimeve), por e nxit të krijojë e të shumëzohë brenda vetes edhe kuptime të tjera të mundshme, që lidhen me botën dhe me shpirtin e tij. Asnjë lloj teksti që nuk i ka këto cilësi, as një lloj tematike ose motive që e cilësojnë tekstin përkatës, nuk mund të shkaktojnë kënaqësi shpirtërore. Letërsia është art i fjalës art dhe para së gjithash është shtjellim gjuhësor poetik dhe shumësi kuptimore. Pra, magjia e fjalës, siç thotë Stevenson, është një ndër cilësitë themelore që duhet të zotërojë një shkrimtar⁷.

II

Në çastin kur shkrimtari i jep dorën e fundit një veprë të vet, kur bindet se teksti i saj shpreh atë që ai e ka menduar dhe duhet të jetë e tillë, ua "hedh" në duar lexuesve, e boton. Mirëpo, në rrjedhë të moteve, ose edhe pa kaluar shumë kohë (këtu s'ka as nuk mund të ketë rregull), ai bindet se veprës

⁷ Jorge Luis Borges, *Ligjërata*. Përktheu nga frëngjishtja Feride Papeka, Pika pa sipërfaqe. Tiranë 2013, f. 10.



përkatëse duhet t'i shtohet ose t'i hiqet diçka. Së këndejmi, përcaktimi që t'i kthehet përsëri veprës së vet të dikurshme dhe ta përpunojë, është i natyrshëm dhe, në të shumtën e rasteve, ka dhënë fryte të rëndësishme.

Arsyet për ndërrim dhe mënyrat e ndërrimit të veprës përkatëse te secili krijues janë të ndryshme, po dy prej tyre duhet të jenë më kryesoret:

a) ngritja e rrafshit artistik të veprës përkatëse

b) bërjen e saj më të komunikueshme dhe mundësinë e ndikimit më të madh estetik në marrësin.

Ngritja e cilësisë artistike të një veprë letrare nënkupton, para së gjithash, ngritjen dhe pasurimin e shtjellimit gjuhësor poetik, të sistemit të të shprehurit. Vetëm përmasa artistike është përbërësi që i jep vlerën kryesore një krijese letrare dhe e bën atë pronë të kohëve.

Pra, struktura e tillë gjuhësore shprehëse mundëson shqiptimin më të ndërliqshëm të dukurive të botës e të rrjedhave të jetës së njeriut; ballafaqimin e njeriut me vetveten



dhe me të tjerët, me të panjohurën dhe me të papriturën. Me fjalë të tjera, vetëm nëpërmjet mesazhit poetik, që është fryt i shtjellimit të tekstit, vepra letrare është në gjendje të bëjë një ndikim sa të thellë aq edhe të gjithanshëm estetik në marrësin.

Gjithë ajo që thashë më lart lidhet pandërmjetësisht me romanin e Azem Shkrelit "Karvani i bardhë", varianti i vitit 1996.

Vendimi i Azem Shkrelit t'i kthehet romanit "Karvani i bardhë", të botuar për herën e parë më 1961, pas 30 vjetësh, nuk është i rastit. Këtë ai e vë në dukje në shënimin hyrës të variantit të dytë:

"Sa isha nxënës i Shkollës normale në Prishtinë, kisha botuar një libër me poezi. Kujtoja se mund të shkruaja edhe roman dhe shkrova 'Karvanin e bardhë'. Roman nuk ishte, ishte një skicë për roman. Aq mund të bëja atëherë.

Lexuesit e quajtën librin tim roman dhe e pëlqyen. Kritika po ashtu. Nuk e patën vështirë ta quanin roman të mirë, ta lavdëronin e ta shpërblenin. Ne shkrimtarët në Kosovë nuk kishim botuar dhe shumë romane me të cilat ta krahasonim.

*Me botimin, as me lavdërimin e asaj skice për roman, jo që nuk u qetësua, por u ndez edhe dëshira ime ta shkruaja edhe një herë 'Karvanin e bardhë'. Tani ai u shkrua.*⁸

Edhe pa këto fjalë të autorit, lexuesi i dy varianteve të "Karvanit të bardhë" – të vitit 1961 dhe të vitit 1996 – nuk e ka vështirë të thotë se ato janë dy vepra të pavarura. Ndryshojnë mes veti, edhe si sasi, edhe si cilësi. Sidomos në rrafshin e shtjellimit, si vlerë, si mesazh poetik, varianti i dytë ngrihet për shumëçka mbi të parin.

Në variantin e dytë të romanit autori shtoi dhe njësoi një varg gjërash, ose ato të vjetrat i trajtoi nga këndvështrime e mënyra të ndryshme; i shprehu me një gjuhë të zgjedhur dhe të pasur; i shpalosi më thellësisht botët e personazheve e marrëdhëniet shoqërore dhe në këtë mënyrë krijoi një veprë me vlera të mëdha, që e bëjnë atë ndër romanet më artistike të shkruar në gjuhën tonë.

Në rrjedhën e shtesave duhet përmendur sidomos personazhet: Laken e Tahir Talit dhe serbin, Jagoshin, të birin e Kërst Kapllarit, të cilët në disa pikë kanë kushtëzuar ndërrimin e shtjellimit të romanit dhe rrjedhën e objektit poetik. Edhe personazhet e variantit të parë (ata ruajnë, edhe emrat, edhe disa nga tiparet kryesore që i kanë në variantin e parë të romanit) në variantin e dytë kanë pësuar ndryshime.

III

Dy çështje kushtëzojnë ndryshimet e mëdha midis këtyre dy varianteve të romanit "Karvani i bardhë":

a) gjuha poetike, përkatësisht sistemi i të shprehurit poetik dhe

b) qasja dhe shqiptimi i ndërliqshëm i botës së brendshme të burrave të ngjuar në shpellë dhe i marrëdhënieve shoqërore, që e kushtëzuan dhe e kushtëzojnë atë botë.⁹

⁸ Shënimi është shkruar në dhjetor të vitit 1995, në Prishtinë.

⁹ Më 2006, kur e lexova dy herë romanin "Karvani i

Si sistem gjuhësor shprehës varianti i dytë i “Karvanit të bardhë” është përpunuar me përkushtim e me dije të lartë dhe dëshmon cilësi kulmore poetike.

Fjala e Azem Shkrelit ka, edhe drejtpeshim, edhe natyrshmëri. Përshkrimet dhe imazhet poetike, të përfutuara me anën e gjuhës së zgjedhur dhe të pasur, janë mjeshtërore e pushtuese, shpesh tronditëse, që dëshmojnë aftësinë e madhe krijuese të autorit.

Për të konkretizuar këtë që thashë do të mund të sillja shumë shembuj, që i ndeshim në secilën faqe të romanit. Mirëpo, po sjell vetëm disa prej tyre, që mjaftojnë të vërehet sa veçantia, aq edhe bukuria dhe qenësia e të shprehurit poetik dhe shumësia e mendimeve që dalin nga struktura përkatëse e tekstit.

“Mes tyre, brenda në të, do të hynte dalëngadalë fortësia e gurit dhe ftohtësia e harrimit” (f. 17)

“[...] atij i vuri dreqi kërpeshin herët dhe i priu mes tufës së vet...” (f. 45)

“Udha më e mençur është ajo që bëhet për së dyti. Ia di fillin, orën, bërrylat. Mirëpo kohë nuk ka për korrigjime, koha ecën, udhët ecin. Të shkelin dhe shkojnë.” (f. 61)

“Ai (Dyli) kishte marrë, marrë jo por rrëmbyer, më shumë se ç’i përkiste nga guximi.” (f. 94)

“Thanë u vra, thanë vdiq lugati i maleve [...] Kishte ndërruar gëzof. E dinte se e presin llogari të vështira. Gjaku me gjak lahet, thonë. Ai s’kishte gjak sa kishte për të larë. U rras nën sqetullën e pushtetit të ri.” (f. 96)

“Farën e ligë nuk e prek as breshëri as bryma.” (f. 121)

“Aty nuk ishin në zgorin e çukapikut, siç u bëhe ndonjëherë se ishin, ishin në bark të një kështjelle gjigante në të cilën mund të rrinin pa therrë në këmbë. Ishte në kokë therra e cila u shponte atyre kohën ditën dhe qetësinë e gjumit natën.” (f. 177)

“Ujë pa va nuk ka, ka thënë ai që ka thënë. Njeriut i kanë dhënë durimin pse i duhet. Si ajri, si buka, si gruaja e mirë...” (f. 190)

“Zgërlyqi i shpellës ia duk më i thellë, terri që e ndante nga shokët, më i gjatë e më i shpeshtë, ai po e prekte me dorë atë terr, ai po e shtynte me trup si borë të zezë e të dendur t’i çilte udhë vetes.” (f. 221)

“Të tjerë jemi ne, të tjerë. Rugovasi nuk e lut vrasësin të mos e vrasë, por vrasjen të mos e ligështojë.” (f. 232)

Ajo që e bën të mëvetësishëm sistemin gjuhësor shprehës në këtë roman është ballafaqimi dhe kundërvënja e mendimeve dhe e dukurive. Asnjë shkrimtar ynë si Azem Shkrelit nuk e ka ngritur kaq lart dhe nuk e ka pasuruar kaq shumë shqiptimin e tillë kontrastik në strukturën e tekstit poetik. Kjo mënyrë e të shprehurit kushtëzon, edhe vështrimin, edhe njohjen më të plotë të botës së brendshme të personazheve e të marrëdhënieve shoqërore të mjedisit ku ata janë rritur dhe veprojnë.

Kjo strategji e shqiptimit poetik përbën thelbin e rrëfimit dhe të shprehurit në roman dhe është e pranishme në çdo faqe, për të mos thënë në çdo pjesë të tekstit.

Të shprehurit kontrastik në tekstin e romanit nuk i nënshtrohet ndonjë rregull ose modeli, por bëhet në mënyra të ndryshme e me mjete të ndryshme. Këtë parim krijues shprehës autori e zbatoi edhe në poezinë e tij¹⁰.

Shembujt që po i sjell në vijim përligjin vetëm disa nga mënyrat e shqiptimit të tillë poetik në roman.

“Mjeria i rrinte më mirë dhe të tillë e la. Nuk më duhesh as ti, as vdekja jote, deshi t’i bardhë”, variantin e dytë, me qëllim që ta shijojë gjuhën poetike dhe stilin e veprës, më lindi ideja të shkruaja një punim me titullin “Rreth një romani që na prish punë...”. Pas tetëmbëdhjetë viteve po e përmbysh idenë – hartimin e punimit.

¹⁰ Shih Azem Shkrelit, Azem Shkrelit, Rrënjë të gurta. “Shpresa – Kuvendi Salezian”, Prishtinë 2001. Botimi i dytë i rishikuar, Shtëpia e Kulturës, Pejë 2012, botimi i tretë Argeta LMG, Tiranë 2023.



thoshte, ndërsa po e ngrinte nga supi, por u tremb mos thoshte më shumë se ç’duhej” (f. 63)

“Të mejtuar e të palëvizur, ata flitnin me flakëzat e verdha të prushit të cilat po digjeshin si lëngatë” (f. 67).

“Sapo vërriu dy herë me këthizën nëpër këmbë, e ëma që donte të dinte për ç’bimë po e lidhte të ardhmen e gjatë e të pasigurt të së vesë së Mehmet Ujkës, futi këthinë nën akuj të gurrës, e rrotulloi tri herë nën vrushkull dhe i ra pëllëmbë prapanicës: Ja rritu ja mbytu, ja rritu ja mbytu, ja rritu ja mbytu!

Fëmija zgjodhi të parën. U dogj dy ditë në zjarmi, mori veten dhe lidhi shtat shpejt. Lidhi shtat se e veja e Mehmet Ujkës i dha kullosh të ulkoje. Jo, por qumësht të dhisë së egër i paskësh dhënë. As qumësht dhie, as kullosh të ulkoje, por gjak sokoli të malit” (f. 77).

“Andaj, jji sa të jesh, mos jji i paqenë dhe kurrkushi. Dikushi jji, jo kërmill, jo dru shtogu, jo bark që han bukë e bën bukë” (f. 80).

“Zbriti Dyl Mehmeti nga malet, u dorëzua kaçaku i malit, cubi i Mehmet Ujkës u zu i gjallë e i vunë prangat. S’i vunë prangat, por e mbyllën, s’e mbyllën, e mbyllën që ç’ke më të se njerëz ka vrarë, të vetët i ka vrarë, s’i dhemb serbit dhembja jonë, ja që nuk e mbyllin, ja që e mbyllin se u duhet i mbyllur, këta e mbajnë në thark ta zbusin që ta heqin pastaj përlaku...” (f. 88).

“Janë njerëzit që ua kanë mësuar egërsinë kafshëve. Jemi ne që i kemi mësuar të tremben, të ikën ose të na vërsulen. Janë të pabesa se i tremben pabesisë sonë” (f. 142).

“Qëndroi mbi gacat që po kërcitnin. Kërcitja e tyre kot që paralajmëronte ndryshimin e tij një kohë të gjatë. Edhe koha ishte jashtë dhe ata nuk do të dinin sa do të zgjaste ndarja e tyre nga moti e nga koha. Ato po rridhnin pa praninë e tyre” (f. 172).

“Vetëm fytyrës së fjetur të guas nuk i shihet djallëzia. Vetëm të fjetura, bukuria e

tyre, e atyre që e kanë, i gjason bukurisë së engjëllit. Te kjo femër janë shëmbëllyer që të dyja. E dyta ia mbulon për mrekulli të parën. Ia mbulon po nuk ia fsheh të tërën. Kështu i rri më mirë. Të bukurave u falet diç. Të hieshmeve u falet ndonjë e pahieshme se e zbusin, e zbukurojnë” (f.180).

“A do ta bëje ti ndryshe femrën? Nuk do ta bëje. As unë. As tjetri. Nuk mund t’i shtosh as t’i mungosh. Kur të duhet, të gjitha i ka. Kur s’të duhet, asnjë nuk i bën” (f. 222).

“Kishin ardhur rugovasi t’i tregonin çetnikut të Beranës duhinë e zjarrin e armëve të dëgjua të Rugovës e jo të merrnin dhen e dhi” (f. 235).

“Kjo luftë ka pasur çmos, ka pasur edhe të këtitillë! Këta njerëz kanë pasur një trup e pesë krerë, edhe pesë krerë kanë fshehur nën ketë kapelë” (f. 261).

Personazhet e variantit të dytë të “Karvanit të bardhë” ballafaqohen më shumë dhe më ashpër me vetveten dhe me vetminë, me fatin e tyre e të shokëve me të cilët frymojnë në shpellën e gurtë. Veprimi i tillë ua zvetënon të tashmen deri në keqardhje, por ua errëson edhe të ardhshmen. Pra, autori në variantin e dytë të romanit i vë ata përballë më shumë fakteve, i shpall mëdyshjet më të mëdha dhe shprishjet shpirtërore më të thella.

Shpalimi i këtitillë nuk ngjet vetëm me krye personazhin, njeriun që, siç thuhet, e ka vrarë koha, Dyl Memetin, por dhe me personazhe të tjerë; ata janë “pasuruar”, qoftë për virtyte, qoftë për vese dhe të këqijat që i kanë ose që i kanë dëshmuar në të kaluarën, ose i dëshmojnë në çaste të jetës në shpellë.

Përmes asaj që ndodh në “gojën e shkëmbit” dhe të disa ngjarjeve që “ndëgjojnë” e “vinë” nga jashtësia e saj, autori ia ka dalë të japë një tablo të qenësishme të jetës e të fatit të njerëzve në Rugovë dhe më gjerë, sidomos në rrafshin atdhetar e të mbarësisë së botës shqiptare, të domosdoshë që njeriu ynë të mësojë nga pësimet, në veçanti përballë të keqes që popujt e tjerë i shkaktuan dhe i shkaktontin. Po sjell disa shembuj.

“E kemi krisur kur duhej e kur s’duhej, kumos e për këmos e kemi krisur të shkretën.” (f. 33)

“Nuk jemi trima pse jemi trima, po pse nuk guxojmë të jemi tutca.” (f. 34)

“Vramë!, i thashë se ne shqiptarët trimërinë për njëri tjetrin e kemi!” (f. 126)

“A nuk u shkulëm e s’u faruam mjaft duke u hurrur mes veti?!” (f. 126)

“[...] ne kemi njerëz që shiten e njerëz që shtiren si ky oficeri i Arif Cubit, njerëz që veshin, jo uniformë, po edhe fytyrë e lëkurë qeni për pak para a pushtet.” (f.168)

“Yni, pra, i kujt tjetër! Askush si yni nuk di të japë për të huajin...” (f. 169)

“Ne gjithmonë jemi bijtë e vonimit, vonimi është yni. Është dashur ta vëmë gishtin në kokë më herët, shumë më herët.” (f. 248)

“Mirëpo për të më bërë futë e katran më kanë bërë të zezat e shqiptarëve të mi, foli Bekë Rrushi.” (f.260)

“Kuç na polli, Cuko! Kuç! Sepse u ethëm me Kremlin!” (f. 264)

“Na hyri fara kopile! Kopili i kuç na hyri, tani ec e shkule!, shtoi nëpër zhurmë të kazanit Haxhi Mani. As nipat tanë nuk do ta shpërlajnë flligën që ia veshëm vetes!” (f. 264)

Me sistemin e këtitillë, sa të pasur po aq të veçantë gjuhësor poetik, me format e shumta dhe të natyrshme shtjelluese, të veçantisë së lakimit të gjuhës sonë shqipe, të shprehurit të pasur frazeologjik, figurativ dhe metaforik, përmes të cilit krijohet një botë skajshmërisht e mëvetësishme dhe e ndërliqshme, romani i Azem Shkrelit “Karvani të bardhë” – varianti i vitit 1996, prish shumë punë! Pas leximit të tij e ke vështirë t’u qasesh e t’i lexosh disa romane (edhe vepra llojesh të tjera letrare), që përftohen me një gjuhë të zakonshme, e cila është e komunikimit të përditshëm; një leksik të kufizuar e të rastit, në qenësi gazetaresk, i cili qëllim kryesor ka kumtimin, informatën; bëhet përshkrimi i ngjarjeve e jo përfitim i tyre përmes rrëfimit poetik të menduar, nga teksti dalin porosi e jepen këshilla, që nuk lidhen me natyrën e artit të fjalës, me letërsinë.

Veprat e këtitilla mjerisht ngritën në qiell (nga motive miqësore ose të tjera) duke përmendur tematikën e motivet si vlera të rëndësishme e aktuale, po duke harruar se letërsia nuk është tematikë e motivikë, po strukturim gjuhësor shprehës poetik dhe se kryesorja në artin e fjalës është si thuhet dukuritë e jo çka thuhet.

Duke folur për poezinë e Azem Shkrelit shumë vite më parë pata shkruar: “Poezia e Azem Shkrelit me strukturën e veçantë tekstore poetike, me shumësinë dhe thellësinë kuptimore që ndërthrin në vete, me nëntekstin e pasur poetologjik dhe me mundësi të shumta të ndikimit estetik, bën njëherë ndër pjesët më artistike të poezisë shqiptare në përgjithësi. Si e këtitillë kjo është dëshmi e denjë e pasurimit poetik të poezisë sonë. Them kështu duke pasur parasysh faktin se krijuesi letrar që shpreh nivelin më të lartë të gjuhës poetike, shpreh nivelin më të lartë të vetëdijes artistike kombëtare¹¹. Azem Shkrelit këtë vetëdije e dëshmoi dhe me romanin “Karvani i bardhë” (Varianti i dytë), me tregimet dhe me vepra dramatike. Kur kësaj i shtojmë një ndër mesazhet e rëndësishme, që po e shpreh përmes mendimit përmbledhës të personazhit, Dyl Mehmeti: “Ndihmoji njeriut të mbetet njeri!” (f. 267; mendim që e ka bazën në filozofinë e Hegelit), që shtrihet në dy rrafshje: në atë kombëtar, shqiptar, dhe në atë ndërkombëtar, njerëzor, atëherë ky roman i Azem Shkrelit bëhet shumëfish i rëndësishëm.

Prishtinë, shkurt 2024

¹¹ Shih studimin tim Poetika e fjalëve të gurta. Qasje veprës letrare të Azem Shkrelit. “Argeta – LMG”, Tiranë 2011.

Për të krijuar një distopi shkrimtarit shpesh i duhet që të gjejë mesin, jo utopinë e vendit të cilin e shndërron, por këtu, pyetemi, nëse kjo është shkathtësi e papërsëritshme e autorit të romanit "Arratisja e fundit e Baltazar Ketës", Agron Tufës, apo në të vërtetë ai vetëm sa ka 'hapur' realitetin. Apo, paradoksalisht, autori Tufa me këtë të fundit ka bërë atë që "nuk bën të emërohet". Por, atëherë lind një pyetje krejt e qëllim të këtu: a është e fundit, kjo arratisje, apo si që thotë personazhi kryesor i këtij romani, ai do të kthehet përsëri dhe përsëri.

Sipas paratekstit të romanit "Arratisja e fundit e Baltazar Ketës" marrë nga Një mijë e një net, bota në këtë roman është një skëterrë e cila gjen shpëtimin e saj nga një mal tjetër, i cili e ruan këtë skëterrë me stuhinë e përhershme në të, e aq më shumë për të zbutur zjarrin e botës ku jemi. Paratekst që e paraprinë dhe e përgatitë lexuesin se do t'i shfaqet një botë në pamundësi si një mekanizëm tunelesh krimi, ligësish dhe çnjerëzoreje. Apo që i është shfaqur dhe vazhdon t'i shfaqet njeriut në tërë historinë e tij, tërë kohën. Por, kjo shfaqje e kësaj bote tonë, nuk është nga larg, as nga maja e Mount Everestit, është pikërisht mospërmasë saj, është e shfaqur mishëruar në të si qytetarë të saj, dhe me vullnetin për vazhdimin e llojit, të paracaktuar nga evoluimi njerëzor, e që është vetë dëshira për jetë, saktësisht nisur prej një garsoniere 'morg' në mes të Tiranës, e deri tek vetë Mount Everesti.

Dhe, gjithnjë duke u ndalur në këtë paratekst, do të thotë "njerëzimi ka shpëtim nga skëterra që e jeton për çdo ditë të dhënë, pikërisht në një lloj harrimi të përhershëm tutje, në malin e radhës, në stuhinë e gjithëkohshme". Apo, që në të kundërtën e kësaj ironie, është i paracaktuar, pre e zjarrit të tij, peng i ligjeve të kësaj skëterre dhe aq më shumë mëtonjës i saj, në tërë luftën e të gjitha "llojeve për mbijetesë", e ku tjetër, përpos, brenda kësaj skëterre.

Por, para se të lexojmë "Arratinë e fundit të Baltazar Ketës", le të ndalemi tek rëndësia e këtij romani. Sepse kur në vetëdijen tonë kolektive mbi letërsinë flasim për të jashtëzakonshmen dhe kulmoren e letërsisë sonë, dhe aq më shumë kur flasim edhe për romane të rëndësishme për vetë letërsinë tonë, ne ikim në një pikë "pajtimi", në një pikë të pamohueshme, të padysueshme, si për autorin si për veprën, ikim pra qysh në fillet e vetë letërsisë sonë, diku ku nuk mund të krijojmë hamendësime për përkatësi e klanizim të letërsisë. Nuk kemi një ndjesi pajtimi me arritjen bashkëkohore të kësaj kulmoreje të letërsisë, qoftë edhe si mundësi, apo qoftë edhe si mishërim i vërtetë i saj. Kur flasim për veprat e rëndësishme, apo thënë saktë për veprat më të rëndësishme të letërsisë sonë, ne flasim për tema të mëdha, gjigante, gjithësi historike, dhe gjithësi të dëshmuara jashtë sistemit tonë letrarë, apo gjithësi të pranuar përmes shitjes së tyre, sikur kjo masë shpirtërore, apo thurje si masë shpirtërore matet, e jo, që lexohet. Si është e mundur të injorohet një vepër si "Arratia e fundit e Baltazar Ketës" nga Agron Tufa?, në arritjen e saj, si një kulminacion i letërsisë shqiptare bashkëkohore. Kjo mund të na sjellë në dy përgjigje të menjëhershme, moskuptimin e saj, e që është pamundësia e përballimit të kësaj katedraleje prej shpirti të letërsisë, apo mos përkatësinë e saj në këtë skëterrë, pikërisht për shkak të mrekullisë letrare që është.

"Arratia e fundit e Baltazar Ketës" roman, nëse jo më tutje, nën krizën e cekur të leximit mirëdashës të letërsisë bashkëkohore, që prej Kadaresë, tek Besnik Mustafaj e deri tek Tufa, ndër të tjerë, së paku në këtë lexim është një nga veprat më të rëndësishme të letërsisë shqipe. Dhe duke pas thënë këtë duhet numëruar edhe arsyet e kësaj thënie. Por ajo nuk do shumë përpjekje, duke qenë se është pararojë e shoqërisë shqiptare në Shqipëri, në të gjitha drejtimet, orientimet, dhe aq më shumë mekanizmat e organizimit të saj, qoftë kjo duke qenë si mbijetesë e llojit më të fortë e qoftë si një inerci e stadiit të dytë të të parës me sa u tha. Pra si rrënjë që tanimë kanë lidhur

Për romanin "Arratisja e fundit e Baltazar Ketës" – Agron Tufa

NËPËR DISTOPINË E SHQIPËRISË

nga Ballsor Hoxha

brenda kaosit të të vërtetës në këtë distopi, që mund të jetë edhe Shqipëria reale.

Ka një arsye krejt të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë pse ka shkrimtarë, aq më shumë shkrimtarë si Agron Tufa, qoftë në jetën e tij paraprakisht kërcënimeve për vrasje për shkak të punës së tij, e qoftë në "thelbin e tij", e që është jo vetëm ky thelb i cili e shtynë nëpër skëterra si Shqipëria distopike (nëse ajo nuk është një e tillë tashmë), qoftë në ecjen mospërmasë zjarrit të skëterrës, dhe atë vetëm dhe vetëm për të dhënë përçarur dhe përcjellë zjarrin e përjetuar të saj, dhe, apo të sajësës që është kjo botë, në realitetin që e jetojmë në përditshmërinë tonë dhe aq më shumë të përsëritur, në të përhershmen, si botë që digjet dhe në të cilën digjemi, njerëz pa një mundësi të qoftë të, mësuarit nga ajo, apo qoftë të të pranuarit të saj.

Duke u nisur që nga emërtimi Baltazar i personazhit kryesorë lindur diku në periferinë e Shqipërisë (si në Afratin e kultivimit të kanabisit), i njerit prej protagonistëve të romanit, dhe aq shumë të referencave të panumërta të mitologjisë, qoftë religjioze dhe asaj greke, këto e mihin, e thurin dhe e gjejnë zanafillën, e krijojnë narrativin e këtij romani në një lloj mekanizmi tunelesh të të qeniesuarit të njeriut nëpër këtë skëterrë. Kjo, sipas këtij leximi, si e përhershme e botës

sonë, dhe në të njëjtën kohë si përafrim, apo simbolikë e themeluar në njerëzim. Në vazhdimisht dekonstruktivitetet dhe mitologjinë, por në të vërtetë tërë kohën e jetojmë atë. Në vazhdimisht e marrim atë si mësim për të kaluarën dhe mospërsëritjen e saj, por ajo vazhdimisht është dhe kthehet si Minotaur i mbetjeve të tiranisë së kaluar në këtë reale.

Apo, kur kthehem dhe pyetemi, por si qenka e mundur që jetojmë ende, nën këtë skëterrë, është një përgjigje krejt e thjeshtë për këtë, e që është në dy vektorët e 'dëshirës për jetë' brenda këtij romani: personazhi Baltazari, si vektor i dëshirës për jetë duke braktisur ferrin, e që është kjo botë, po sikur që ka qenë dhe si është sot, së paku në metaforën e këtij romani, dhe për të ngjitur pikërisht Mount Everestin, atë malin e stuhisë së përhershme nga parateksti; dhe në vektorin e kundërt të këtij narrativi personazhi Ardian Proseku i cili me dëshirën e tij për jetë mbahet, kapet e ndryshon edhe karakter në jetën e tij, disa herë aq më shumë, për të jetuar përbrenda kësaj skëterre, përbrenda kësaj distopie, duke e shndërruar pikërisht me këtë dëshirë të tij për jetë atë në një skëterrë të 'jetueshme'.

Në Shqipërinë distopike të këtij romani, ai "që venë atje nga ku nuk kthehet i gjallë njeriu", kthehet, por jo edhe me mundësinë e të qeniesuarit në këtë botë, jo më të të

djegies në skëterrën Shqipëri, por të ikjes, pavarësisht se ai i premtos vetes, e gruas së tij, Sesilës (personazhes) në shënimet e tij, se do të kthehet. Dhe pikërisht kjo ngjarje, mitike, horror, tmerr, e groteskë, e peshon, e mbanë në balancë një proces të tërë zgjedhor të vendit ku ndodhë kjo, në këtë Shqipëri distopike. Gjë që bën të përfshihet dhe të lidhet narrativi, në njeriun që, në një mënyrë, gjithësi metaforike, vazhdimisht, në atë "ku rafsha mos u vrafsha" filozofi të jetës së tij, në paradoks vazhdimisht tenton të shkojë aty "nga ku nuk kthehet njeriu", pra në varr e që është personazhi Ardian Proseku. Mirëpo e tërë kjo duke lindur një trekëndësh dashurie dhe lidhesh e ndërthursh të pafundme përmes këtij trekëndëshi, të vetë llumit, e dashurisë, të xhelozive, e të besimit, të dinamikave krejtësisht ekstreme, si që ndodhë në shoqëritë distopike si Shqipëria e këtij romani.

Agron Tufa si autor i këtij romani, mjeshtër i dëshmuar i thurjeve më të papritura e më komplekse, thurë një shoqëri të tërë të një vendi, gjithësi distopik, nga një gazetar krimesh, qoftë të përditshme dhe qoftë të të kaluarës, mihur tutje nëpër mitologjitë e njerëzimit, që vazhdimisht përsëriten në ne, dhe tutje deri në majën e amalgamës politike të të gjitha majave të pushtetit në këtë distopi, të quajtur Shqipëri në këtë roman.

Dhe para se të tentojmë një thellim brenda filozofisë së këtij romani, në të gjitha shtresat e tij, prej mitologjisë, pastaj asaj që ka kaluar në mitologji të tiranisë komuniste, e deri tek mitologjia e politikëbërjes në këtë distopi të quajtur Shqipëri në këtë roman, dhe tek majat e pushtetit e që janë vetë kultivuesit dhe prodhuesit e krimin, gjejnë një balancë, në një njeri të vetëm, në një kuturu njeri, të cilit i ka mbetur vetëm një fije jete, e që është pikërisht e paracaktuara parake e njeriut - dëshira për jetë e tij - që sikur Baltazar Keta, po ashtu edhe ky, pra personazhi Ardian Proseku, e balancojnë dhe mu sikur një vrimë e zezë, një person i vetëm, e përpinë tërë botën e sajuar në një përmbyse gjigante, distopike, që megjithatë pas shumë pak kohe, rikthehet në majën e saj të përhershme, që është Publikja e këtij njerëzimi, Publikja e kësaj distopie, të quajtur këtu Shqipëri.

Duke iu kthyer këtyre dy vektorëve, që i quajtmë 'dëshirë për jetë' e dy personazheve tërësisht të kundërt në çdo gjë, por si që ndodhë në romane të Tufës, i bashkon tërë universi, që nga vendlindja e njëjtë, historia e jetuar dhe aq më shumë një grua, personazhja Sesilia, ata janë njeriu në dy mishërimet e jetës, asaj të trupit dhe Proseku të shpirtit. Më tutje Baltazari i ngritur nga varri i tij, dhe Ardian Proseku, i përfshirë në të gjithë rrathët e kësaj skëterre, paradoksalisht nga kjo 'dëshirë për jetë' e tij, shfaqin njeriun si një qenie e paracaktuar nga po kjo dëshirë, duke e rrënuar, siç ndodhë dy herë së paku në këtë narrativ, nga së paku po këta dy protagonistë të këtij narrativi, universin e kësaj bote distopike. Në të vërtetë këto dy rrënime, një herë me daljen nga varri i tij (qoftë edhe mbetur si fenomen i pashpjegueshëm, për të mos zbuluar në tërësi romanin) të Baltazarit, dhe herën e dytë me pranimin e fajit gjigant brenda narrativit nga Ardian Proseku; janë metafora, ku e para zhbënë Publikën e sajuar të kësaj distopie, dhe i dyti rrënim në anën tjetër e ekspozon të gjallë dhe siç që është, lakuriq këtë Publike të kësaj bote distopike, që mund të jetë edhe Shqipëria reale.

Në teorinë e Dekonstruksionit, nuk ekziston asnjë karakteristikë njerëzore, që mund të zotërojë këtë botë siç e imagjinojmë, qoftë autoafeksioni i njeriut me fiziken e tij imagjinuar si kulmi i botës, apo të të tjera llojeve të fizikes për vetë njeriun. Në këtë ne e arrestojmë një të tashme, gjithnjë të imagjinuar, dhe i bindemi pikërisht këtij arrestimit që vjen prej neve, për të shmangur, për t'i ikur, ballafaqimit me skëterrën ku gjendemi, apo vetë vdekjen. Apo vetë pandihmëshmërinë tonë në këtë botë, botë që është sajesa jonë, e Publikja si sajësë manipulimi të saj. Mirëpo kjo e tashme, as nuk është e kaluar, dhe as e ardhme, aq më pak e



tashme, por në të vërtetë është një fenomen, i cili në mangësitë e njeriut për ta hamendësuar, koha e kaluar gjithnjë e fshinë veten, dhe me këtë, njeriut i mbetet, në të vërtetë tërë ajo që i mbetet është të gjëje gjurmën (Freudiane) të asaj që është - fshirë.

Duke pas parafrazuar këtë teori, thelbin e saj (për të mos u zgjatur në gjëra tejet teknike), le të pyetemi ku është tërë ajo rrjetë me tërë atë kontroll, pushtet, ligësi e katilësi, dhe aq më shumë që bartë një faj kolektiv mbi pesëdhjetë vjeçar, dhe forcë dhune? Ngjanë sikur ka humbur, ka - fshirë - veten po ky pushtet, dhe është i kaluar, përderisa jetojmë këtë të tashme të arrestuar, dhe të përhershme. Për më shumë, ku është ana tjetër, e kësaj tiranie, kësaj tragjedie me përmasa të romanit të Agron Tufës?

Në narrativën e romanit, gjatë tërësisë së tij, por sidomos në kohën kur është hedhur në të pashpjegueshme "kthimi" i Baltazarit në mesin e të gjallëve, kur e tëra na ka mbetur ashtu si është lakuriq skëterra jonë në të cilën jetojmë, përnjëherë kuptojmë se për tërë këtë kohë është rivendosur i tërë sistemi tiranik i komunizmit, apo ai i çnjerzores (si të dojë lexuesi) brenda pushtetit, qoftë atij mediatic, të biznesit, të politikës, e të njeriut në karakterin e tij, në "thelbin e tij", gjë që e bën të ditur, sipas teorisë së Dekonstruksionit, se gjurma, e tiranisë, është vetë e tashmja, e arrestuar e jona. Se e tashmja e arrestuar e jona, përmban brenda vetes tërë të kaluarën tonë. Dhe në këtë gjurma (Freudiane) e cila shpërfaqet, e që ka për një epiqendër Minotaurin, personazhin Aristidhin e tiranisë së shkuar, i cili në degjenerimin që kë pësuar në ideologjinë e tiranisë, rigjeneron të njëjtin, duke mos e lëshuar të kaluarën kurrë në të kaluarën që është, apo duke e çarë të tashmen në gjurmën e të ligës që ka ndodhur në të kaluarën dhe që bartet në të tashmen tonë.

Se nuk ka një të tashme, një të vërtetë aq më shumë, e dëshmon gjatë tërë jetës së tij profesionale personazhi Ardian Proseku i cili e ka për profesion pikërisht ri-aktualizimin mediatic të krimeve të tiranisë, por që në të vërtetë ajo është aq e afërt, aq e gjallë aq e kudondodhshme sa që e vë atë në një trans në të cilin humb tërë atë që ka, duke mos qenë i bindur në këtë të tashme të arrestuar. Ai është, përkundër personazhit tjetër Baltazarit, një shpërfaqje e njeriut i cili personifikon dhe metaforizon mënyrën se si jetohej në këtë skëterrë, se si mbijetohet thellë prapa në ligjet e Darwinit, dhe se si i bëhet ballë Publikës së një distopie si Shqipëria, dhe si bartet vetë zjarri i kësaj skëterre.

Në të vërtetë autori Tufa, në këtë kaos të të vërtetës, që është vetë e vërteta, pa një marrëveshje, pa një Vendosmëri (të përbaljes së historisë së saj - Heidegger) e shfaqë personazhin Ardian Proseku si që jeton, në ndërdijen e tij, dhe çuditërisht, kjo ndërdije e dërgon atë në tërë këtë trans të tij, në dashurinë për jetë, në dashurinë ndaj një gruaje, Sesilës e cila, fatkeqësisht, i takon Baltazarit, e cila është vetë mishërimi i një gjurme tjetër, të kësaj të tashmeje e cila mendojmë se me arrestimin e saj kemi arrestuar edhe çnjerzëzinë e vitit 1997, kjo duke qenë se Sesila vetë ka të humbur dy prindërit e saj në një dhunë më makabre që mund të imagjinojmë.

Sepse, arsyeja e arrestimit të të tashmes, ndodhë pikërisht për shkak krijimit të sajës në Publikën e kësaj skëterre, të arrestimit të kufirit të botës sonë, si sajësë, është po e njëjta skëterrë, po i njëjti ferr, në të cilin kemi jetuar në të kaluarën, apo që mund të shpjegohet krejt thjeshtë me pyetjen: çka ndodhi me çnjerzëzinë e 1997, apo të tiranisë komuniste? Ku është ajo, dhe si është gjykuar dhe veçuar nga pushteti, cilido pushtet, është fjala për këtë çnjerzëzi.

Në këtë dekonstruksion, gjurma (Freudiane) ngjanë sikur e dyzuar, e përshkëllirë në seritë e krimeve kolektive, por në të vërtetë, ajo, si që ndodhë me këtë epiqendër të saj, me Arsitidhin e kësaj të kaluarë, ajo është një zinxhirë transformimi dhe aq më shumë, siç e sheh autori, një Minotaur i pashkatërrueshëm, i kësaj skëterre të quajtur, përndryshe, botë e jona.

Pra duke iu kthyer, për të vazhduar këtë

dekonstruksion, kureshtjes së autorit Tufa, kureshtjes së shkrimtarit për të hyrë në këtë "Bash - Ëndërr", për të hyrë në këtë skëterrë, ajo ndoshta është në paradoksin e cekur më lartë, si ndodhë që mbijetojmë. Por nëse e përafrojmë një "Bash - Ëndërr" në këtë, e që do të mund të ishte vetë seria e pafundme e "Bermudave" (bastioneve të kriminit të të gjitha llojeve të përbashkuar pikërisht në Afratin e dy protagonistëve, Baltazarit dhe Ardian Proseku), kur hyjmë aty, me automatizëm, në gjithë bashkëkohësinë dhe luksin e kontekstit, njeriu është në dy botë: ai i ligjit të të fortit (lexo: më të egrit) ku babai nuk bën gjë as nuk mundet, për të ndaluar dhunimin e vajzës gati se para tij, dhe në anën tjetër, ai i të ikurve, qoftë të profesorit të letërsisë Pajtorit, e qoftë të përhumburit në të përhershmen protagonistit Ardian Proseku, secili duke ikur në mënyrat e veta, duke braktisur këtë skëterrë.

Ngjanë sikur të gjithë ikin, në këtë roman, ngjanë sikur të gjithë braktisin këtë skëterrë, ngjanë sikur nuk ka mbetur askush në këtë skëterrë. Por, pas daljes prej këtyre "Bash - Ëndërrave", prej Pargës së Greqisë bashkëkohore, dhe me Labirinthin e saj, ku ndodhë "gjysmë" dhunimi apo marrëdhënia seksuale që nuk di të jetë ndryshe pos si dhunë!, ndërmjet Ardian Proseku dhe Sesilës,; dhe Bermudave, pikërisht këtu na shfaqet edhe sinonimi i Jozef K., personazhit të Kafkas, që është njeriu i cili tërë kohën mundohet të bëj jetën e vetë, njerzore, i përballur me heqakeqën e tij, në mesin e tërë pandjeshmërisë së kësaj bote, por që ruan dashurinë e tij, mu sikur Sesila e cila gati se një jetë të tërë beson në kthimin, (e premtuar) të Baltazarit të saj, bashkëshortit të saj.

Ky roman vazhdimisht ka një balancë: të Baltazarit si "ai që kthehet nga nuk vjen njeri" me pushtetin politik të tërë Shqipërisë distopike; pastaj të balancës së pushtetit politik me atë kriminal, pastaj të njeriut me tërësinë e kësaj skëterre, pastaj të besimit të njeriut në trupin e tij në balancë me besimin e njeriut në çka?!, athua çfarë beson protagonistit Ardian Proseku? Ndoshta në rrugën, përvojën të cilën e ka pasur deri në aktualen e kësaj skëterre. Mirëpo, këto balanca janë metafora e "dëshirës për jetë" të njeriut, qoftë edhe në një skëterrë, qoftë edhe në një distopi, që ngjanë në Shqipërinë e sotshme, ndaj të pandjeshmës së asaj që ka kaluar në distopi.

Këta dy vektorë, ai drejt majës së Mount Everest, si bartës i zjarrit të paikshmërisë nga kjo skëterrë, vetë Baltazari, dhe në anën tjetër ai i Ardian Proseku, që është vektor pingul në vullkanin e të tërës, dashurinë e përvujatur ndërsa vuan të gjitha llojet e dhunës së kësaj të tashmeje, sikur e kërkojnë pikërisht përbrenda "Bash - Ëndërrës", përbrenda Kështjellës së Kafka, pajtimin, apo edhe revoltën ndaj kësaj bote. Sikur, u mungon diçka, sikur u mungon një dozë çnjerzoreje, sikur u mungon aftësia për mbijetesë, por në paradoks po me këtë paaftësi duke e pas rrënuar të tërën, secili në mënyrën dhe fatin e tij.

Në këtë dekonstruksion, shfaqet edhe një shenjë, e cila në gjakimin e autorit Tufa është në të vërtetë përpjekje për ta kthyer atë nga shënjimi në të cilin ka kaluar. Ai në të vërtetë, mu sikur Derrida që bën me Himenin femëror, duke e marrë për shenjë të pa fizike, të padëshmueshme, të pa të vërtetën e saj të përhershme, Tufa merr telogoninë, si shënjim i cili nuk rri, dhe as nuk vendoset si shenjë në njerëzim, as në botën e tij, por në të vërtetë është - difference - e aftësisë femërore për të zhbërë tërë këtë sajësë, tërë këtë botë me aftësinë e lindjes së Baltazarit të vdekur tanimë në dëshirën dhe përbrenda dashurisë saj me personazhin e Proseku.

Dhe ndoshta, pikërisht ky shënjim i kalimit të femrës, nga një shenjë fizike (lexo: shenjë e vendosur në hierarkinë e gjërave), në shënjim të një bote të largët tashmë, e bën këtë roman edhe më të rëndësishëm, në pikërisht trajtimin e asaj që ka kaluar femra, përmes morisë së femrave të cilat përjetojnë këtë skëterrë, dhe në këtë na tregojnë për një kalueshmëri, e që në gjurmën (Freudiane) është në të vërtetë gruaja e cila bartë tërë këtë skëterrë në shpinën e saj.

- Libër i ri me poezi i shkrimtarit Visar Zhiti në Itali -

RRUGË QË RRJEDHIN NGA DUART E MIA

Doli në Itali libri me poezi "Strade che scorrano dalle mie mani" i Visar Zhitit, botim i Shtëpisë Botuese "Puntoacapo Editrice" në Alessandria, qendër e Piemonte-s, e specializuar në letërsinë kontemporane..

Lajmin e jepte shtëpia botuese, duke e nisur me një fjali poetike:

Pavarësisht ditës së vranët, rrezet diellore arritën sot me një stampim gjurmëfreskët. Më së fundi erdhi në redaksi përkthimi me peshë i Elio Miracco-s me tekstet e origjinalit përballë, "Rrugë që rrjedhin nga duart e mia" (*Strade che scorrano dalle mie mani*) të Visar Zhitit. 300 faqe të mbushura me përvojat dhe vizionet e poetit që Eco, Grasso dhe Luzi e përkufizuan tashmë si një poet të qëndrësës, pasi puna e tij si artist shenjoji në mënyrë të pashlyeshme jetën e tij të përditshme (për ata që nuk e njohin autorin, theksojmë vetëm se Zhiti konsiderohet si shkrimtar i madh i letërsisë së sotme shqipe dhe vuajti burgim nga regjimi diktatorial për 10 vjet për shkak të vargjeve të tij). Jemi krenarë që ky autor zbarkon në botimet tona, të lumtur që kjo ndodhi falë punës së "EstroVersi Associazione Culturale", që prej vitesh jemi krah për krah dhe që ka mundësuar dhe mundëson zëra të huaj të lexohen dhe dëgjohen gjatë qëndrimeve këtu në Itali. Antologjia e Visar Zhitit përmbledh poezi nga librat e mëparshëm, por edhe të reja. Në kopertinë është piktura "Mendim rinor" e Maurizio Caruso-s, ka disa të dhënat për autorin dhe vleresime nga personalitete të shquara të letërsisë.

KANË THËNË MBI VISAR ZHITIN:

Shihni... historinë e Visar Zhitit: mjaftoi që ai të shkruante poezi të konsideruara "hermetike dhe të trishtuara", pra dhe armiqësore ndaj regjimit... dhe me të drejtë e dënuan me dhjetë vjet burg.

Poezia tremb regjimet autoritare dhe diktatoriale edhe nëse flet, si në rastin e Zhitit, vetëm për trëndafilat.

Umberto Eco

Në ato burgje Zhiti është mbajtur për vite me rradhë, i pambrojtur përballë dhunës dhe arbitraritetit. [...]

Por këto janë dhe faqe fitimtare të poezisë. Liria mbështet vargjet e Visar Zhitit edhe kur janë të mbytura nga argumente të errëta. Dhe na shfaqet lakuriq me pamje të plotë monstruoze të një tiranie. Dhe çlirohet nga kjo morsë një poet i fortë dhe i vërtetë.

Mario Luzi

Poet dhe gladiator. Poet dhe muzikant. Poet dhe kalorës i Varrit të Shenjtë. Poet dhe artist. Poet dhe ushtar. Poet dhe punëtor hekurudhash. Poet dhe falltar. Poet dhe doktor. Poet dhe mërgimtar. Poet dhe engjell. Për të mos iu dorëzuar një dëshpërimi pa rrugëdalje, Visari shpik dita-ditës paraqitje dhe role të ndryshme, sepse në fund dëshiron të mbetet vetëm poet.


Sebastiano Grasso
President i Klubit PEN Italian

Visar Zhiti është shkrimtari shqiptar, jeta dhe vepra e të cilit janë pasqyra më e mirë e historisë së kombit të tij...

Robert Elsie
Albanolog kanadezo-gjerman



Piktoria Maurizio Caruso me librin e porsabotuar



Maurizio Caruso: "Mendim rinor".

Kohët e fundit, në disa shkrime, jam përpjekur të theksoj se është momenti që në fushën e letrave t'u lëmë vendin e duhur Tregut dhe Kritikës Letrare. Nuk ka dhe nuk mund të ketë letërsi e art përtej këtyre treguesve; edhe nëse, do të ishte një gjë fort e rrallë. Madje, gjykoj se edhe kur ndahen çmime e bëhen nderime - për çka gjithnjë konsumohen llafë, mbase me të drejtë - duhen marrë parasysh këto tregues; sepse janë shumë pranë së vërtetës, sa i takon veprave në fjalë dhe letërsisë në tërësi.

Duke parë që në kritikën për Kritikën Letrare ndonjëherë ka keqkuptime, shfryrje, deri mllafe, po qëndroj në kjo e fundit: së pari për të marrë në sy pyetjen nëse për gjithçka na e ka fajin ajo (Kritika Letrare); dhe së dyti për t'iu avitur sa më kthjellët termit në fjalë, si zhanër. Lexojmë e dëgjojmë të thuhet lart e poshtë, nga gjithfarë shkruer, ndonjëherë edhe të poleve të ndryshme, që 'nuk ka Kritikë Letrare', me ç'rast një pjesë e madhe e letrarëve shqiptarë përpriqen të justifikojnë qasjen e tyre të pafat në këtë lëmë, ku vërtet nuk është e lehtë t'ia dalësh mbanë. Ky është një debat i vjetër sa vetë arti; por në këtë shënim, do t'u shmangemi përkufizimeve dhe do të përpriqemi të ndërtojmë një raport sa më të besueshëm mes nesh dhe disiplinës për të cilën po flasim.

Si fillim, vetëm pak radhë do të jenë këtu peng i së shkuarës, ngase i vlejnjë temës. Dhe fjala është që dikur - kjo tregohet jo thjesht për të qeshur - njëri ndër kritikët letrarë më aktivë çalonte (fizikisht); dhe prandaj thuhet me ironi se Kritikë Letrare 'çalonte'. E vërteta, mendoj, vjen pak më ndryshe; që, siç thashë më lart, një shumicë shkruerësh asnjëherë nuk kanë qenë dhe nuk janë të kënaqur me këtë disiplinë dhe kjo, jo për faj të saj, por mbase ngaqë ata aq e kanë hapin. Kritikë Letrare e atyre dekadave - sado që, përgjithësisht, në përfshirjen e saj ishte tejet e angazhuar (ideologjikisht) - pati një zhvillim bindës, nëse marrim parasysh parimet e të shkruarit, si i tillë në vetvete.

Ata kishin mbi vete trysinë e kornizave të kohës, mbase edhe të bindjeve të tyre; por në librat dhe, përgjithësisht, në kritikën e tyre letrare ka shumë profesionalizëm. (Alfred Uçi, Jakup Mato, Drago Siliqi, Dalan Shaplo, Koço Bihiku, Razi Brahimi, Adriatik Kallulli, Dilaver Dilaveri, Rinush Idrizi, Neki Lezha, Abdurahim Myftiu, Riza Hysa, etj.) Shënimet letrare dhe studimet e tyre vijnë të qarta për nga brendia, të pranueshme në formë dhe më se korrekte nga pikëpamja gjuhësore. Kjo ndodhte në një kohë që, megjithë problemet e rënda, letërsia më e mirë (Ismail Kadare, Petro Marko, Jakov Xoxa, Qamil Buxheli, Nasi Lera, etj.) tentoi ta thyente monotoninë e diktuar në këtë lëmë, monotoninë që ndrej rëndë në botime, gazeta, revista, TV e Radio, për shkak të profilit të rendit politik, sa edhe ngaqë pjesa dërmuese e shkrimtarëve dhe artistëve, duke qenë grafomanë ose thjesht të indoktrinuar, shërbenin me zell si një 'peshore' që e kish të kufizuar aftësinë matëse. Kjo masë nuk mund të mos rëndonte në gjithë pamjen e Letrave Shqip.

Sot, domethënë pas '90-ës, jemi në një situatë krejt tjetër; dhe prapë dëgjojmë të flitet shumë për 'mungesën e Kritikës Letrare' dhe për 'fajet' e saj në zhvillimin e letërsisë dhe arteve. Gjithë i njëjti refren. Prapë, duke mos qenë i këtij mendimi, si dhe duke u mbështetur përgjithësisht në parime që inspirojnë ekulibër e drejtësi, mund të them me bindje se këto qarje e justifikime nuk na shpëtojnë dot nga moseskësia; e thënë ndryshe, nuk kemi pse të shfryjmë vend e pa vend mbi Kritikën Letrare. Nuk është përgjegjëse (vetëm) ajo për çfarë shkon keq apo edhe mirë në zhvillimet e sotme letrare.

Emrat më të njohur në këtë fushë, mes tyre asi që e kanë ushtruar këtë zhanër edhe më herët, si dhe pedagogë në universitete, studjues, shkrimtarë profesionistë, etj. përballem me një lëndë letrare të tejloqshme dhe me sjellje vanitoze, që s'ka kritikë dhe estetikë t'i sistemojë. E megjithatë, në shënimet letrare dhe në librat e tyre kanë gjetur përgjigje një sërë pyetjesh që u ngritën sidomos në fillim të viteve '90, por edhe më pas, kur letërsia dhe arti ndryshuan në të gjitha dimensionet. Këtu është fjala për kritikë të letërsisë dhe artit të konfirmuar në çdo kohë, si Josif Papagjoni, Floresha Dado, Mido Gjini, Xhezair Abazi, Pandeli Koçi, Bashkim Kuçuku, Klara Kodra, etj., por sidomos për firma që vijnë në këtë

KRIKKA LETRARE DHE SPEKULIMET NËN OKELION E SAJ

nga Vangjush Sarro



disiplinë më së shumti në dy dekadat e fundit: Shaban Sinani, Fatmir Terziu, Behar Gjoka, Muharem Jakupi, Ymer Çiraku, Vangjush Ziko, Spiro Gjoni, Milaim Nelaj, Xhahid Bushati, etj. Shkrimtarët, artistët kanë parë vëmendje dhe profesionalizëm në aktivitetin vlerësues të kësaj kaste kritikësh, edhe pse mund të presin më shumë, çka është një çështje tjetër.

'Mëkatet' e Kritikës Letrare, nëse vërtet mund t'i quajmë kështu, nuk kanë të bëjnë me fatin vetjak të kaq shumë krijuesve në ofensivë; (po, ata janë gjithnjë e më shumë, tash pothuaj turmë në portat e letërsisë dhe artit). Ashtu si vetë letërsia, edhe kritika letrare ka shkallët dhe gjendjen e vet, të cilat as nuk zmadhohen e shëndoshen duke i mbivlerësuar, as edhe tremben e struken nëse i stigmatizojmë në mënyrë tendencioze. Për hir të së vërtetës, Kritikë Letrare e nivelit profesional, ajo elitë të themi, e përkushtuar në këtë disiplinë, është pak aktive; por as që mund të mendohet ndryshe. Përgjithësisht, ajo shkon krahas zhvillimeve e arritjeve të letërsisë më të mirë. Më tutje apo një rend më poshtë mund të thuhet se kemi thjesht tentativa për të bërë një panoramë të jetës letrare, përpjekje për t'i moderuar disi qëndrimet e ftohta e ndonjëherë të anuara të Kritikës - elitë (siç e quajtmë) dhe kjo ndihmesë vjen nga krijues të njohur të kësaj fushë, por edhe nga edhe vetë shkrimtarët; (me modesti, do ta rendisja veten në këtë kategori). Këta 'ndihmëtarë' mëtojnë të tregojnë kuota të caktuara të zhvillimit letrar, të sjellin emra dhe të shqyrtojnë krijime që e meritojnë vëmendjen e publikut dhe të institucioneve. Më këtë, vjen Kritikë Letrare mediokre, që ashtu si letërsia mediokre, është formalisht korrekte, le të themi e shkruar jo fort keq, por gjithsesi e zvarritur, e lodhshme, ndonjëherë tejet e rëndomtë. E më së fundmi, ka edhe një kategori apo shkallë tjetër të këtij zhanri, ku s'ka mbetur shkruer e letrar pa u përfshirë; dhe kjo është gjendja apo sjellja diletanteske në këtë fushë.

Pa qenë strikt në sa u tha më sipër, po i kthehem sërish drojes që shprehet vend e pa vend në lidhje me 'mungesën' e Kritikës Letrare. Arsyet pse duket sikur (e thuhet sikur) Letërsia dhe Kritikë Letrare shkojnë keq e më keq, janë të shumta dhe në një shënim të tillë nuk mund të argumentohen plotësisht e në thellësi. Por le ta cekim sadopak temën dhe çështjen, duke zbuluar apo numëruar disa ngërce në këtë raport të vështirë: Një shumicë librash letrarë (nëse mund të quhen kështu) humbasin me t'u botuar; nuk arrijnë dot te publiku, ngase janë shkruar varfër, por edhe sepse shtypen pak kopje, kurse libraritë janë dingas e rëndom nuk i marrin dhe vetë autorët e dinë që hapësira për ta është e kufizuar. Kjo është thjesht një nga pasojat e shfaqjes së amatorizmit në këtë fushë. (Me sinqeritet, unë vlerësoj dëshirën dhe pasionin e gjithkujt që qaset në këtë lëmë, por nuk është e thënë të bien në sy të gjithë, madje ky është fati vetëm i një pakice; i më të talentuarve.)

Ngërçi tjetër është dukuria e dhurimit të librave, çka tash është bërë pothuaj njëloj farse, që e zvetënon dhe e korit përshtur këtë fushë të artit. Unë nuk di si mund t'u ngajë të tjerëve, por vetë mendoj se ato (gjoja) shkrimet që bëhen nga dikush pasi që i është dhuruar një libër, përgjithësisht ta shpifin... Ato janë qoka, vizita kortezie, lavde në distancë, ndoshta aty-këtu edhe recensione të një niveli mesatar, por që asnjëherë nuk kanë sharmin dhe vlerën e një kritike letrare. Të vjen keq kur edhe autorë deri diku të njohur bëhen prë e kësaj manovre, që tash në Letrat Shqip është bërë 'tendri' por, siç u tha më lart, edhe qesharake në të njëjtën kohë. Shpesh, duke qenë larg këtij profesioni, lëndonjësi poston thjesht një karikaturë të 'shënimit letrar', duke telendisur kështu veten dhe libërdhuresin. Se mund të jesh edhe

pedagog(e) siç lexova diku së fundi dhe prapë, me gjithë dëshirën e mirë, shkruan broçkulla, ngaqë nuk je në 'terrenin' tënd.

Po ashtu, mendoj se lë një shije të pakëndshme edhe rendja e disa amatorëve të Kritikës Letrare pas emrave (përkohësisht) të njohur dhe që mund t'u japin shkruer në fjalë njëloj aksesit, mund t'i bëjnë ata disi më të njohur. Duke iu qepur një emri që është disi 'më në rreth', që ka njëloj stature, pavarësisht se si e ka krijuar atë, shkruerit përpriqet të korrigjojë e shëndoshë disi klasin e vet; dhe kjo sjellje duket gjithashtu e sforcuar dhe (ende) pak për ta quajtur 'Kritikë Letrare'. Por natyrisht, këto dukuri nuk se përshtojnë mundësinë për të treguar (ndonjëherë edhe mirë) mbresat nga leximi i një libri.

Dhe ndërkaq, është krejt tjetër gjë pjesa më e pamatur e saj, e kritikës pra, domethënë ajo shtresë krijuesish (pasionantë, paçka se hapin e kanë të pakët) të cilët e ushtrojnë këtë disiplinë në mënyrë diletanteske, anipse me shumë pretendime. Edhe kjo përfshirje e sforcuar në art, që sulmon përshtur gazetën dhe rrjetet, është bërë njëloj barre për kulturën e sotme në tërësi dhe e 'hedh vallen' bashkë me krijimtarinë e dobët e pa frymëmarrje, me krijimtarinë që përsërit, që çirret, që imiton, që nuk e prek dot lexuesin...

S'ka vend për fyerje, as për paragjykimë, fundja jemi në një bisedë, por... ja si shkruhet në një (të ashtuquajtur) kritikë letrare: "Kështu autorja, (me vargun e saj), herë dashuron qetësisht e në mënyrë gati të pahetueshme, herë me vrull, me zjarr dhe në mënyrë pushtuese." Po përpriqem (së koti) të 'kuptoj' se çfarë thuhet edhe në një tjetër shënim letrar: "Por ja që është e pamohueshme se përcaktimi në mënyrë empirike i pranisë së gjërave të tilla nuk është i lehtë, edhe pse elementë të shumtë ndërhyjnë dhe ndihmojnë për të shkaktuar iluzionin e përfytyrimit, të dëgjimit, të nuhatjes, të shijes dhe të prekjës." (Duket sikur autori ka ngatërruar letërsinë me anatominë a nuk di ç'tjetër.)

Dhe 'xhevahiret' nuk kanë të mbaruar; ato, në vend që ta 'ndriçojnë, e ndotin edhe më shumë mjedisin letrar dhe artistik. "Futja e elementeve të kriminalistikës së ndërthurur me ato policeske, që joshin lexuesin, që në kohën reale rreket të sendërtojë imazhe filmash gjatë leximit." (Kaq ishte 'fjalja'. Mendoni se ka përfunduar, ka kuptim?) Një tjetër fragment nga një 'kritikë letrare', në fakt një tjetër fjali mungesore e stërgjatë: "Marrëzi duke qenë e pakufishme dhe e pakapshme, aq më shumë vetmi e pakalueshme, dhe e pabartshme." Janë me të vërtetë klas i ulët shkarravitjet këso. Ja edhe një e tillë si 'periudhë' më vete: "E më tutje, pushteti i njeriut mbi qeniesimin duke pasur pushtetin mbi kënaqësinë..."

Ndonjëherë them me vete që, kushedi, mbase shumë gjëra kanë ndryshuar; edhe vetë Kritikë Letrare. E ndoshta vetë jam pak 'i vjetëruar' në mënyrën se si e shikoj këtë disiplinë dhe vetë letërsinë. Të qëndrosh në disa terma e parime, qenka vërtet e vështirë. Por hënde de, çfarë ka përtej shkollës së këtyre disiplinave? Jo çdo qasje është letërsi e kritikë letrare dhe këtu s'ka vend për të vjetër e të rinj (siç zu të flitej dikur, kohë të shkuara). Kur dikush më foli për 'ndryshimin' fabulës si lloj letrar, madje duke përdorur pa pikë vetëpërbajtjeje fjalën 'modernizim', unë thashë dhe shkruajta se ato që ishin në rend të bisedës mund t'i quajë thjesht kalambure, por jo fabula. Për më tej, të jemi të sinqertë: edhe 'modernizim', edhe rima foljore nga fillimi në fund, kjo sikur nuk shkon; qofsha i gabuar (!)

Në fakt termin e vjetëruar e përcolli tek unë në një nga rrjetet sociale, mik pas miku, dikush që mbase donte të shpaguej, pasi në ndonjë nga shënimet e mia letrare - këto qasje gjithmonë 'çalojnë' - nuk e kisha

përmendur. Në fakt, nuk kisha lexuar asgjë prej tij, s'mund t'i ndjekësh të gjithë. U kërkoj ndjesë lexuesve të nderuar të kësaj gazete (që e çmoj fort) për këto radhë me njëloj ngarkese vetjake; por besoj që jemi brenda temës. Pra, për ta njohur disi autorin 'modern' dhe që më kishte stigmatizuar si në lojën e 'telefonit të prishur', u bëra kureshtar pa le ç'kolos kisha lënë pas dore; dhe kështu, dikur i hodha një sy fragmentit të një romani... Tregohet (gjithë pathos) se si ish martuar një nga personazhet dhe e kish shtruar mirë (në seks) nusen e tij, aq sa e kishte lodhur e kjo i thosh 'më lerë, se më more frymën', etj. Nuk kuptova asgjë dhe nuk e pëlqeva. Epo mirë, ndoshta gabohesha që s'më tërhoqi ajo lloj letërsie e ato episode. Prandaj, më pas, - jo shumë larg nga leximi i atij fragmenti - pashë një tjetër gjë, po nga ai autor; gjithë për kureshtje. Këtu rrëfehej... si masturboheshin fëmijët, adoleshentët më mirë; gjë e parë shumë herë, po vërtet shumë herë, në libra e në filma. Mbase nuk ishte mirë, e di që ndoshta prapë po e paragjykoj, por nuk shkova më tej me autorin në fjalë. Kjo, natyrisht, nuk e pengon atë të promovohet edhe më tej; dhe këtë e them me sinqeritet, sepse jo çdo gjë që nuk gjen pëlqimin tonë, është e papëlqyeshme për të tjerët dhe për Kritikën Letrare.

Dhe meqë po shpjegoja këtë punën e 'trendit e të vjetërimit', ja edhe një fragment nga një tjetër kritikë 'moderne': "Loja postmoderne e rrëfimit të asaj që është rrëfyer pafundësisht dhe krijuar e rikrijuar edhe para vetë autorit, e bën rolin e artistit sa interesant aq edhe të rrezikshëm, pasi kur në pavetëdijën kolektive rrëfimit futen në një formë të caktuar, refuzohet pranimi i çdo varianti tjetër." Po nga ajo 'kritikë trendi': "Gjendja e ethshme e tërë personazheve që i kaplon magjia e shfaqjes është në qendër sidomos të kapitujve të parë të romanit." Dhe pastaj: "Gjendja e turbullirës mendore që e çon X-in* drejt vetëvrasjes, nuk përshkruhet me thellësi për mendimin tim, por duhet kuptuar që estetika e autorit shkon harmonikisht me tërësinë e romanit, ku mosteprimi me cilëndo temë, do thojë se është princip themelor."

Jo, nuk besoj që të jem 'i vjetëruar'; sidomos kur lexoj këso 'analizash' të fryra e të stisura, që nuk mund të quhen kritikë letrare (prandaj këtë herë po e shkruaj me shkronjë të parë të vogël). Ndërkaq, situata bëhet gjithnjë dhe më e rëndë sepse shkruerit nuk dinë të heshtin, të ndryshojnë ndonjë gjë në të menduar e në të shkruar; madje jo vetëm kaq, por vazhdimisht i kanë sytë në qiell: "Teksa ke lexuar dy veprat e tij të mëparshme dhe me padurim pretë të tretin, ja ku erdhi romani befasues X si pjesë përmblyllëse trilogjisë, Y të cilën, pas leximit, e fusim në atë që mund ta quajm, "Tresor" i letërsisë shqipe dhe jo vetëm." Shikoni sa shumë gabime gjuhësore dhe, nga ana tjetër, çfarë parashtrimi *ex cathedra!* Mbase ngaqë (së paku në këtë rast) edhe artikullshkruerja, edhe ai për të cilin shkruhet, janë nga ata që marrin ose japin çmime, ndonjëherë të rëndësishme (!) Është trishtuese të shtosh që edhe gazeta të njohura i lejojnë këto spekulime në emër të Kritikës Letrare. Atëherë, që ta përmbyllim këtë bisedë, problemi ynë, së paku problemi ynë më i madh, nuk është asfare ajo, Kritikë Letrare. Problemi ynë më i madh është teprimi, në kuptimin më të ngushtë të fjalës. Është megalomania. Është mediokriteti. Është marria e të shkruarit pa përgjegjësi. Dhe këto nuk mund të gjejnë prejje e shfaqjesim në 'mungesën' e Kritikës Letrare, sado që ajo, si të gjitha zhanret e llojet e artit përjeton problemet e veta.

*Këto shenja janë përdorur (në vend të emrave a titujve të librave) për të mos lënduar autorët, sa kohë që çështja shtrohet në parim.

Më në fund është koha që ti të shkosh në shtrat. Kjo ka qenë një ditë e gjatë dhe mos harro, ka për të qenë edhe e nesërmja. Nëse ky nuk rezulton të jetë gjumi i fundit i jetës tënde — gjumi i madh, siç preferojnë ta quajnë disa njerëz (në këtë rast, këto do të jenë gjithashtu faqet e fundit që do të keni lexuar ndonjëherë) — nesër do të kesh një ditë tjetër të gjatë. Idealja, supozohet që të flemë nga gjashtë deri në tetë orë gjumë në ditë, është në të mirë të shëndetit tonë — si fizik ashtu edhe atë mendor. Mungesa e gjumit e lodh mendjen dhe na krijon luhajtje në temperament duke na bërë antisocial. Gjithashtu mund të shkaktojë sëmundje serioze. Kështu që tani, me siguri do të jesh duke u përgatitur. Ti mund të jesh shtrirë tashmë, me llambën e ndezur pranë shtratit, për të lexuar këto faqe të fundit. Ndoshta je i lodhur, por me vetëm disa faqe të mbetura për të përfunduar, mund të bësh ende përpjekje për të vazhduar. Mbase libri të ka rrëshqitur tashmë nga dora disa herë. Po dremitesh. Pastaj sërish, mund të mbash ende rrobat e tua të brendshme, në mos diçka më shumë — ato që mbaje veshur që prej mëngjesit. Nuk ka rregulla që të diktojnë se si duhet të lexosh, megjithëse herë pas here njerëzit kanë shpikur rregulla si të lexojmë, mirëpo nuk është e thënë se ato duhen marrë për bazë. Për shembull, Daniel Masa, në një nga poezitë e tij më të bukura, na këshillon kështu: “Mos lexoni atë që vijon nëse nuk e keni gdhirë kurrë”. A ke “lundruar” ndonjëherë natën? Nëse po, atëherë mund të vazhdosh dhe të lexosh poezinë e Masas sapo të kesh përfunduar me këto faqe. Nëse nuk e ke bërë, prapëseprapë mund të vazhdosh dhe ta lexosh. Mendo këtu për Mikael Berg dhe Hana Shmitz: ata lexonin në një vaskë. Për të lexuar atë që pason natën ishte një vendim i shëndoshë, një plan i mirë, ose në çdo rast një rastësi e lumtur. Për të lexuar atë që vijon, është e rëndësishme që të kesh filluar ose do të fillosh të kotesh për gjumë. Leximi yt duhet të vazhdojë në mënyrë të barabartë dhe të fillojë, me boshllëqe gjatë të cilave koka të shkon herë para e here mbrapa. Duhet të ketë heshtje, mbase e shoqëruar kjo me tiktakun e orës, ose e thyer nga zhurma e ndonjë makine që kalon aty pranë apo e një treni ekspres që afrohet/largohet nga stacioni. Ose mbase dera e apartamentit ngjitur do të hapet dhe mbyllet, duke treguar mungesën — sado të parëndësishme — të konsideratës për ata që e pëlqejnë veten, po e mbyllin këtë ditë të gjatë me një vend leximi tundues për dremitje. Ose ndoshta edhe ti e ke zakonin e të lexuarit në një vaskë. Le të bëhemi pak romantikë këtu: je ti dhe ajo lakuriqësia çliruese në një vaskë të madhe, plot/gjysmë me ujë të vakët. Ndoshta pak shkumë aromatike. Patjetër që duhet të jesh nën dritën e qiririt, dhe qiriri duhet të jetë aromatik. Je duke lexuar dhe po harron gjithçka. Edhe këtu, herë pas here mund të kotesh, thjesht mund të tundësh kokën. Jashtë po bie shi, po fryn dhe një ciknë e fortë dhe bën ftohtë. Në këtë kohë në horizont nuk duket këmbë njeriu në rrugë. Nuk është edhe aq vonë, por në këtë orë do të zbulosh se njerëzit janë të prirur të anulojnë çfarëdolloj takimi që mund të kenë pasur, të hedhin një velenxë në prehër dhe të shikojnë programin në televizionin që transmeton lajmet e orës tetë, të pinë rum me mjaltë dhe limon para se të shkojnë në shtrat. Sapo të jenë në shtrat, teksa tërheqin shtrorën do të thonë: “Oh, më në fund!” Herë pas here dëgjoen gjëmime bubullimash, një rrufe mbi xhamat e errët të dritares me perde në banjë. Dhe ndoshta — pse jo? — pranë buzës së vaskës, mbi pllakat e ftohta, ke një gotë verë të kuqe. Kjo ka qenë një ditë e gjatë dhe, me siguri, nëse gjërat shkojnë sipas planit dhe dëshirës, e tillë ka për të qenë dhe e nesërmja. Nata po zvarritet. Mbase sapo ke bërë dush dhe sapo je rehatuar në shtrat. Ti mund të kesh shtruar faqe të reja për javën. Shtratin e gjete të rregulluar mirë. Ose mbase u fute në një shtrat ende të parregulluar nga mbrëmë. Mundet që edhe ti u mbështete duke thënë: “Oh, më në fund!” Ndoshta është dikush pranë teje: personi që

Botim i ri nga Ombra GVG

VËSHTRMË NË ERRËSIRËN E NATËS

nga Immanuel Mifsud

Përktheu: Elisa Ivanaj

Immanuel Mifsud është një poet dhe shkrimtar i lindur në Maltë në vitin 1967. Ai filloi të shkruante poezi në moshën 16-vjeçare, kur bashkëthemeloi grupin letrar “Versarti”. Në të njëjtën moshë ai filloi të punojë në grupe teatrore eksperimentale, duke drejtuar pjesët e veta dhe më vonë ai drejtoi shfaqjet e Chekhov, Dario Fo, Max Frisch, Federico Garcia Lorca, David Mamet, Harold Pinter dhe Alfred Buttigieg.

Ai ka një doktoraturë nga Universiteti i Maltës ku ligjëron në letërsinë dhe teatrin bashkëkohor maltez. Mifsud konsiderohet si një nga shkrimtarët më origjinalë të vendit të tij.

Ka marrë pjesë në një sërë festivalesh prestigjioze të letërsisë, si Festivali i Poesia de la Mediterrania (Palma de Mallorca), Dnevi Poezija in Vina (Medana, Slloveni), Terceti Trnovski (Ljubljana, Slloveni), Dni Poezie a Vina (Valtice), Republika Çeke dhe të tjerë. Disa nga poezitë e tij u botuan në botime eminente si New European Poets (Graywolf Press), The Echoing Years (Waterford Institute of Technology) dhe In Our Own Words: A Generation Defining Itself (MWE), ndër të tjera.

Është fitues i një sërë çmimesh: Çmimi Kombëtar i Maltës për prozë (2002, 2015), Çmimi Kombëtar i Maltës për poezinë (2014, 2016) dhe Çmimi i Bashkimit Evropian për Letërsinë (2011). Vepra të ndryshme të zhanrit të prozës dhe të poezisë së Mifsudit janë përkthyer dhe botuar në një sërë gjuhësh dhe janë botuar në vende të ndryshme evropiane dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

do, ose që pandeh se e do; personi që ndjen/mendon/beson/pret/je i/e bindur se do të të rikthehet. Ndoshta është dashuria jote e vërtetë. Ndoshta ti dhe ky person jeni të martuar, ose jeni në një bashkim civil, ose në një bashkim formal ose joformal. Apo mbase marrëdhënia jote me këtë person është klandestine: takoheni një herë në javë, një herë në muaj? Një herë në vit? Një herë në vit

ndoshta do të ishte shumë pak, por në të vërtetë nuk mund të thuhet se çfarë ndodh në këtë botë, e mbushur me histori të çuditshme. Ose mbase ky është një person që mezi e njeh; ju të dy u takuat krejt rastësisht dhe pastaj gradualisht vijuat gjithnjë e më shumë dhe së shpejti do të jetë koha që të përfshihen pak më thellë. Pastaj përsëri mund të jesh vetëm sepse personi që do (që

të do) tashmë ka rënë në gjumë. Ose mund të jesh vetëm sepse je vetëm. Është koha. Është koha që ti të shkosh në shtrat, të lësh natën të depërtojë në ty, të kaplohesh në mërzë, të përfshihesh. Morfeu(hyjnica grek i ëndrrave) i mban lulëkuqet(lulëkuqja është simbol i kujtesës dhe i shpërsës për një të ardhme të paqetë) e tij. Një tufë lulëkuqesh. Nuk të merr gjumi? Arrite të mbash sytë hapur/gjysmë të hapur. Jashtë nuk ka vend për askënd në këtë kohë. Ndoshta. Nëse ata ndoshta nuk kanë organizuar një takim dhe e kanë zgjatur atë takim. Zhurma e atyre takave në trotuarin e gjatë i përket dikujt që së shpejti do të shënojë disa vargje në një fletore të vogël të zezë në vazhdën e takimit të sotëm. Kush mund të ishte, kush mund të ishte duke ecur me taka të larta në këto trotuare të gjata në këtë kohë, në këto anë? Dikush që e mori idenë nga dikush tjetër, që e bën atë rregullisht — që mund të largohej nga kënaqësitë e natës dhe rreziqet e saj me sytë mbyllur, dikush me një njohuri intime të ajrit dhe aromave të ndryshme që përhapen nëpër dhoma, shtretër dhe adresa pa emër. Ose ndoshta, përkundrazi, është thjesht dikush që qëndroi jashtë për herë të parë dhe humbi. Mos i mbyll sytë. Prit edhe pak. Morfeu mund të presë në hyrje të shtëpisë tuaj, në korridorin e poshtëm, poshtë derës tënde. Ai madje mund të presë në derën tënde ose pranë teje. Mund të presë edhe pak. Së bashku me të po pret një natë e gjatë. Mban dhe një kuti prej fildishi, të bardhë, të shkëlqyeshme, plot. Ka njerëz që po përpiqen të vendosin të dalin jashtë pavarësisht se sa vonë është. Si gruaja që nuk ka ndërruar rrobat që nga mëngjesi dhe qëndron atje poshtë në shesh, në pritje. Ajo do të presë për një kohë të gjatë. Në pritje prej një kohe të gjatë në këmbët e monumentit që qëndron aty në mes. Do të presë dhe do të presë më kot. Pastaj ajo do të ndjejë të ftohtin. Me gjasë derdh një ose dy pika lot, ose disa lot, një rrëke lotësh. Mund dhe të mos jetë për shkak të pritjes së saj të kotë. Një masë e ftohtë në ajër mund t'i bëjë sytë të përloren. Sakaq ajo do të qëndrojë në pritje dhe do të presë më shumë. Aty, rrëzë një monumenti që po ashtu pret prej kohësh, tek qëndron aty, në mes të sheshit. Po, ka nga ata që përpiqen të vendosin të dalin jashtë, pavarësisht se sa vonë është. Në fakt, është pikërisht sepse është kaq vonë natën që ata dëshirojnë të shkojnë: fikin televizorin, ngrihen nga divani, hedhin një xhakë të krahëve dhe zbresin shkallët pa u ndjerë në rast se dikush është ende duke lexuar dhe mund t'i dëgjojë, ndezin makinën dhe largohen. Pikërisht në këtë moment është kjo grua e re — beqare — që po bën ekzaktësisht këtë. Sapo doli nga dera e përparme, ajri i ftohtë i mbushi mushkëritë dhe në momentin që ajo hipi në makinë, e cila ishte e parkuar për së gjati, turiri i makinës kullonte nga shiu. E di se ku po shkon ajo, apo jo? Ndoshta ti nuk e di adresën, por e di se ku po shkon ajo. Ti e di se ku do të shkojë ajo; ose të paktën e ke ndonjë ide. Në këtë orë, një ndryshim dukshëm vihet re mbi të. Nuk mund të thuash që ajo u shndërrua në fantazmë, sepse fantazmat nuk ekzistojnë dhe mbi të gjitha, fantazmat nuk kanë trup dhe nuk dinë asgjë nga kënaqësitë e mishtore, ose kanë harruar. Siç e di, ajo nuk ka dhe shumë për të ecur dhe gjithsesi, në këtë orë dhe me një mot të tillë rrugët janë bosh. Së shpejti, ajo do të mbërrijë tek i dashuri i saj në fjetore, një shtëpi plot me çudira. Në këtë shtëpi duhet të matësh hapat, pasi ka disa që fllenë ndërsa dielli shkëlqen dhe zgjohen nga drita e hënës. Nuk duhet t'u kihet besë atyre që kanë sëmundjen e gjumit. Por dashuria është e verbër dhe kur bëhet fjalë për dashurinë, ne nuk jemi vetëm të gatshëm të qëndrojmë zgjuar, por për gjëra edhe më brutale. Vazhdo, fli, mos u shqetëso, unë do t'i mbaj sytë mbi ty gjithë natën. Mundohu të mos shqetësohesh. Le të të përfshijë nata për sa kohë që qëndron këtu dhe më lejo të jem me ty, të të shikoj dhe të të dua, për humbur pasi je në gjumë.

(Vazhdon)

MERIDIANET

Pas çdo faqeje,
duke kërkuar për një gjurmë
njeriu, shpaloset portreti

ROMAN

Immanuel
Mifsud

VËSHTRMË NË ERRËSIRËN E NATËS

OMBRA GVG

VJETI 1968

Ndjenjat e mia janë farë maranxhash e plasin nën diellin e fortë mbi rrasë.

E vetmja dashuni ime,
pse m'i len ndjenjat
të plasin nën diellin e fortë
mbi rrasë?

Ndjenjat e mia janë farë cipresash e plasin nën diellin e fortë mbi rrasë.

Dashunia shkon e më len
pa dheun e pranverës
e mbes i vetëm në kohën e pa ngjyrë,
e mbes i vetëm pa stinë
në vjetin njimij nandqind
e gjashtëdhjetë e tetë.

HERA

(Ai mal akulli kishte një emën
e s'mund ta thom,
ai mal akulli kishte një emën tabú.)

Para se mbylleshin sytë në gjumë, Hera,
pashë malin e akullit të bardhë
te kambët e mia.
Hera e fortë, shkrije akullin
te kambët e mia
me diell, Hera!
e qitni një bimë të blerë
aty te kambët e mia.

Mos e le akullin të rritet
ndër netët e ftofta e të preki
kambët e mia.
Në kohën e hijeve më merr në gj
deri në dritë, Hera!
Me zemër të flakët e me diell,
me trup të blerë, Hera,
deri në dritë me mue.

(Ai mal akulli kishte një emën
e s'mund ta thom,
ai mal akulli kishte një emën tabú.)

München, 1968

LUMTUNIA

Pranë meje rrjedh lumi
i qytetit të madh.
Nga uji del fryma e pishave
të ngime me rrëshinë
dhe dej pëllumbat e fjetun
nën diellin e verës së vonë.

Dritat e syve tu të mbyllun
dy molla të tejpushme
me bërthamë të kuqe në mes
përshkojnë rrezet e diellit
nalt në qiell.

Dhe rrezet e diellit zbresin
përsëri shkallave
npër rrembat e ajrit
deri në tokë
dhe në ujin e lumit
dhe në botën time të lashtë.

Prandaj dhe lumtunia në mue
asht një rrotull e bardhë.

München, verë 1968

LIDHJA

Ngrite dorën e këputi rranjët e shlira
që të lidhin me dheun tand, e Mbara,
para se me vlue mushti ndër degë.
Njeriu, që i thonë Uliks, po vien

21 korrik 1925 - 12 mars 1992

MARTIN CAMAJ

Lirika



me trajtën e re tue pru me vete
ullij të zez nga Jugu.

Hapësia asht jeta: a e ndien?
Njeriu, që i thonë Uliks, njeh
rrahjet e zemrës sate kur ti pushon
me fëtyrë të sjellun, pa e pa.

Ti nisesh e njeriu, që i thonë Uliks,
njeh hapat tu në hapësinë
me fëtyrë të sjellun, pa të pa,
e të ndien.

25.5.68

PESHA

Pesha e skamnisë
po më ndrydh, Hera.
Pranë meje lumej grunoresh
e unë jam i unshëm.

E jam sytrishtë, Hera,
kur shoh mes grunoreve
ty, tue ecë si frymë
me bukë në krah.

München 16.6.68

ME TY

Jam si jam, thëngjill
që digjet në gj, dy, tri herë
e mandej bie në letargun

e mendimeve, Hera,

dhe hini mbulon qenjen time.
Mbrenda në gjallninë e jetës
jam me ty.
Dhe jam me tokën
nën peshën e bimëve gjithfare
në këtë verë.

Në takim me ty
hini bie prej zemrës sime
e nuk jam i zi e shëndris.

München, 29.6.68

FATI

Shikoje fatin, Hera, ndër yj
që duken në largësi.
Andej dhe lumtunia u nis
kah na, yll i shkëputun,
e rrokulliset prej agimi
në agim.

Magjypja vren dorën tande
e flet e flet
për yllin e largët n'udhëtim.

Besimi rritet në tokën e butë
mes pemëve tjera
te bregu i lumit
nën diellin e fortë qershor.

Besimi rritet n'atë tokë.

KËSHTJELLI MBI UJË

Nuk kemi shtëpi askund, Hera,
e ajri sillet rreth nesh
në fushën e gjanë
e ajrinë ndan.

Nuk kemi shtëpi askund
dhe rrezet e hanës këpusin
gishat e duerve tona në rrugë.
Me gurët e banesës sonë
losin fëmija e rritun
brigjeve mbi ranë.

Ndigjo këtu, Hera!
Larg mbi ujë në det e kam
nji kështjell të msheftë
punue me hala peshku e alga
e shëndrit si ar gjithnatën.

Kur të lodhesh prej njerëzve
që shtrydhin gjurmën tande në kalim,
eja atje natën, mbi ujë e rri
në kështjellin tim.

Edhe nën mëngjes ti ke me gëdhi
në një kullë guri mbi dhe.

GAZI I NDALUN

Gazi i ndalun shëndrit sytë tu
e ledhatimi i tyne zbulon
nji anë të shpirtit tim.
A i sheh ti retë?
Ato s'e kqyrin tokën
tue u nxi nga hijet e fundit
të ditës e kthejnë në liqej
e bahen ujë.

Hera, gazi i ballit tand
po humb në mue
e bahet zjarr.

PO S'ERDHE TI

Po s'erdhe ti,
vien nata.

Më kujtohet dita jonë
- rreze mes gjetheve në pyllë.
Hera, kthe përsëri aty
ku na zuni nata.

Po s'erdhe ti,
vien nata.

Kur të zbardhen majet e alpeve
pres zanin tand
te dita jonë.

Po s'erdhe ti,
vien nata.

NGRITJA

zà brini ndër alpe
ulet muzgu, Hera, e pushon
në ne.
Malli im lëshon rranjë në ty
dhe ndiej si rritet gjelbrimi
në patalogjet e blera.
dhe rritet zemra ime
e flurim ngjitet përpjetë
ka maja gurore
në kapin e qiellës, në re,
ke lumtunia ime.

Sonte atje nalt do të shoh
andrrën e pakufi të ngjyrave:
zi, gjelbër, blerë,
ngjyra si grunë e si qiell
tue u derdhun në ty.

AGIMI I DITËS SË RE

Jam i lumtun, Hera,
që zjarri bie zjarr
e bebëzat e synit tand
shëndrisin
n agimin e ditës sonë.

Ngjyra e sendeve ndrroi

n'agimin e ditës sonë.

A ndien? Vera jonë
leviz n'ajrin e kullutë
n'agimin e ditës sonë

e ka me na zanë vjeshta
me pemë të pjekuna ndër duer.

E VETMJA DRITARE

E vetmja dritare mbeti e çelun
në banesën time vorri:
shoh një yll, një zog rrëmbyes
tue qindrue në ajr.

Hera, due luftën e zogut
kundra yllit,
luftën e yllit kundra zogut.
Due sosjen e shpendit
due ramjen e yllit
në shplakën e dorës sime,
në trajtën e gurit
të paçmueshëm,
rrezen e diellit në te
për një jetë, Hera.

Poqese këta nuk ndodh
e mbylla dritaren vetë.

TI QË KALON

Me kohë u rrxue një gur
nga mali im
dhe shkeli vetëm filizat e ahave
e mandej pushoi, i randë, në mue
dhe shtresat e ndjenjave e banë
themel qindrese së tynë në botë.

Ti që kalon para meje
mos vre me kureshtje
ndërtesën e ndjenjave të mia,
por ndiej gurin që pushon në mue
dhe merre me mend peshën e tij
në parzmin tand

pse çdo stinë e vjetit tim
të pakryem
ka rranjët e veta në ty.

PASHË NJI QYTET TË VJETËR

Pashë një qytet të vjetër
mesjetar
se si lulëzon në blerim.
Mandej erdhe ti
dhe harrova qytetin
e blerimin dhe u ula
me ngranë
qershiza të zeza
pranë gjive tu,
qershizat e rrituna
rranxë mureve të qytetit
mesjetar,
atje ku tash bie shi
i qetë, i qetë.

Sy tu e qartë si qiella
më shikojnë e bashkë
i ndiejmë piklat e shiut
mbrenda nesh dhe jashtë.
Kokrra qershizash, zi, zi
mbrenda nesh
e në kupën përpara nesh
e në gji.

ANDËRRTARI

Ecte udhës shtegëtari përpjetë
kalin tue mbajtë për kripë.
Kishte kambët e përgjakuna:
dy ditë rrugë kish bá zdashë
me kalë për dore
e asnji dhimbë s'kish ndie,
i tretun në mendimet e veta.
E qeshë kishte me vete

tue kujtue kalesën
dhe sende tjera, si për shembull:
si mbruhet buka në magje
e si rritet brumi, tue u ajë.
Ashtu rriten edhe vashat
dhe parzmin me dëshira
nuk iau nxuni as shtëpia e atit
e duelën një nga një nuse.
Dhe qeshte me vete
për shijen e vashave të katundit
që muerën për burra
djelm të hajshëm, të zbehtë
me sy grizhle të zvogluem
si nejt e zez të tryezave,
si nejt e zez në drrasa.

Mandej vrente trishtueshëm
udhën e gjatë, pa pasë kohë
të mendojë
se a mbaron ndokund.

KAM SHIKIMIN TAND NË SHPIRT

Kam shikimin tand në shpirt
dhe melodinë e pavdekshme
të gjakut në pasion.
Freskia mëngjesore
dhe bari i lagun fryjnë
zembrën time të zgjueme
nga prania jote në te.

Kam shikimin tand në shpirt.

Filli i zanit tand
depërton gjymtyrët e mija
dhe trajtat tua rrijnë
të pashlyeme
në bebzat e syve të mij,
që lahen për të parën herë
në jetë
në këtë mëngjes me diell.

Kam shikimin tand në shpirt.

MJEDJES

Erandja e makthit të katundares
të Nënshkodrës mbas vargjeve
të duhanit herë hera
ta ndjeva ndër vargje të dliirta
në kohën e parë. Në kohën e parë
më tërhoq vetmia e mbramjeve
tua të qeta
dhe në zembrën tande idhnake
s'besova kurr.

Shum vonë zbulova mbas fjalëve
të kristalta
drojen e zbërthimit të bulzave
para ngrijes dimnore, në fillim,
dhe para diellit të fortë, më vonë.
Shum vonë për ty, Poet.

Zemrat njerzore i mbylle
me druj çeliku para vehtes.
Vetmitar mes njerzëve tu
shujtoheshe me frytet e heshtjes
e na solle shpinën ftoftas
mue me shokë, pa kend tonin
në një leteraturë.

KULLOSHTRA

Fijet e para të barit dhe kingjat
prej barqeve të ngrofta të dhene vijshin
bashkë. Kulloshtra e re e fijet e para
të barit përziheshin bashkë e u zijshin
gjatë.
E kur më të rijt pyetshin: pse kjo gja?
Gjegja ishte e thjeshtë: pse është mirë.

Breznitë e reja skeptike pyesin për së dyti:
e pse është mirë? Zani i etënve – jehonë
kumbon: pse është mirë!
E vrainjë të vjetrit pse donë me vra
në shpirt kujtimin e të njomit të bukës
mbas një dimnit të gjatë të fëminisë.

Bari i njomë kulloshtira në zjarm
e dielli tue u ulë në luginë
është e vetmja lirikë e tatgjyshit
e sdon ta ndrrojë me vargjet
që shkruajmë ndër letra, na.

RELIKET E KOHËS

E kujtoj fëmi endë para kandilit
fityrën tande më të ndritun se flaka.
Dhe e dijsa se ke me u bâ e hijshme
kur pijshe ujë etshëm mbas shujte.
E dijsa se vjeshta ka me mbushë pusat
me pika shiut plot e për maje.

Tash del hana e re çdo muej
e më bjen me vehte jehonën
e vonueme të kohës sate.

E pyes vehten: si mundet ajo
me kthye buzë pusave të ngimë
ku tash janë mure punue me gur
të latueme dhe ndoshta ndrisin dhe kandila
të ri
ngarkue me tym.

Dhe dashunoj më tepër ate grue
pse endë merr pranverën e jetës
në atë trup të mbuluem me tesha
të ashpra zhguni
pse ajo është një rreth në vargonin
e jetës seme që e due të tanësishme.

DHE PLOTNI TË PËRSOSUN

Vapa e mbasdites ngjitet prej gropave
e shenanve të thatë në kodrina te era.
Ti zemër, e era bashkë përzieni
rrezet e diellit njanën me tjetrën
e të gjithë bashkë gatoni gëzimin
per darkë.

Asht vapë e pushoni në prehnin e saj
e në parzëm, ti dhe era, zemër.

Ajo quhet Mena dhe e dashunoj
për zytë e zez që ka: ata shkëlqejnë
nën hijen e vetullave e ballit
të mrekullueshëm dhe gëzohen
për njimij kënaqsina të vogla.

Ajo, zemra eme dhe era përftojnë
lumtuninë në vapën e thyemjes së ditës
dhe timtat e orës e ora
përbajnë një tansi të pandame sendesh
dhe plotni të përsosun.

XXX

E ndiej frymën tande në buzë
e drue se jet afsh vere
e digjet në re.
E dora në sup
ndoshta bahet flutur
e tret në livadhe.

Zani yt do tëbesë
i gjatë, i gjatë, në mue.


FORTUNA

Prej gjinint të ujit ngriten
mija sende e rroken me vala.
Nata e errët
mbulon turbullimin e detrit.

Kush harroj mbramë
barkat në breg
nesër nuk i gjen më atje.

Andrrat e mija të shqetësue
ikun në terr.

Agimi tash vien
e zbardh andrrat e mija
mes detit të qetë
mbi barkat e humbuna natën.



Tirana dashuri tiranike
me thundër mall
të vë përposht, të mposht
që se shpërbën koha
formulë e pazbërthyeshme
në asnjë laborator
virus, kolerë, Covid
që paradoksalisht
të mban frymën gjallë
nektar Zotash
rebus i pazgjithshëm
nga inteligjencia artificiale
që se djeg as acidi, as zjarri
krater vullkani
nuk e rrëzon asnjë dekret
asnjë diktator apo grushtshtet

Tirana mall i krisur,
grimuar si kristali mijra grimcash,
mijra grimcash i ngjitur
përrua i ndërjegjes
na thith e tërheq si manjeti
forcë graviteti

Tirana qytet i përhumbur
i shpyllëzuar
mall resh sipër yjesh
i gurëzuar
rreth qafës lidhur nyjesh
i nyjëzuar
zjarr i mbuluar, i fikur
dhë i ligështuar, i ligur
prej shpopullimit
s'do të ngopesh kurrë
me fytyrat e bijve
nga dashuria të ngjizur
nga urrejtja klasore
të vvarë e të ikur

*

Tirana qiell i mbirë
me gjëmbaçë
nga pritja sflitur
ku malli fluturon
mbi rropulli resh davaritur
skifter krahëhapur,
i tendosur,
nën qiellin e përgjuar
për liri i uritur

*

Tirana
gravura të ngadhnjyera
relikash
Ura e Tabakëve
Xhamia e Et'hem Beut
Sahati miniaturë tiranase
e Big Benit
qytet pa rrugë shinash
pa stacion treni –
dëshmitar i vetëm
qielli i thellë, blu,
bukuri e ciflosur
e syve ngjashënjë të reve
muranë e murosur

*


tek kangjellat e tyrbes
së Dervish Hatixhesë
kapur për dore
gjyshe e mbesë
ndezin qirin
e Zotit i luten me përgjësë
pa zë me mërmëresë
t'ju shpëtojë
nga fermani i shortit
birin dhe atin...
mbi Dajt një re e gjakosur,
lulemullagë e pafajsisë
bie në gropën pa emër
për të pafatin

*

Tirana trekëmbësh i lutjeve
nga buzë të dridhura jetimësh
të etërve jetëshuar
gjoksshpuar
nga breshërimat

*

Nga gazet e zinj



ymbushur lot
për herë të fundit
ia hodhën amanetet
Lanës
Senës së Tiranës
pak para se trupat e tyre
të binin si drurë të sharruar
në gropat vulëhumbura
rrethinave të kryeqytetit
me yllin e kuq kryqëzuar

*

askush si pa ata djem nënash
etër të rinj fëmijësh zemërmardhur
veç terri i zi
lajmëtar i mandatës
ia nguli sytë
skuadrës së pushkatimit
bashkë me kukuvajkat
dhe lakuriqët e natës

*

pa varre do mbesin,
pa u vajtur nëna, gruaja
trashëgimtarët
tiranasi, qytetarët
pa qirin dhe buqeta lulësh
emra të zhdukur
grumbuj eshtrash humbur
pa nam e nishan
periferive të Tiranës
shpërndara nëpër
gërmime e humbëti
aty ku pëllumbat
sapo u rriten pak krahët
ikin, marrin arrati

*

Tirana malli im i djegur
shkrumb e hi
kosë hënore e qytetit qeli
nën qiellin e mavijosur
me hematoma
torturash mavi

*

familjet gdhieshin
po s'ngryseshin
se vinin kamionët
i ngarkonin si rrangulla të vjetra
të vegjël, prindër e pleq
me rrobat e trupit i dëbonin
në humbëtira gulagësh i internonin

*

fëmijët zemërharabelë
pyesnin se
kur do të ktheheshin
në shtëpitë e tyre në Tiranë
të luanin me shokët
të ndiqnin në klasë
vijimin e mësimin
ndërsa mësuesja të nesërmen
dorëngrirë do t'ju vinte vizë
mbi emrat në regjistër
pa dhënë asnjë shpjegim

trashëgimtarë bijësh armiku
degë të sapombira
të një pylli të tërë të ri
sythe e bula,
pleq, djem, vajza, gra e burra
brez pas brezi mbi ta
si Yll i Verdhë Davidi
do t'ju ngjitej në lëkurë vula

ata të gjithë Tiranë
të luteshin t'i mbroje
besonin tek ty
pa llogaritje
të gatshëm për çdo provë e bast
të deshën me gjithë shpirt siç ishte
me një Pallat Mbretëror
pa monark,
pa skeepër e kurorë
pa apostuj, pa samizdat*
me nje Pallat Kulture ikonoklast

*

braktisja ateiste
u mbyti besimin jetim
në fund të detit Adriatik
e dashuria e tyre për ty
nuk vlejti asnjë grosh
e tash Tiranë e dashur
nga dhimbja e zvogëluar
sa një grusht
je e gatëshme për bijtë e tu
me Perënditë të grushtohesh
ashtu e dërmuar
në çdo cep të botës t'i kërkosh
nën mavijosjen e qiellit mavi
shpuar tej për tej në zemër
nga turjelat e qiellçjerrëseve bosh

*

Tirana prej tetë dekadash
e gjitha një ish
ish Radio Tirana
ish Bulevardi Zogu i Parë
ish Shtypshktonja Gutenberg
ish Hotel Bristol
ish Kafe Kursal
ish Libraria Lumo Skëndo
ish Shtëpia e Oficerëve
ish Kafe Rinia
ish Kafe Flora
ish Pastiçeri Agimi
Tirana vetëm ish
pa asnjë gjurmë e shenjë
sikur s'ish

*

ish shtëpia e Nënëdajës
ish Pazari i vjetër
ku im atë blinte kajmak
për gruan e tij të bukur
shtatzanë
ish birraritë e vogla
ku tymi dhe era e mishit
nën shoqërinë e krikllave të birrës
brënda të ftonin
të shijoje panine të ngrohta
me qofte zgare me rigon

*

ish Banja Publike
ish Shtëpia e Gjethëve
ish klithmat me oh dhe oi
ish torturat shnjëzore
ish Kinema Republika
ish Partizani i Panjohur
ish ylli i përgjakur i Muzeumit
ish piramida
ish Lidhja e Shkrimtarëve
ish komiteti qendror
ish rrëzimi i diktatorit
gjithçka një ish
sikur
kurrë s'ish

*

ish reklamat e filmave
tek ish komitetit egzekutiv
Ish Instituti i Kulturës Popullore
ish stacioni i trenit
ish Teatri Kombëtar
i hedhur në erë në mesnatë
me skenat, rekuizitat,

kostumet e Hamletit,
Ofelisë, Dezdemonës, Jagos
me sportelin e biletave
kolltukët e platesë, llozhave
i masakruar barbarisht
në ditën e kijametit
në shekullin njëzetë e një
e gjithë Tirana një ish
sikur s'ish
e gjitha veç
një grumbull kaosi rrapullish

*

Tirana ime e gjitha një ish
ish qytet ateist
me kishë katolike
kishë ortodokse
me minare e xhami
e mishmash partish

*

Tirana një ish hamam
otomanizmi komunist
prej arratisë së mbretit
deri nën vrundujt
e avujve të narkoshtetit
me disa toponime fluide
Dajti, Lana, Ura e Tabakëve
Kombinati, Kinostudio,
Spitali, Selvia, Braka
ka mbetur qielli i ngijer
nga kuq në mavi prej honi
me 300 ditë me diell të palumtur
që djegin si flakë inkuizicioni

*

por malli mbetet tatuazh në lëkurë
i qepur me makinën e gjyshe Singer
që historitë e familjes fshihte
nën qerpikë me pengun
se do t'i merrte me vete
në botën tjetër
pa na i treguar
se muret vigjëlonin, veshëngritur
sypagjumë, natë e ditë
duke përgjuar

**

Tirana pa trolejbusë
e shina tramash
pa bare e klube nate
pa zgjoje fantazish e fantazmash
e dehje të çmendura
pa agjensi udhëtimesh,
për lamtumira me lot ndarjesh
si balada flijimesh

*

të gjithë brënda
në një vathë delesh
kullosnim në bulevardin e madh
shtylla kurrizore e qytetit
nga jugu në veri
nga Materniteti
tek Korpusi Universitar
mollë e ndaluar ishte dija
për shumë djem e vajza tirane
edhe në dashuri ishte e ndaluar të bije
vëllai i madh çekan mbi krye
moralit komunist të ndiqte hije
duhej të jepte vizë dhe lejë partia

*

ajo vajza me sy të trishtë
si të Sylvia Plath
nuk lejohet ta dashuroni
se s'ka biografi të mirë
kujdes ai djalë me kaçurela biond
si të Byronit
urrejeni sa të mundni
gjyshin e ka të arratisur në Amerikë
të jatit e ka në burg
është vetë kolera mos e afroni

rinia e Tiranës fytyrbukura
jetonte ditë krahëkëputura,
me përjashtim të rrugës
me emrin ilegal Broadway
ku ëndërrohej pa doganë
për fluturime pindarike
mbi Harley Davidson

të shpranguar, duke uluritur me shpirt
këngët e Jimmy Hendrix,
Rolling Stones e John Lenonn
dhe kush e di
ndofta dhëmbështrënguar
hitin rebel të Sam Cooke
A change is gonna come

*
ndodhte që mendimet
çliroheshin
prej pyllit
me gjëmbaçë kaktusesh
e bridhnin të lira
në bulevardin veri-jug
nga Materniteti
ku kishim lindur ne
e gjithë rinia
tek Korpusi Universitar
gjallërohej e lëvizte jeta
si një Lum Rin sysh të ndezur
jerm zjarrmie
i gatshëm për udhëtime
ndërplanetare
e histori të ndaluara dashurie

*
Tirana ime e veshur kokë e këmbë
me dok e terital
mbathur me këpucë uniforme, të rënda
takat e larta high heels
ishin mbeturina borgjeze, të huaja
vajzat nuk i shihnin as në ëndërr
e kishin të ndaluar

*
qytet me rrugë pa auto
pa semaforë të kuq, të verdhë, të gjelbër
me linja autobuzësh të mjera
me ndejtëse të shqyera, pis, të ndyra
ku varfëria luante tragjedi e drama
me damar të prerë
nga vuajtjet dhe traumat

*
Tirana ime e burgosur e ndërjegjes
nuk kishe ku të shkoje e nga të vije
i gjithë globi dhe universi
ndahej me gjyshe, dajo, xhaxhallarë,
halla e teze
që sot bëjnë gjumin e trazuar
nëpër varreza pa qetësi e paqe
mes gjëmbaçësh kryeneçë e shkurresh
prej mallit për të dashurit
që i kanë të shpërndarë nëpër botë larg,
për t'ju ndezur qirinj e sjellë buqeta lulesh

Tirana dashuri tiranike
me thundër malli
të vë përposht, të mposht
që se shpërbën koha
formulë e pazbërthyeshme
në asnjë laborator
virus, kolerë, Covid
që paradoksalisht
të mban frymën gjallë
nektar Zotash
rebus i pazgjithshëm
nga inteligjencia artificiale
që se djeg as acidi, as zjarri
krater vullkani
nuk e rrëzon asnjë dekret
asnjë diktator apo grushtshtet

Tirana mall i krisur,
grimuar si kristali mijra grimcash,
mijra grimcash i ngjitur
përrua i ndërjegjes
na thith e tërheq si manjeti
forcë graviteti

*samizdat – aktivitet disident, shpërndarje në
mënyrë klandestine e literaturës letrare apo
publicistike të censuruar kryesisht në BRSS

Janar-Mars, 2024

(Nga libri *Skaterr* që autorja
po përgatit për botim)

PAFAJËSIA E FUNDIT

poezi nga Alejandra Pizarnik

Shkrimtare dhe përkthyes argjentinase. Pizarnik zhvilloi një ndër veprat letarare më origjinale dhe të habitshme të shek. XX. Vargjet e saj janë në një tension ndërmjet automatizmit dhe surrelizmit dhe ekzaktësisë racionale, tejkalojnë edhe vet jetën e poetes, duke na ndërfutur në nostalgjinë e saj të fëmijërisë së humbur, tërheqjen ndaj vdekjes, intimitetit të thellë dhe dëshirës për të qenë e dashur dhe e njohur.)

Solli në shqip nga origjinal Manjola Brahaj



REMINISHENCAT

Dhe koha e ngulfati yllin tim
katër numra enden të maskuar
duke i nxirë ëmbëlsirat
dhe koha e ngulfati yllin tim
ecte i fyer mbi pusin e errët
shkëlqimet qanin në gjelbërimin tim
e unë shikoja e shikoja
dhe koha e ngulfati yllin tim
të kujtoj tre klithje të
tokave të maleve dhe radio të errëta
dy gota të verdha
dy fyte të çjerrur
dy puthje komunikuese të vizionit të
një ekzistencë në tjetrën ekzistencë
dy premtime vajtuese të
shkëlqimeve tmerruese të panjohura
dy premtime për të mos qenë për të qenë
për të mos qenë
dy ëndrra duke luajtur pusinë e fatit në
rrethrotullimin e një kozmosi prej
shampanje të verdhë në të bardhë
dy shikime duke siguruar lakminë e një
ylli të vogël
dhe koha e ngulfati yllin tim
katër numra qeshin në rrotullime të
neveritshme
vdes një
lind një
dhe koha e ngulfati yllin tim
kërcime zambakësh ujqorë të zjarrtë
shkëputin hijet e mia të ardhshme
një mjegull enigmatike rimbush
qoshkun e vetmisë sime
hija e diellit shtrydh
sfinksin e yllit tim
premtimet mpiksen
përballë shenjave të yjeve të ngulfatur
dhe koha e ngulfati yllin tim
por esenca e tij do të ekzistojë
në brendësinë time të pavdekshme
shkëlqen esenca e yllit tim.

ZGJIMI

León Ostrovit

Zotëri
kafazi është bërë zog
e ka fluturuar
e zemra ime është çmendë
sepse ulërin deri në vdekje
e u qesh pas erës,
delireve të mia.

Çfarë do të bëj me frikën?
Çfarë do të bëj me frikën?

Tani nuk kërcen drita në buzëqeshjen time
as stacionet nuk djegin
pëllumba në idetë e mia.
Duart e mia janë zhveshë
e kanë shkuar ku vdekja
mëson si të jetojnë të vdekurit.

Zotëri
Ajri më dënon qenien
matanë ajrit ka përbindësia
që pijnë nga gjaku im

Është shkatërrimi
është koha e boshit pa boshësi
është çasti për t'u vënë çelës buzëve
t'i dëgjosh të denuarit duke bërtitë
duke vështruar secilin prej emrave të mi
të mbytur në asgjë.

Zotëri
I kam njëzet vjet
edhe sytë e mi i kanë njëzet vjet
e megjithatë s'thonë asgjë.

Zotëri
kam sosë jetën time në një çast
Pafajësia e fundit shpërtheu

Tani është, asnjëherë o kurrë
ose thjesht, iku.

Si nuk vetvritem para një pasqyre?
e të zhdukem për t'u rishfaqë në det
ku një varkë e madhe do të më priste
me dritat e ndezura?

Si nuk i zhgul venat
e të bëj me to një shkallë
për të ikë në anën tjetër të natës?

Fillimi i ka dhënë dritë fundit
Gjithçka do vazhdojë njëlloj
Buzëqeshjet e harxhuara
Interesi i interesuar
Gjestet që imitojnë dashuri
Gjithçka do vazhdojë njëlloj

Por krahët e mi insistojnë që të
përqafojnë botën,
sepse ende nuk ua kanë mësuar
që tashmë është tepër vonë

Zotëri
Hidh arkivolin e gjakut tim.

Kujtoj fëmijërinë time
kur unë isha një plakë
Lulet vdisnin në duart e mia
sepse kërcimi i egër i gëzimit
ju shkatërronte zemrën.

Kujtoj mëngjeset e zeza të diellit
kur isha vajzë
si të thuash dje
si të thuash para shekujsh.

Zotëri
Kafazi është bërë zog
e ka përpirë shpresat e mia.

Zotëri
Kafazi është bërë zog
Çfarë do të bëj me frikën?

PAFAJËSIA E FUNDIT

Me u nisë
me kurm e shpirt
me u nisë.
Me u nisë
me i heqë qafe shikimet
gurë shtypës
që flejnë në fyt.
Duhet me u nisë
jo ma inerci nën diell
jo ma gjak i shtangun
jo ma me formue radhë për me vdekë.

FERRI MUZIKOR

Godasin me diej

Asgjë nuk lidhet me asgjë këtu

E nga kaq shumë kafshë të vdekura në
varrezat e eshtrave të mprehtë të
kujtesës sime

E nga kaq shumë murgesha që si sorra
nguten për të luajtur mes
këmbëve të mia

Shuma e fragmenteve me shqyen

Dialog i papastër

Një projektim i dëshpëruar i materies
verbale

E liruar nga vetvetja

Duke u ngulfatur në vetvete

SAMANTA SCHWEBLIN:

Letërsia ka një fuqi të pakrahasueshme

Bisedoi: Florencia del Campo

Përktheu Granit Zela

Florencia del Campo. Le të fillojmë duke folur për letërsinë e Amerikës Latine. Çfarë përshtypje keni për panoramën e letërsisë latino-amerikane në përgjithësi dhe më konkretisht për mundësinë e qarkullimit të saj në gjuhë të tjera?

Samanta Schweblin. Letërsia e Amerikës Latine është rritur shumë gjatë dhjetë viteve të fundit. Jo se mendoj që njerëzit shkruanin më pak më parë, apo se brezat e rinj janë më interesant se të mëparshmit. Ka të bëjë me shumë me faktorë të tjerë, si rritja e botuesve të pavarur, më pak monopole të shpërndarjes së librit, më shumë kontakte mes botuesve dhe autorëve të vendeve të ndryshme. Dhe ekziston po kështu një grup lexuesish të rinj që janë shumë më të rëndësishëm për vazhdimësinë e suksesit të botuesve spanjollë, sepse më shumë latino-amerikanë po botohen në Spanjë, dhe kjo na afron më shumë me përkthimet.

Mendoj edhe se është një moment i mirë për përkthimin e letërsisë. Libri i parë u botova në vitin 2001, por vetëm në vitin 2010 u botova në Spanjë, ku ma merr mendja se filloi cikli i përkthimit. Vetëm në dy vjet pati rreth pesëmbëdhjetë përkthime dhe mbaj mend që edhe botuesit u befusuan nga këto shifra, jo vetëm sepse isha një autore e panjohur, por sepse ishte një libër me tregime. Më kujtohet që rasti im u diskutua si një përjashtim i madh, por gjatë viteve të fundit ka pasur disa raste kur romanet e para, apo edhe përmbledhjet e para me tregime për shembull, janë përkthyer menjëherë në anglisht. Dhe për më tepër, njerëzit i lexojnë, sepse disa prej tyre janë edhe fitues çmimesh prestigjioze ndërkombëtare, të cilat të vënë në spikamë përtej audiencave të zakonshme. Mendoj se kjo shkon krahas rivlerësimit të figurës së përkthyesit, i cili nga një emër i fshehur në faqen e të drejtave të autorit të librit ka kaluar në ballinë, madje duke u kthyer në një lloj "botuesi" në kuptimin që sot disa disa libra shiten sepse janë të përkthyer nga përkthyes të famshëm dhe në shumë raste përkthyesit bëhen pjesë e këtyre çmimeve për romanet ndërkombëtare pothuajse

si bashkautorë të librit. Unë e mbështes plotësisht këtë prirje.

Çmimet letrare përfundojnë duke kurorëzuar një fitues, por ushqejnë idenë e një premtimi. Si e përjetoni këtë lëvizje të dyfishtë?

Pse shkrimtarët flasin kaq pak për paratë, kur është gjithmonë e nevojshme të kesh një punë tjetër përveç të shkruarit, për të blerë kohën e mjaftueshme të lirë për të shkruar? Dhe koha është një nga gjërat më të shtrenjta në këtë botë. Përpiqem të mendoj që çmimet u jepen librave dhe jo mua. U jam mirënjohës atyre dhe e di që ofrojnë mbështetje të rëndësishme për librat.

Dua t'i kthehem pak asaj që zakonisht thuhet për prirjet bashkëkohore të letërsisë në Amerikën Latine. Madje përdoren emërtesa për t'i grupuar autorët në lëvizje letrare si "Gotikë Andeanë", "Gotikë Pampeane", "Neo-rurale", "krijim autoletrar", apo çfarëdo qoftë tjetër. Dua të di nëse leximi që i bëni panoramës së tanishme letrare ndahet në këto kategori dhe, veçanërisht, nëse mendoni se prireni të bëni një dallim në letërsinë e Amerikës Latine midis asaj që krijohet në kontinent dhe asaj që krijohet jashtë vendit.

I kam lexuar se kolegët e mi autorë pa i parë brenda këtyre emërtesave. Më pëlqejnë emrat, sepse ka diçka përvetësuese në to - gotik, por i bërë në Ande ose në zonën e Pampas. Gjithashtu sepse ka një rivlerësim të letërsisë së zhanrit të fantazisë, horrorit dhe fantashkencës, të cilat më në fund kanë filluar të shihen si "letrare". Por nuk jam e qartë për përkufizimet dhe nuk i marr parasysh ato etiketa kur zgjedh libra për të lexuar ose kur i analizoj ato.

Më ngjall interes pyetja juaj nëse ka ndonjë gjë që i dallon apo bashkon letërsitë që janë shkruar jashtë vendeve tona të lindjes. Pyes veten se çfarë ndodh me versionet e spanjishtes në të cilat shkruan secili prej nesh, sa do ta pengojë lexuesin apo një histori të caktuar - ose anasjelltas, sa do të ndihmojë - kur shkruajmë në këto variante

spanjolle të folur ata si ne që jetojmë jashtë vendit, të cilat janë prekur nga harresa e shumë fjalëve, nga huazimi i të rejave, ose nga ndjenja e mungesës së fjalëve në gjuhë të tjera për të cilat nuk kemi një përkthim në gjuhën tonë. Më duket se për brezat e rinj që shkruajnë jashtë vendit, spanjishtja bëhet diçka më shumë një gjuhë vetjake, një spanjishte unike që është pothuajse një hartë ku mund të lexosh se në cilat qytete kanë lindur këta autorë, çfarë traditash i kanë formuar dhe ku po shkruajnë tani.

Si e kuptoni idenë e të qenit e huaj gjë që krijon tensionin midis vendit të lindjes dhe atij ku jetoni? Pyetja ka të bëjë me praninë fizike dhe subjektive (trupore) që banon në një vend të huaj, por edhe për mundësinë që gjuha të jetë në vetvete një tjetërsim, diçka e huaj. A është gjuha gjithmonë e huaj?

Jetoj më së shumti në një zonë të madhe të Amerikës Latine, kështu që po, spanjishtja ime është shumë e tjetërsuar. Në Berlin, miqtë e mi janë kryesisht meksikanë, kilianë, spanjollë, venezuelianë, kolumbianë. Dhe jam shumë e vetëdijshme se sa shumë, nga këndvështrimi i një lexuesi më argjentinas, kjo e çnatyralizon plotësisht spanjishten time. Jetoj jashtë vendit tim, por sapo një histori e re fillon të më bëhet njësh në mendje, e gjithë imagjinata ime udhëton menjëherë në Argentinë. Në një farë mënyre, jam ende atje. Pra, personazhet e mi janë para së gjithash argjentinas që kur hapin gojën, flasin në mënyrë të çuditshme.

Para disa vitesh, kur po shkruaja *Kentukët* (2018), kjo më trembi pak. Mendova, cila është gjëja më e natyrshme? A duhet ta ndryshoj në mënyrë artificiale spanjishten time të vërtetë, atë që flas tani, sa herë që flasin personazhet e mi? Apo duhet ta lë spanjishten time të re të rrjedhë dhe ta pranoj atë tjetërsim të lexuesit? Pyetja më trembi sepse nuk ndihesha rehat me asnjërin nga këto dy skaje. Kisha frikë sepse mendova se zgjidhja ishte asnjënjësia. Mendoj se e natyrshme që kërkoj nuk është një përgjigje që gjendet te spanjishtja apo në një gjuhë tjetër, por në gjuhën e veçantë që i përket çdo libri.

Ideja e tjetërsimit në gjuhë më shtyn të mendoj për të çuditshmen si diçka që prish një rend në dukje normal. Në historitë tuaja ndodhin gjëra të çuditshme, por ato skaliten brenda realizmit. Çfarë reflektimi mund të bëni për këtë dhe për zhanret me të cilat punoni apo grisheni të provoni?

E çuditshmja nuk bie ndesh me realizmin. Mbaj mend që vitet e adoleshencës i kam kaluar duke lexuar realistët amerikanë dhe miqtë e mi, të cilët i njihnin perënditë e mia më të mëdha asokhe ishin Ray Bradbury dhe Kafka, dhe ndërsa atëherë shkruaja vetëm histori fantastike, më pyetën të habitur pse isha kaq e fiksuar pas Raymond Carver-it, Tobias Wolff-it dhe John Cheever-it. Ndjeva se e çuditshmja krijohet kur vihej në pikëpyetje "e vërteta" apo "normalja" dhe se krijimi i kësaj ideje të realizmit ishte po aq i rëndësishëm sa ngjarja që e prishte atë. Duhet të kesh diçka për të prishur, apo jo? Përveç kësaj, çfarë është realiteti në letërsi? Normalitet? A është ajo që është shoqërisht e pranueshme si e mundur dhe e njohur? Nëse dakordësia shoqërore nuk është e përbotshme, për çfarë shërben letërsia, nëse jo për të parë gjithçka që është e çuditshme? Mendoj se edhe te historitë më realiste, letrarja gjithmonë fillon kur ndodh diçka e çuditshme ose e papritur.

Jam i interesuar të përmend një temë të përsëritur në historitë tuaja. Ose më shumë se një temë, një çift: çiftin nënë-bijë. Doja t'ju pyesja për marrëdhënien midis kësaj lidhjeje si lëndë letrare dhe dy koncepteve të mëparshme që keni hulumtuar: e huaja dhe largësia. A ka lidhje mes tyre?

Ndoshta po. Njerëzit ndonjëherë më pyesin pse më intereson kjo marrëdhënie, kur nuk jam nënë. Ndiej se duhet të justifikohem dhe të them gjëra të tilla si "Zgjodha të mos bëhem nënë" dhe, veçanërisht, të them se nuk kam asnjë keqardhje për këtë zgjedhje. Por nëse nuk ka asnjë problem në nivelin vetjak, pse i kthehem kësaj marrëdhënieje? Dhe ja ku pyetja juaj më duket zbuluese, madje, po, është e huaja, kureshtja. Nuk e di sa jam e interesuar të shkruaj për një grua dyzet e tre vjeçare që jeton dhe shkruan në Berlin - sepse për këtë kam jetën time. Ajo që më intereson është gjithçka që nuk jam. Nënë, baba, koreane, gjermane, djalë, kalë, plakë. E huaja është gjithmonë e huaj dhe largësi. Dhe largësia më ndihmon të shoh më qetë, më jep kohën që më duhet për të kuptuar.



Meqenëse jemi te tema e mëmësisë, po shfrytëzoj rastin të flas për *Largësi shpëtimi* (2014) dhe të lavdëroj përshtatjen e saj si film. Është e njohur nga publiku që keni punuar shumë për përshtatjen së bashku me Klaudia Llosan. Besoj se keni studiuar për film në kolegji - e keni ndjerë se ky proces është një rikthim te ky lloj mediumi?

Po, kam studiuar filmin, por në mendjen time prirja ishte gjithmonë drejt të shkruarit, kurrë nuk kam menduar të bëj filma. Thjesht doja ishte të kuptoja se si shkruhen filmat, doja një fushë studimi ku bëhej gjithmonë pyetja se si duhej të tregohej një histori, dhe studimi universitar për filmin i përgjigjet kësaj në të gjitha disiplinat: tekstin, imazhin, fotografinë, redaktimin, zërin. Por më kujtohet shumë mirë që isha e vetëdijshme se po bëja diçka gati prej autodidakteje. Ndërsa të gjithë mendonin për filmin, të gjitha veprat e studiuara, sprovat dhe qëllimet e mia ishin letrare. Pikërisht gjatë atyre viteve të studimit të filmit fillova të ndiqja seminare për të shkruarit në Buenos Aires, shkrova dhe botova librin e parë dhe mbarova studimet pa u përfshirë ndonjëherë profesionalisht në asgjë që kishte të bënte me filmin.

Kur Klaudia Llosa ma sugjeroi që ta përshtatnim romanin së bashku për ta bërë film, m'u duk një sfidë e madhe. Mësova shumë nga përvoja dhe shpesh ishte një lloj trampoline - në shumë takime tona shpërqendroheshim duke folur për orë e orë të tëra për kryqëzimet midis filmit dhe letërsisë, për teoritë tona, për format, strukturat, mundësitë. Kalimi i këtyre ideve me dikë që vjen nga bota e rrëfimit të historive, por që punon me një lëndë kaq të ndryshme doli të ishte shumë produktive më vonë për të shkruarit, dhe mendoj se e njëjta gjë ishte e vërtetë edhe për Klaudian.

Mendoni se filmi ka ndikuar në letërsinë tuaj?

Me siguri që ka edhe ndikime të filmit në atë që shkruaj, por janë më të vështira për t'i dalluar. Jam e vetëdijshme për libra të veçantë që mund të kenë ndikuar pothuajse në të gjitha historitë që kam shkruar. Më kujtohen libra, imazhe, situata nga përditshmëria ime, por nuk mund ta bëj këtë lidhje me filmin, ndihem vërtet sikur është në një botë tjetër. Është sikur, midis filmit dhe letërsisë, rregullat, historitë dhe teknikat me të cilat tregohet një histori të ishin vazhdimisht në kontakt, por jo lënda e tyre, jo thelbi me të cilën tregohen. Filmi ndodh me lëndën e botës sonë reale; edhe një film fantastiko-shkencor ndërtohet me botën materiale që na rrethon. Letërsia ndodh në mendjen e lexuesit. Mund të jetë po aq pamor dhe lëndor sa filmi, por ngarkesa emocionale e lexuesit riformëson gjithçka me një fuqi që për mua është e pakrahasueshme.

Për vite me radhë keni drejtuar kurse për të shkruarit krijues në Berlin. A vazhdoni ta bëni?

Vazhdoj ta bëj, por jo më në shtëpinë time, siç bëja dikur në Buenos Aires dhe Berlin. Mbjaj seminare në universitete, si për shembull *Të shkruarit Krijues* në nivel Masteri në Pompeu Fabra të Barcelonës, apo në Frei Universitët në Berlin. Kalova në universitet sepse, nga njëra anë, ndihem sikur kurset për të shkruarit më ndihmojnë të kem një vështrim më teorik për atë që zakonisht bëj me intuitë, ato më detyrojnë të mendoj për problemet që duhet të zgjidhen për të krijuar universe, tone, histori dhe stile, gjë që atje bëhet në mënyrë më të natyrshme dhe gjithmonë ndodh të marr informacione të reja nga auditori. Studentët më japin shumë energji, përherë jam shumë e emocionuar kur shqiptoj me zë të lartë mendimet e mia për proceset letrare dhe i zgjerojë ato me një grup pune, ngjan si një gjë vërtet e nevojshme për t'u bërë - nuk mendoj se do të heq dorë ndonjëherë nga mësimdhënia. Por problemi është se nëse ato kurse për të shkruarit zgjasin një kohë të gjatë, siç ndodhte kur i organizoja në shtëpi, mendja ime sikur fillon të merret më shumë me tekstet e studentëve të mi se sa tek unë. Dhe nuk më duket gjë e mirë.

Është interesante të theksohet një pyetje e përsëritur si të sigurosh jetesën nga kjo zeje, si ta bësh letërsinë jo thjesht një pasion apo edhe një mënyrë jetese, por më tepër të jetosh prej saj (d.m.th., letërsia e lidhur me tregun dhe fuqinë punëtore në një botë kapitaliste). Problem i madh është se sa pak paguhet arti krijues dhe nuk ka shumë zgjidhje për këtë. Nëse heqim njëzet ose tridhjetë shkrimtarët më të shitur që mund të gjeni në çdo vend, shumica e autorëve nuk e sigurojnë jetesën nga të shkruarit, por më tepër nga letërsia, duke shkruar artikuj, duke organizuar kurse për të shkruarit ose duke punuar në shtëpi botuese. Të gjitha këto janë gjithashtu



punë të paguara pak, kështu që duhet të kesh disa punë të tilla për të marrë një pagë të plotë dhe nuk të mbetet shumë kohë për të shkruarit. Kur njerëzit më pyesin pse u shpërngula në Berlin, mendoj se presin të flas për këtë qytet të mrekullueshëm shumëkulturor me hapësirat e gjera, plot parqe dhe liqene dhe bibliotekën më të madhe ibero-amerikane. Por e vërteta është se qëndrova në Berlin pikërisht për paratë. Për të gjithë kohën e lirë për të shkruarit që më dha ky qytet.

Së fundi, do të doja të dija se çfarë jeni të interesuar të gjeni tek gratë shkrimtare të brezit tuaj dhe në çfarë mënyrash mendoni se letërsia që shkruani vendos një lloj komunikimi me to.

Kërkoj të njëjtën gjë tek shkrimtaret femra si tek shkrimtarët meshkuj: një letërsi të mirë, të guximshme dhe të hapur, e cila më çon në vende dhe ide që nuk i kam

përjetuar kurrë më parë dhe që më ndihmon të kuptoj botën në të cilën jetoj. Nuk më shkon mendja të kërkoj ndonjë gjë të ndryshme në lidhje me letraren. Për sa i përket natyrës së tyre si shkrimtare gra, mendoj se tashmë kemi një lloj marrëveshjeje të heshtur se si të lëvizim në këtë mjedis që ka qenë gjithmonë kryesisht mashkullor dhe që ka ndryshuar kaq shumë gjatë viteve të fundit. Një gjë e rëndësishme është marrëveshja për të mos marrë pjesë në asgjë ku të qenit gra do të na detyronte të formojmë sërish një grup të veçantë. Dhe mendoj se është zbulimi i kësaj hapësire të re të mundshme, dhe përpjekjet që na është dashur të bëjmë here pas here për të krijuar një hapësirë për të gjithë, ato që më kanë bërë të ndihem se kam krijuar një dialog me shkrimtare të tjera gra të Amerikës Latine.

Përktheu: Granit Zela



Romani i hollë dhe mjeshtëror i mjeshtër të realizmit magjik është një rrëfim i dashurisë së ndaluar në fazën e mbrame të jetës

ROMANI "SHIHEMI NË GUSHT", NJË RRËFIM I FUNDIT I DASHURISË DALLDISËSE

Nga David Mills, *The Times*

Çdo gusht, Ana Magdalena Bach, bashkëshortja në mesomoshë e një dirigjenti orkestre, udhëton e vetme për në ishullin karaibian ku i prehet e ëma. Viteve të fundit, pasi viziton varrin, ka filluar të gjejë një të dashur dhe të kalojë një natë të përlotshme me seks para se të hipi në traget për t'u kthyer te burri i saj me shkop dirigjenti në dorë.

Rrëfimi i *Shihemi në gusht*, njihet menjëherë se është i Gabriel García Márquez-it. Dashuria – dalldisëse, e ndaluar, transgresive dhe sidomos mes njerëzve në moshë – është një prej temave të tij më të mëdha. E ka çuar në kulm të *Dashuria në kohërat e kolerës*. Ai roman i pasionit të njerëzve në moshë është i bazuar pjesërisht në një lajm në gazetë mbi një çift amerikan në të tetëdhjetat të cilët u gjendën të vrarë në një varkë në Acapulco. Aty u zbulua se që të dy kishin qenë të martuar dhe kishin pasur një romancë të fshehtë për vite me radhë. García Márquez tha se kjo histori e "magjepsi". Ia vlen të përmendet realiteti faktik pas romaneve të García Márquez-it sepse ai qëndron si tregues i dalluar i realizmit magjik, ku e mbinatyryshja ndërthuret me përditshmërinë dhe një grua që nden rrobat mund të pluskojë për në parajsë. Në fakt, edhe në romanin e tij më të famshëm, *Njëqind vjet vetmi*, një krijim magjik mitik mbi historinë e Kolumbisë, ka origjinë krejt të zakonshme në fëmijërinë e tij dhe rrëfimet e gjyshërve të tij. Realizmi magjik është bota e parë nga një fëmijë, me misterin dhe pafundësinë e rivendosur.

García Márquez duhet lexuar sepse është shkrimtar me kaq shumë ndikim, i cili rimodeloi perceptimin e vendit të vet mbi veten dhe riformoi letërsinë e tij dhe atë të gjithë botës (mund ta falënderojmë për Salman Rushdie-n). Por, më shumë se kaq, ndryshe nga shumë shkrimtarë të tjerë të "mëdhenj" librat e tij të kënaqin. Rrëfimet e tij vijnë me personazhe të pashlyeshme nga kujtesa dhe imazhe rrëmbyese të shoqëruara me episode të mprehta psikologjike. A ka fitues të tjerë të Çmimit Nobel, të cilin e mori në 1982, që kanë arritur shitjet ndërkombëtare të *Njëqind vjet vetmi*, me 50 milion kopje?

Mahnitja e tij me takimin e dashnorëve të vjetër me sa duket i mbeti në mend pasi *Shihemi në gusht* është libri që po i jepte dorën e fundit në vitet e tij të mbrame. Sidoqoftë, gjykimi i tij mbi të, para se demenca ta fikte, ishte: "Ky libër nuk bën. Duhet shkatërruar." Dhjetë vite pas vdekjes së tij në moshën 87-vjeçare, të bijtë e kanë injoruar dhe kanë

vendosur se pavarësisht "vështirësive", aftësitë në zbehje që e pengonin të mos e përfundonte librin, e pengonin edhe për të kuptuar se sa i mirë ishte.

Pra, a është ndopak i mirë? Epo, është i përfunduar në kuptimin se e ka një fund, dhe është i mirë. Nuk është një prej atyre veprave të fundit acaruese, si *Edwin Drood*, që ndërpritet duke lënë gjithçka të pazgjithur.

Hapet me udhëtimin ku Ana paraqet një praktikë të re në qëndrimet e shkuara të përvitshme e pa ndodhi në ishull. Është 46 vjeçe dhe e martuar prej 27 vitesh, por këtë vit, për asnjë arsye të dukshme përveçse një gllënje xhin, papritur ndihet "e djallëzuar, e lumtur, e aftë për çdo gjë" dhe merr një burrë në shtrat. Me t'u kthyer në shtëpi, pëson ndryshime të mëtejshme: fillon të tymosë sërish, fillon të ketë dyshime mbi të shoqin e saj dhe fillon të presë me padurim kthimin në ishull për të gjetur një të dashur të ri.

Forca e këtij romani qëndron në të kuptuarit e pasionit dhe ndjesisë së fajit që vjen më pas, ndjeshmëritë e ndërjegjes, dhe atë që është më mirë të lihet e pathënë. Në qendër të tij është një kundërvënie me bashkëshortin e saj mbi tradhtinë e tij të mundshme që e hedh poshtë: "Nëse të them se s'ka ndodhur, jam i sigurt se s'do të më besosh... Dhe nëse të them se ka ndodhur, nuk do ta durosh dot. Çfarë do të bëjmë?" Vetëkënaqësia e tij kapet në një frazë të hollë: "Ai i tha gjithçka me një ngurrim të llogaritur."

Dobësia është se ky roman i shkurtër ndonjëherë duket si i pashkruar mirë. Temat e aluduara, nuk zhvillohen. Ka muzikë nëpërtë, dhe pavarësisht se është e pavërejtur, emri i plotë e Ana-s është një germë më pak se ai i gruas së JS Bach-ut, Anna. Megjithatë, asgjë nuk ndodh me këtë, përveç nëse e gjithë pika metaforike është se burri i saj ka hequr dorë nga të luajturit dhe në vend të kësaj lexon partitura në shtrat, duke e lënë mënjanë shkopin e tij.

Disa zhvillime janë thjesht sipërfaqësore, si vendosmëria e së bijës për t'u bërë një *karmelitane këmbëzbathur* pavarësisht se ka pasur një jetë seksuale energjike që nga moshën 15 vjeçare, jeton me një muzikant xhazi dhe nuk fle kurrë.

Megjithatë, për këtë apo ndonjë "lajthitje" tjetër, *Shihemi në gusht* është qartësisht një roman i García Márquez-it: i këndshëm në mënyrë mjeshtërore dhe që shkon mirë deri në fundin e tij befasues e që të jep kënaqësi. E lexova me një frymë, pastaj u zgjova të nesërmen dhe e lexova sërish.

Përktheu: Enxhi Hudhri

PARATHËNIA E "SHIHEMI NË GUSHT", NGA BIJTË E SHKRIMTARIT

Rodrigo dhe Gonzalo García Barcha


Humbja e kujtesës nga e cila vuajti ati ynë në vitet e fundit ishte, siç merret lehtë me mend, shumë e vështirë për ne të gjithë. Por në veçanti mënyra se si kjo humbje i zvogëloi mundësitë e tij për të vijuar të shkruante me disiplinën e zakonshme ishte për të një burim zhgënjimi dëshpërues. Na tha njëherë me qartësinë dhe elokuencën e një shkrimtari të madh: "Kujtesa është njëkohësisht lënda ime e parë dhe veglorja ime. Pa të s'ka asgjë."

Shihemi në gusht ishte fryti i një përpjekjeje të fundit për të vijuar krijimin duke u bërë ballë të gjitha vështirësive. Procesi ishte një garë midis përsosurisë së artistit dhe davaritjes së aftësive të tij mendore. Vajtje-ardhja e gjatë e varianteve të tekstit është përshkruar me detaje, shumë më mirë sesa mund ta bënim ne, nga miku ynë Cristóbal Pera në shënimet e tij për këtë botim.

Dorëshkrimin e *Shihemi në gusht* e lamë mënjanë, me shpresën se koha do të vendoste për të. Duke e lexuar sërish pothuaj dhjetë vjet pas vdekjes së tij zbuluam se teksti kishte jashtëzakonisht shumë merita për t'u shijuar. Mbi të gjitha, për të shijuar atë që spikat më shumë në veprën e Gabos: talentin e tij të trillit, poezinë e gjuhës, rrëfimin robërues, aftësinë për ta kuptuar qenien njerëzore dhe dashurinë e tij për eksperiencën e tij jetësore dhe fatkeqësitë e tij, sidomos në dashuri. Dashuria, me gjasë tema kryesore e gjithë veprës së tij.

Duke e gjykuar librin shumë më mirë nga sa e kujtonim, menduam një tjetër mundësi: se mungesa e aftësive që nuk e lejoi Gabon të bënte punën përfundimtare me librin, atë punë që ia besuam redaktorit të tij, Cristóbal Pera, edhe e pengoi të kuptonte se sa i jashtëzakonshëm ishte ky roman. Vendosëm t'i japim prioritet kënaqësisë së lexuesit të tij kundrejt të gjitha argumenteve të tjera. Nëse lexuesi i tij e duartroket, ka të ngjarë që Gaboja të na falë që po e botojmë romanin pa lejen e tij. Te kjo besojmë.

Përktheu nga origjinali: Mira Meksi



1

Ukthe në ishull të premtën më 16 gusht me trage-tin e orës tre të pasdites. Kishte veshur pantallona xhinse, këmbishë me kuadrate skoceze, këpucë të thjeshta me pak takë dhe pa çorape, një çadër sateni, çantën e dorës dhe të vetmin bagazh një çantë plazhi. Në radhën e taksive të portit shkoi drejt e te një model i vjetër i ngrënë nga salnitri. Shoferi e përshëndeti miqësisht dhe me makinën që troshitej e çoi përmes fshatit varfanjak, me shtëpi prej kallamash dhe balte, me çati prej gjethesh palme dhe rrugësh me rërë të zhuritur përballë një deti në flakë. Iu desh të bënte dredha për të shmangur derrat sypatrembur dhe fëmijët lakuriq që e përqeshnin duke bërë lëvizje toreadori. Në të dalë të fshatit hyri në një shëtitore me palma mbretërore ku ndodheshin plazhet dhe hotelet e turizmit, midis detit të hapur dhe një lagune të brendshme të populluar me shapka të kaltra. Më në fund, u ndal te hoteli më i vjetër dhe i pavlerë.

Konsierzhi e priti me skedën e regjistrimit gati për firmë dhe çelësin e së vetmes dhomë të katit të dytë që binte nga laguna. Ajo i ngjiti shkallët me katër hovje dhe hyri në dhomën e varfër që mbante aromën e insektvrasësit të porsahedhur dhe po-thuaj të zënë tërësisht nga një shtrat i stërmadh bashkëshortor. Nxori nga çanta një çantëz tualeti lëkurëkeci dhe një libër fletëpaprerë me një faqe të shenjuar nga libërprerësi prej fildishti. Nxori një këmbishënatë mëndafshi rozë dhe e vendosi poshtë jastëkut. Nxori edhe një shall trekëndësh mëndafshi të stampuar me zogj ekuatorialë, një këmbishë të bardhë me mëngë të shkurtra dhe një palë atlete tenisi shumë të përdorura, dhe i shpuri në banjë.

Përpara se të rregullohej hoqi unazën e martesës dhe orën që ishte burrash e që e mbante në dorën e djathtë, i vendosi në raftin e pasqyrës së tualetit, pastaj i hodhi një grusht ujë të shpejtë fytyrës që të shpëlante pluhurin e udhëtimit dhe të trembte dremtitjen e zhegut. Kur mbaroi së thari fytyrën, peshoi në pasqyrë gjinj të saj të rrumbullt dhe të lartë megjithëse kishte bërë dy lindje. Tendosi faqet anash me skiçin e duarve për t'u kujtuar se si kish qenë e re. I ngriti sipër rrudhat e qafës, që tanimë nuk kishin shpëtim dhe kontrolloi dhëmbët e përsosur e të porsalarë pas drekës në traget. Fërkoji me kokën e antidjersës sqetullat e rruara mirë dhe veshi këmbishën prej pambuku të freskët me nistoret AMB të qëndisura në xhep. Krehu flokët e butë vezullues, të gjatë gjer te supet dhe i mblodhi bisht duke i lidhur me shallin trekëndësh me zogj. Për ta përfunduar, zbuti buzët me një laps tualeti prej vazeline të thjeshtë, njomi gjishtërinjtë tregues me gjuhë për të shtruar vetullat e bashkuara, vendosi nga një pikë parfumi *Maderas de Oriente* pas veshëve dhe u përball më në fund në pasqyrë me fytyrën e saj prej mamaje vjeshtake. Lëkura pa asnjë gjurmë tualeti kishte ngjyrën dhe përbërjen e melasës, dhe sytë prej topazi ishin të bukur me qepallat e tyre të errëta portugeze. E bloi veten sa mundi, e gjykoji pa mëshirë dhe e gjeti po aq mirë sa ndihej. Vetëm kur vendosi unazën dhe orën i ra në të se ishte vonë: ishte ora katër pa gjashtë minuta, por i lejoi vetes një minutë nostalgjie për të kundruar shapkat që flatronin të palëvizshme në përgjumjen e përvëlur të lagunës.

Taksia e priste poshtë bananishteve të hyrjes. U nis pa prituri urdhrat nëpër shëtitoren e palmave deri te një shesh i hoteleve ku ndodhej tregu popullor në qiell të hapur dhe u ndal në një pikë shitjeje lulesh. Një zezake e bëshme që kotej mbi një karrige plazhi u hodh përpjetë nga buria e makinës, njohu gruan në ndenjësën e pasme dhe mes të qeshurave dhe lllomotitjeve i dha një buqetë me gladiola që kishte porositur për të. Disa blloqe banimi më tej taksia dredhloi nëpër një shteg që mezi kalohej i

FRAGMENT NGA KAPITULLI I PARË I "SHIHEMI NË GUSHT"

Përktheu nga origjinali: Mira Meksi



cili ngjitej nëpër një shpat të thepisur me gurë të mprehtë. Përmes ajrit të qelqëzuar nga i nxehti shiheshin Karibet e hapura, jahtet e qejfit të rreshtuara në skelën e turizmit, trageti i orës katër që kthehej në qytet. Në majë të kodrës ndodhej varreza më e varfër. Ajo e shtyu pa mundim portën e ndryshkur dhe hyri me buqetën e luleve në dorë në shtegun e varreve të mbytura nga barërat e këqija. Në qendër ndodhej një pemë ceiba me degë të mëdha që e orientuan të identifikonte varrin e së ëmës. Gurët e mprehtë të shponin edhe përmes shollës prej kauçuku të nxehur dhe dielli i ashpër filtrohej nga sateni i çadërës. Një iguanë doli vrullshëm nga shkurret, u ndal në vend përballë saj, e vështrroi një çast dhe u përvodh vrik.

Ajo vuri një dorashkë kopshtari që e kishte marrë me vete në çantë dhe iu desh të pastronte tri rrasa varri përpara se të dallonte mermerin ver-dhash me emrin e së ëmës dhe datën e vdekjes, përpara tetë vjetësh.

E kish përsëritur atë udhëtim çdo 16 gusht në të njëjtën orë, me të njëjtën taksia dhe të njëjtën luleshitëse, nën diellin e zjarrtë të së njëjtës varrezë të varfër, për të vendosur një buqetë gladiolash të freskëta në varrin e së ëmës. Që nga ai çast nuk kishte më asgjë për të bërë deri në orën nëntë të mëngjesit të së nesërës, kur dilte trageti i parë i kthimit.

Quhej Ana Magdalena Bach-u, kish mbushur moshën dyzet e gjashtë vjeçe dhe kishte njëzet e shtatë vjet martesë plot harmoni me një burrë që e donte dhe që ai

e donte, me të cilin u martua pa i mbaruar studimet e larta për art dhe letërsi, ende e virgjër dhe pa u fejuar më parë. E ëma kish qenë një mësuese e shquar e arsimit fillor montesorian¹, e cila, pavarësisht meritave që kishte, nuk deshi të ishte asgjë më shumë gjer në frymën e fundit. Ana Magdalena trashëgoi prej saj shkëlqimin e syve të praruar, virtytin e të genit fjalëpakë dhe inteligjencën për të zotëruar temperamentin e saj. Ishte një familje muzikantësh. I ati kish qenë mësues pianoje dhe drejtor i Konservatorit Publik përgjatë dyzet viteve. I shoqi, edhe ai bir muzikantësh dhe drejtor i orkestrës, zëvendësoi mjeshtrin e tij. Kishin një djalë shembullor që ishte violonçeli i parë në Orkestrën Simfonike Kombëtare në moshën njëzetedyvjeçare dhe ishte duartrokur nga Mstislav Leopoldovich Rostropovich² në një seancë private. Përkundrazi, vajza tetëmbëdhjetëvjeçare kishte një lehtësi pothuaj gjeniale për të mësuar me vesh çdolloj instrumenti, por vetëm i shërbente si pretekst për të mos fjetur në shtëpi. Ishte shumë e dashuruar me një trumbetist të shkëlqyer xhazi, por dëshironte të dorëzohej murgeshë në urdhrin e Karmelitave Këmbëzbathura kundër vullnetit të prindërve.

Dëshirën për t'u varrosur në ishull e ëma ia kish shprehur tri ditë përpara se të vdiste.

¹ Montesorian – Montessori është një model edukimi i ideuar nga edukatorja dhe mjekja Anna Montessori, italiane, i zhvilluar në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX.

² Mstislav Leopoldovich Rostropovich – Violonçelist, pianist dhe shef i famshëm orkestre azer (1927-2007).

Ana Magdalena deshi të shkonte në varrim, por askujt nuk iu duk e udhës, sepse ajo vetë nuk besonte se mund të mbijetonte nga ai hidhërim. I ati e çoi në ishull në përvjetorin e parë për të vendosur rrasën prej mermeri që i detyroheshin varrit. E frikësoi lundrimi me një kanoe me motor të jashtëm që u vonua pothuaj katër orë në një det që nuk pati asnjë çast të qetë. Admiroi plazhet me miell të praruar mu në buzë të xhunglës së virgjër, poteren e zogjve dhe flatrimin e vegimtë të shapkave në hurdhën e lagunës së brendshme. E ligështoi mjerimi i fshatit, ku u desh të flinin jashtë nëpër hamakë të varur midis dy palmave të kokos, ndonëse aty kish lindur një poeteshë dhe një senator fjalëmadh që për pak desh u bë president i Republikës. I bëri përshtypje numri i madh i peshkatarëve zezakë me krahu të gjymtuar nga shpërthimi i parakohshëm i kallëpeve të eksplozivit. Megjithatë, përmbi gjithçka, kuptoi vullnetin e së ëmës kur pa shkëlqimin e botës që nga maja e varrezës. Ishte i vetmi vend i vetmuar ku nuk mund të ndihej vetëm. Ishte koha kur Ana Magdalena Bach-u vendosi ta linte aty ku ishte dhe t'i çonte çdo vit në varr një tufë me gladiola.

Gushti ishte muaji i të nxehtit të madh dhe rrebe-sheve të çmendura, por ajo e mori si një ndëshkim më shumë nga ato që duhet të përmbushte patjetër dhe përherë vetëm. Të vetmen dobësi e tregoi përpara këmbënguljes së fëmijëve të saj për të parë varrin e gjyshes dhe që natyra ia nxori për hundësh me një lundrim të frikshëm. Anija u nis megjithëse binte shi që të mos i zinte nata në udhë dhe fëmijët mbërritën të terrorizuar dhe të telikosur ngase i zuri deti. Kësaj here, për fat, fjetën në një hotel turizmi që senatori e ndërtoi në emrin e tij dhe me paratë e shtetit.

Ana Magdalena Bach-u kishte parë si rriteshin çdo vit thepajat prej xhami që shtoheshin ndërsa fshati varfërohej. Barkat me motor u nxorën jashtë përdorimit nga trageti. Lundrimi vijoi të zgjaste katër orë, por me ajër të kondicionuar, orkestrë dhe vajza qejfi. Vetëm ajo vazhdoi me rutinën si vizitorja më e përpiktë e fshatit.

U kthye në hotel, u shtri në shtrat pa asgjë tjetër në trup veç të mbathurave prej dantelle dhe e rinisi leximin e librit në faqen e shenjuar nga libërprerësi, poshtë fletëve të ventilatorit të tavanit që vetëm sa e llokoçisnin vapën. Libri ishte *Drakula* e Bram Stoker-it. Kishte lexuar gjysmën në traget me zellin e një kryevepre. E zuri gjumi me librin në kraharor dhe u zgjua pas dy orësh në errësirë, qull në djersë dhe e vdekur nga uria.

Bari i hotelit ishte i hapur deri në orën dhjetë të natës dhe zbriti të hante ç'të gjente përpara se të flinte. Vuri re se kishte më shumë klientë se zakonisht në atë orë dhe kamerieri nuk iu duk ai i mëparshmi. Porositi, për të mos u gabuar, të njëjtin sanduiç me proshutë dhe djathë si vitet e tjera, me bukë të thekur dhe kafe me qumësht. Ndërsa po ia sillnin i ra në të se ishte rrethuar nga po ata turistë të moshuar të kohës kur ai ishte i vetmi hotel. Një vajzë mulate këndonte një bolero të trishtuar dhe vetë Agustín Romero-ja³, tani plak dhe i verbër, e shoqëronte me dashuri në të njëjtin piano të rrënuar të festës së përrurimit.

Ajo mbaroi me të shpejtë, duke u përpjekur të dilte përmbi poshtërimin që po darkonte vetëm, por u ndie mirë me muzikën, që ishte e ëmbël dhe qetësuese, dhe vajza dinte të këndonte. Kur mbaroi, kishin mbetur vetëm tri çifte në tryeza të shpërndara dhe pikërisht përballë saj një burrë që binte në sy, të cilin nuk e kish parë të hynte. Ishte veshur me lino të bardhë, me flokë ngjyrë gri metal. Kishte në tryezë një shishe konjaku dhe një gotë përgjysmë, dhe dukej më i vetmuar në botë.

³ Agustín Romero – Muzikant i njohur argjentinas.

Më 18 mars 1999 lexuesit e Gabriel García Márquez-it morën lajmin e gëzueshëm se nobelisti kolumbian po punonte me një libër të ri të përbërë nga pesë tregime me një protagoniste të vetme: Ana Magdalena Bach-un. Autorja e lajmit ekskluziv, gazetarja Rosa Mora, botoi tri ditë më vonë në gazetën "El País" një intervistë të autorit së bashku me tregimin e parë të librit, *Shihemi në gusht*. García Márquez-i e kish lexuar përpara disa ditësh në Casa de América¹ në Madrid, ku merrte pjesë, së bashku me po ashtu nobelistin José Saramago, në një forum mbi forcën e krijimit ibero-amerikan. Në vend që të mbante një fjalim, ai e habiti audiencën duke lexuar variantin e parë të kapitullit të parë të romanit që tani lexuesi e ka në dorë. Rosa Mora shtonte: "*Shihemi në gusht* do të bëjë pjesë në një libër ku do të jenë edhe tri novela të tjera prej njëqind e pesëdhjetë faqesh, të cilat Gaboja i ka pothuaj të shkruara dhe ka të ngjarë që të shtojë edhe një të katërt, sepse, sipas asaj që shpjegon, i ka ardhur një ide që i duket tërheqëse. Emëruesi i përbashkët i librit është se do të trajtojë histori dashurie të njerëzve në moshë."

Disa vite më vonë Zoti e deshi që fati im të kryqëzohej me atë të García Márquez-it, njërit prej shkrimtarëve të mi më të dashur që nga adoleshenca. Leximi i apasionuar i veprës së tij, së bashku me atë të Rulfo-s, Borges-it dhe Cortázar-it, më kish bërë të kapërceja Atlantikun për të bërë doktoraturën mbi letërsinë e Amerikës Latine në Universitetin e Teksasit në Austin. Në gusht të vitit 2001, tanimë i kthyer në Barcelonë si redaktor i Random House Mondadori-t, Carmen Balcells-i më telefonoi për t'u takuar në agjenci, pothuaj e zbrazët ato ditë vere. Duhej të më kalonte në telefon García Márquez-in, të cilit i nevojitej një redaktor rojë për kujtimet e tij. Redaktori i tij i zakonshëm, miku im i shtrenjtë Claudio López de Lamadrid, ishte me pushime. Kështu nisi puna ime krah për krah me shkrimtarin kolumbian për botimin përfundimtar të *Të jetosh për ta treguar jetën*, duke riparë një dorëshkrim që më vinte me pikatore me e-mail apo me faks dhe që unë e riktheja me shënime të mia, që konsistonin thelbësisht në verifikimin e të dhënave. Më falënderoi veçanërisht për informacionin se *Metamorfoza* e Kafkës, leximi i së cilës ndryshoi universin e tij narrativ, nuk kish qenë përkthyer nga Borges-i, megjithëse botimi argjentinas që përdori kështu e pati shënuar në kopertinë. Ndonëse ishte në Los Anxhelos duke marrë veten nga një sëmundje, puna redaktoriale në largësi më lejoi të isha dëshmitar i punishtes së shkrimtarit, që nga rishkrimi i kapitullit kushtuar "Bogotazo-s"² deri te ndryshimi brilant i një shkronje në titull për të shmangur konfliktin me një tjetër autor. Ndonëse nga një rastësi e papritur munda ta njihja personalisht së bashku me Mercedes Barcha-n në një restorant në Barcelonë, nuk e rilidhëm marrëdhënien tonë autor-redaktor deri në vitin 2008.

Në maj të vitit 2003, pas një periudhe të gjatë në Los Anxhelos, Gabriel García

"Shihemi në gusht" nga Gabriel García Márquez

SHËNIM I REDAKTORIT

nga Cristóbal Pera

Márquez-i dhe Mercedes Barcha u kthyen në shtëpinë e tyre në Meksiko, ku i pret një sekretare personale e re që porsa e kishin pajtuar, Mónica Alonso. Dëshmia e saj është thelbësore për të ndërtuar kronologjinë e krijimit të *Shihemi në gusht*. Sipas Mónica Alonso-s, më 19 qershor të vitit 2002 shkrimtari mbaroi së ripari bocat përfundimtare të kujtimeve, punë në të cilën ndihmohej nga redaktori Antonio Bolívar-i. Pasi e pastroi shkrimtoren nga variantet dhe shënime të librit të dorëzuar, mori vesh lajmin e vdekjes të së ëmës po atë ditë. Me këtë përkim enigmatik mbyllej qerthulli që niste në fillim të kujtimeve të tij: "Ime ëmë më kërkoi ta shoqëroja për të shitur shtëpinë." Shkrimtari nuk kishte ndonjë projekt të shpejtë kur, duke kontrolluar kutitë e studios së tij, Mónica gjeti një dosje që kishte dy dorëshkrime: njëri i quajtur *Ajo* dhe tjetri *Shihemi në gusht*. Që nga gushti i vitit 2002 deri në korrik të vitit 2003, García Márquez-i punoi intensivisht me tekstin e *Ajo*, titulli i së cilës ndryshoi në *Kujtim kurvash të trishita* kur u botua më 2004. Kjo do të

ishte vepra e fundit fiksjon e botuar në gjallje të tij.

Por botimi në maj të vitit 2003 i një tjetër fragmenti të *Shihemi në gusht* dukej si një deklaratë publike se García Márquez-i vazhdonte të bënte përpara me projektin e tij të fundit narrativ. Kapitulli i tretë i *Shihemi në gusht* u botua si një tregim i pabotuar, i titulluar *Nata e eklipsit*, në revistën "Cambio" të Kolumbisë më 19 maj 2003 dhe disa ditë më pas në "El País". Sipas Mónica Alonso-s, duke filluar nga muaji qershor i vitit 2003 shkrimtari e rinisi me intensitet punën me dorëshkrimin e romanit. Kështu, që atëherë dhe deri në fund të vitit 2004, mbledh deri pesë variante të numërtuara njëri pas tjetrit, përveç disa drafteve të hershme dhe një varianti që e kish sjellë nga Los Anxhelosi. Të gjitha këto variante të datuara ndodhen në dokumentet e shkrimtarit të ruajtura në Harry Ransom Center të Universitetit të Teksasit në Austin.

Kur mbërriti në variantin e pestë, e la punën me romanin dhe i dërgoi një kopje agjentes së tij Carmen Balcells-


it. "Ka raste kur librat duhen lënë të pushojnë", - iu rrëfye Mónica Alonso-s. Një ngjarje e rëndësishme e priste, kremtimi i dyzetvjetorit të botimit të *Njëqind vjet vetmi*, me një botim kremtues të Akademisë Mbretërore të Gjuhës Spanjolle, dhe përgatitjet do ta zinin me punë. Pjesëmarrja në sesionin e hapjes së kongresit, më 26 mars të vitit 2007, në Kartagjenë, do të ishte një nga aktet e tij të fundit publike.

Në mars të vitit 2008, tanimë i vendosur në Meksiko si drejtor botimesh i Random House Mondadori-t, rinisa marrëdhënien si redaktor i caktuar nga Carmen Balcells-i që të punoja me García Márquez-in për një libër që do të për-mblidhte tekstet e tij për t'u lexuar në publik, i cili do të botohej dy vjet më vonë me titullin *Nuk kam ardhur për të mbajtur fjalim*. Vizitat e shpeshta në studion e tij, të paktën një herë në muaj, u përkthyer në një bisedë të gjatë për librat, autorët dhe temat që trajtonin në tekstet e botimit.

Në verën e vitit 2010 Carmen Balcells-i më informoi në Barcelonë se García Márquez-i kishte një roman të pabotuar të cilit nuk po i gjente një mbyllje dhe më kërkoi ta nxisja që ta përfundonte. Më tregoi paraprakisht se bëhej fjalë për një grua të pjekur të martuar që shkonte në ishull ku ishte varrosur e ëma dhe ku gjen dashurinë e jetës së saj. Me t'u kthyer në Meksiko, gjëja e parë që bëra ishte ta pyesja Gabon për romanin dhe t'i tregoja për fjalët e agjentes së tij. Gaboja më rrëfeu i argëtuar se nuk ishte dashuria e jetës që gjeti protagonistja e tij, por një dashnor të ndryshëm në çdo vizitë. Dhe që të më vërtetonte se po e kishte një mbyllje, i kërkoi Mónica-s variantin e fundit, përherë në dosjet gjermane Leuchtturm ku vendoste dorëshkrimet e tij, dhe më lexoi paragrafin e fundit me të cilin e mbyllte historinë në mënyrë impresionuese. Ishte shumë fanatik për punën që kishte në dorë, por disa muaj më vonë më lejoi të lexoja tre kapituj me zë të lartë pranë tij. Më kujtohet përshtypja që më bëri mjeshtëria absolute me një temë origjinale që nuk e kish trajtuar më parë në veprën e tij dhe shpresa se një ditë lexuesit e tij do të mund ta njihnin.

Kujtesa nuk e lejonte të vendoste ku duheshin të gjitha pjesët dhe korrekturat e variantit të tij të fundit, por rishikimi i tekstit ishte për një kohë mënyra më e mirë për të mbushur ditët e tij në studio, duke bërë atë që i pëlqente më shumë: propozonte një mbiemër këtu apo një detaj që mund të ndryshonte atje. Varianti 5, datuar 5 korrik 2004, dhe në faqen e parë të të cilit shkroi: "Një OK i madh përfundimtar. Të dhënat mbi të KAP 2. Kujdes: kap i mundshëm Përfundimtar/ është më i miri?" ishte qartazi i parapëlqyeri i tij dhe aty vendosi që të bënte me Mónica-n disa nga sugjerimet e shënuara në variante të mëparshme. Në të njëjtën kohë Mónica mbante një variant digjital në të cilin ende bashkëjetonin fragmente të tjera alternative apo skena që autori i pati marrë në konsideratë më parë. Këto dy dokumente janë baza e këtij botimi.

Marrëdhënia midis autorit dhe redaktorit është një pakt besimi i bazuar në respekt. Privilegji i të punuarit me Gabriel García Márquez-in është një ushtrim konstant modestie që, në rastin tim, zë vend në vetë fjalët e tij kur Carmen-i ma kaloi në telefon në bisedën tonë të parë: "Dëshiroj të jesh sa më kritik



Frontespici i variantit 5

Faqja e parë e dosjes së shenjuar si "Varianti 5". Viteve të fundit të jetës, García Márquez-i konsolidoi në këtë variant shënime të cilat kish bërë në variantet e mëparshme. Ndonëse në faqen e parë lexohet "OK i madh përfundimtar", varianti ende ka fragmente që u korrigjuan në variantin digjital Word që ruajti sekretarja Mónica Alonso.

¹ Casa de América – Organizatë publike për forcimin e lidhjeve kulturore midis Spanjës dhe Amerikës Latine.

² Bogotazo – Është një periudhë protestash dhe represioni që ndodhën në Bogota, Kolumbi, pas vrasjes së José Gaitán-it, kryetarit të Partisë Liberale kolumbiane, më 9 prill 1948.

që të mundesh, sepse porsa të vë pikën përfundimtare nuk kthehem më të shoh asgjë.” Puna ime në këtë botim ka qenë ajo e një restoratori përpara telajos së një mjeshtri të madh. Duke u nisur nga dokumenti digjital që kish mbajtur Mónica Alonso dhe duke e konfrontuar me variantin 5 – ku viteve të fundit ishin hedhur korrigjime të vogla të të tjera varianteve – të cilin ai e konsideronte përfundimtar, kam riparë çdo shënim të tij të shkruar me dorë apo diktuar Mónica Alonso-s, çdo fjalë apo fjali të ndryshuar apo të hequr, çdo alternativë në anë të fletës, që të vendosja trupëzimin e saj në këtë variant përfundimtar. Puna e një redaktori nuk është që të ndryshojë një libër, por që ta bëjë më të fortë me atë që ndodhet në faqe, dhe ky ka qenë thelbi i punës sime redaktoriale. Kjo përfshin, midis të tjerash, verifikimin dhe korrigjimin e të dhënave, që nga emrat e muzikantëve dhe të autorëve të cituar, deri te koherenca e moshës së protagonistes ashtu siç ai e planifikoi në shënimet e tij anës fletës.

Shpresoj që lexuesit e *Shihemi në gusht* të ndajnë të njëjtin respekt dhe admirim që kam ndier dhjetëra herët që kam lexuar këtë tekst, lexime në të cilat ndieja praninë e Gabos përmbi supin tim, si në foton që na bëri një ditë Mónica kur korrigjonim së bashku bocat e librit të tij të fjalimeve.

Mirënjohja ime është për Rodrigo dhe Gonzalo García Barcha-n për besimin që më dhanë një ditë gushti kur më telefonuan për të më informuar se kishin vendosur që *Shihemi në gusht* duhej botuar dhe se unë do të isha redaktori. Përpara peshës dërrmuese të përgjegjësisë, nxitja dhe besimi i tyre përgjatë të gjithë procesit ka qenë shpërblimi më i madh për punën redaktoriale të jetës sime. Kujtimi i Mercedes Barcha-s, që një ditë vendosi të më hapë derën e shtëpisë, përpos asaj të studios, ka qenë përherë i pranishëm këta muaj. Besnikëria dhe angazhimi i Mónica Alonso-s me shkrimtarin kanë qenë thelbësore që teksti të mbërrinte në dorën tonë dhe e falënderoj për kohën që më ka kushtuar për të rindërtuar historinë e shkrimit të tij. Jemi të gjithë në borxh me ekipin e Harry Ransom Center të Universitetit të Teksasit në Austin, ku ruhen arkivat e shkrimtarit, për punën e riprodhimit digjital të dorëshkrimeve të romanit, thelbësore për mbarëvajtjen e këtij botimi: Stephen Ennis, Jim Kuhn, Vivie Behrens, Cassandra Chen, Elizabeth Garver dhe Alejandra Martínez. Redaktorit të madh dhe mikut tim Gary Fisketjon i jam mirënjohës për një bisedë që më ndihmoi të dal nga bllokimi i redaktorit. Eksperiencia e tij ka qenë një udhërrëfyes, siç vijon të jetë kryeredaktori ynë i shtrenjtë, Sonny Mehta, të cilin do ta kish mrekulluar botimi i këtij libri. Falënderime të veçanta për time shoqe Elizabeth-ën dhe fëmijët tanë, Nicholas-in dhe Valerie-n, për mbështetjen e tyre kohës të gjatë që kalova në papafingo, i mbyllur me novelën. Së fundmi, mirënjohje të thellë Gabos për humanizmin, thjeshtësinë dhe dashurinë që përherë rrezatoi te çdokush që i afrohej duke menduar se ishte perëndi, që të tregonte me buzëqeshjen e tij se ishte njeri. Kujtimi i tij këta muaj ka qenë nxitja më e madhe për të mbërritur deri këtu.

Shkurt 2023

Përktheu nga origjinali: Mira Meksi

“Shihemi në gusht” nga Gabriel García Márquez PËR NJË LIBËR QË MË NË FUND MUND TË SHKRUAJ

nga *Andreas Dushi*

“Shihemi në gusht” e kam ndjekur në çdo etapë, ditë pas dite prej të paktën pesë muajsh. Pyesja Mirën si po shkonte përkthimi, Kadin për redaktimin, Enxhin për botimin dhe veten për përjetimin. Si duhet ta prisja atë libër? Me dyshimin e tradhtisë ndaj amanetit të Marquez-it apo me gëzimin e tradhtisë ndaj vdekjes së tij? Ka raste kur shkrimtarët vdesin shumë para se të humbasin jetën, ditën kur vendosin të mos shkruajnë më. Sikurse ka raste, shumë më të rralla, kur jetojnë edhe pasi vdesin sepse u kanë mbetur dorëshkrime. Doli se ky ishte Marquez-i.

Mosbotimi i librit në gjallje të tij pati qenë dëshira e vetë autorit. Dakord, por pse lindi kjo dëshirë? Analizën e detajuar mbi këtë fakt e bëjnë të bijtë, Gonzalesi me Rodrigon. Ishte moshja e shtyrë dhe demenca që sa vinte e bëhej më e thellë. Por problemi duhet shtruar njëkohshëm me pyetjen: “Si ndikoi kjo?” E bëri Marquez-in të humbiste kthjelltësinë e të shkruarit apo të të gjykuarit? Unë besojta të dytën, sidomos për faktin se nuk e kishte arritur këtë

fazë teksta shkruante “Shihemi në gusht”, por gjendej në bregun e oqeanit të demencës ndërkohë që përsiaste rreth botimit të tekstit. Pasi e lexova romanin, u binda se kisha të drejtë. Ai “OK FINAL” i madh në kopertinën e dorëshkrimit të daktilogruar (faksimili i tij gjendet në pasthënien e librit) shkruar nga dora e tij më siguroi se dëshira nuk ishte mosbotimi, por perfeksionimi.

Pasthënia mahnitëse e një redaktori të jashtëzakonshëm me kujdesin thuajse atëror për tekstin dhe besnikërinë murgërore ndaj tij e qartësonte të gjithë, në detaje. Përmbledhtazi: Marquez-i, për shkak të problemeve gjatë pleqërisë, nuk mundi t’i pasqyronte dot korrigjimet në një variant përfundimtar. Kjo qe puna e bërë prej tij, sqaruar aq bukur në shënimin e sipërpërmendur sa vërtetë u ndjeva edhe një herë i mrekulluar nga roli, rëndësia dhe pesha e redaktorit për një shkrimtar dhe veprën e tij.

“Shihemi në gusht” është përjetim i një emociioni të pashtershëm të lirisë, në stilin më të kulluar të Marquez-it. E gjithë vepra përshkohet prej fillit të dëshirës



për hapësira të reja shumëpërmasore dhe përmbillet me ngasjen ndaj tyre si diçka të trashëguar, pjesë e atij shkrimi gjenetik që kalon nga njëri brez te tjetri.

Marrëdhënia është element i dashurisë, por jo vetë Dashuria, ndaj mund të jetohej edhe jashtë saj, pa e cënuar atë. Historitë e Ana Magdalenës fillojnë me dëshirë dhe, sido të shkojnë, nuk mbarojnë me pendesë. Ajo nuk bën asgjë pse do të shkelë kurorën e martesës, por përpiqet të zëvendësojë ndonjë gur të çmuar që ka rënë prej aty.


Të jetë sjellja e saj arsyeja pse, kur kthehet nga ishulli, gjërat në shtëpi nuk po i shkojnë si duhet? I shoqi sikur është ftohur, apo është ftohur ajo ndaj tij? S’di të them. Ajo ama, pasi kupton se vetë po e thyen besimin e të shoqit, fillon të mendojë mos ndoshta të njëjtën gjë e bën dhe ai. Dhe kur merr vesh, pas këmbënguljesh të papushimta, se ai e kishte tradhtuar vite më parë, ndihet shumë e zhgënjyer dhe e harron çka e nxiti këtë dyshim: sjellja e asaj vetë!

Përtej kësaj, lakorja e ndryshimit të historisë së ishullit, industrializimi dhe komercializimi i tij nga një vend i qetë në një gjullurdi zhurmash me turistë, makina e hotele paraqet më së miri natyrën e një bote e cila po ndryshon shumë shpejt për nga ai kah që domosdoshmërisht e shpie drejt zhbërjes së thelbit të saj dhe zëvendësimit të tij me një copë kauçuku që merr gjithë llojet e mundshme të formave.

Gjuha në këtë roman është e thjeshtë dhe ngjarjeve ndonjëherë u mungojnë tipare të rëndësishme, por thuajse gjithmonë janë detajet krejt lehtësisht të shmangshme: Lexojmë se si vishet Ana, se si ndihet gjatë marrëdhënies me të dashurin e asaj nate, madje edhe kur i prek seksin apo e ndjen atë në trupin e saj. Si mjet, gjuha, krejt e dliirë nga banalitetet, përdoret për të sjellë më së miri emocionin e ndjelljes nga mishi i tjetrit. Ishulli kthehet në skenë fantazish, edhe me njerëz, ose sidomos me njerëz që në pamje të parë ngajnë sikur nuk kanë asgjë tërheqëse për dikë si Ana Magdalena.

Ka kohë që dua ta shkruaj këtë, sepse romanin e kam lexuar tash më shumë se dy muaj, por nuk mundesha, spoil alert ishin të ndaluara rreptësisht nga agjentët e huaj dhe akoma më rreptësisht më ndaloheshin prej botueses shqiptare. Tani kur gjashtë marsi erdhi dhe mund ta ndaj me të gjithë si e kam jetuar unë leximin e “Shihemi në gusht”, pra tani që libri u botua në gjuhët kryesore të botës, edhe në shqip nga “Onufri”, pres me kërshtëri përshtypjet e secilit, edhe si përforcim apo rrëzim i qëndrimit tim e të pjesës më të madhe të botës ndaj çështjes së botimit të këtij libri.

Marrë nga andreasdushi.com



Romani i panjohur i G. G. Markezit u botua në të gjithë botën
(në shqip nga Onufri), në të njëjtën ditë: 6 mars 2024

